



ndersa pu
mend hi
me ne le
kapital
u gradi
ka Ekon
lad ne
nepe nje

www.bekonomike.com

RAPORTI VJETOR 2025

SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Banka
Ekonome

 Banka
Ekonome

SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Raporti Vjetor

2025





Përmbajtja

MESAZH NGA BORDI I DREJTORËVE	03
MESAZH NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV	05
VIZIONI	09
MISIONI	09
VLERAT TONA	09
MJEDISI MAKROEKONOMIK	10
SEKTORI BANKAR	10
POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE 2025 NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS	17
PJESËMARRJA NË TREGUN E KREDIVE	18
PJESËMARRJA NË TREGUN E DEPOZITAVE	19
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	21
PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE	24
ASETET E BANKËS	25
ECURIA E KREDIVE	26
ECURIA E DEPOZITAVE	27
TE HYRAT NGA INTERESI	28
SHPENZIMET OPERATIVE	29
ZHVILLIMI I BIZNESIT	30
PORTOFOLI KREDITOR	32
KLIENTËT KORPORATË	35
KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME	37
KLIENTËT INDIVIDUALE	39
KANALET E DISTRIBUIMIT DHE RRJETI I DEGËVE	41
KANALET ALTERNATIVE TË SHËRBIMIT - QENDRA E THIRRJEVE	43
LIZINGU	44
ZHVILLIMI I SIGURIMEVE DHE BANCASSURANCE	45
ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE PËRKRAHJA E BIZNESIT	47
MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR	51

MENAXHIMI I RISKUT OPERACIONAL	52
RISKU KREDITOR	53
MENAXHIMI I RREZIQEVE	57
RISKU I LIKUIDITETIT	57
RISKU I TREGUT	58
RISKU I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)	59
PAGESAT DHE OPERACIONET	60
TRANSFERET KOMBËTARE	61
TRANSFERET NDËRKOMBËTARE	62
GARANCIONET DHE LETËRKREDITË NDËRKOMBËTARE	63
KARTELAT BANKARE	65
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	69
FOKUSI NË SIGURINË E INFORMACIONIT	71
MENAXHIMI DHE TRAJNIMI I PERSONELIT	73
PAJTUESHMËRIA E PËRGJITHSHME	79
PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS	80
MESAZH NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV	91
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	93
PERFORMANCA E KS SIGURIA	95
SIGURIA – RITJE E KONSOLIDUAR, RITJE E BESIMIT DHE TRANSFORMIM I QËNDRUESHËM	101
DEPARTAMENTI I SHITJES DHE MARRJES NË SIGURIM	102
SIGURIMI I SHËNDETIT DHE AKSIDENTEVE	103
SIGURIMI I PRONAVE DHE GARANCIONEVE	104
SIGURIMET KASKO	105
SIGURIMI I AUTOPËRGJEGJËSISË (TPL)	106
DEPARTAMENTI I DËMEVE	107
SINERGJIA MES KS SIGURIA DHE BANKËS EKONOMIKE, NJË SIGURI E PËRGJITHSHME SHOQËRORE	109

MESAZH NGA BORDI I DREJTORËVE

Transformim, konsolidim dhe vizion i qartë për të ardhmen

Të nderuar klientë, kolegë dhe aksionarë, Viti 2025 ishte një vit i rëndësishëm transformimi dhe konsolidimi për Bankën Ekonomike, i karakterizuar nga zhvillime të qëndrueshme dhe avancime të dukshme në të gjitha dimensionet kryesore të operimit. Në një mjedis financiar që po evoluon me ritme të shpejta dhe që kërkon përshtatje të vazhdueshme, Banka ka vijuar të ndërtojë një profil më të fortë, më modern dhe gjithnjë e më të orientuar drejt nevojave reale të klientëve. Gjatë këtij viti, kemi arritur një performancë të qëndrueshme financiare dhe kemi forcuar më tej pozicionin tonë në treg. Rritja e portofolit të kredive dhe depozitave, së bashku me një rezultat pozitiv financiar, me një fitim prej 12.70 milionë euro para tatimit, që reflekton një strategji të disiplinuar biznesi, një menaxhim të kujdesshëm të rrezikut dhe, mbi të gjitha, besimin e vazhdueshëm të klientëve tanë.

Megjithatë, për ne, performanca financiare është vetëm një pjesë e historisë po aq e rëndësishme është mënyra se si ndërtojmë të ardhmen e Bankës dhe si krijojmë vlerë të qëndrueshme në afat të gjatë.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të vitit 2025 ishte zgjerimi i pranisë së Bankës Ekonomike në treg përmes integritit të operacioneve të degës së Türkiye İş Bankası në Kosovë. Ky hap përfaqëson një moment strategjik në rrugëtimin tonë, duke kontribuar në:

- Rritjen e bazës së klientëve dhe zgjerimin e pranisë gjeografike
- Forcimin e kapaciteteve operacionale dhe konkurruese
- Rritjen e aftësisë për të mbështetur ekonominë dhe bizneset vendore

Integrimi i këtij operacioni është realizuar me sukses falë një koordinimi të fortë institucional dhe një angazhimi të lartë të të gjitha strukturave të Bankës, duke dëshmuar kapacitetin tonë për të menaxhuar procese komplekse transformuese.

Sektori bankar po kalon një transformim të thellë teknologjik dhe organizativ, dhe për Bankën Ekonomike ky transformim mbetet një prioritet strategjik. Gjatë vitit 2025, janë përshpejtuar ndjeshëm investimet në këtë drejtim, duke përfshirë:

- Modernizimin e infrastrukturës teknologjike dhe sistemeve bankare
- Zhvillimin e shërbimeve digjitale dhe kanaleve alternative të komunikimit
- Përmirësimin e përvojës së klientit përmes proceseve më të thjeshta dhe më efikase

Synimi ynë është i qartë: të ndërtojmë një bankë që ofron shërbime më të shpejta, më të sigurta dhe më të personalizuar. Transformimi digjital nuk është vetëm një investim në teknologji, por një ndryshim thelbësor në mënyrën se si operojmë dhe si ndërveprojmë me klientët tanë, duke e vendosur përvojën e tyre në qendër të çdo zhvillimi.

Një tjetër element kyç i strategjisë sonë është zhvillimi i një ekosistemi financiar më të plotë dhe të integruar. Në këtë drejtim, kemi konsoliduar bashkëpunimin me kompaninë e sigurimeve KS Siguria, duke krijuar mundësi për të ofruar zgjidhje të kombinuara që përfshijnë shërbime bankare dhe sigurimi. Ky model bashkëpunimi:

- Rrit vlerën e ofruar për klientët përmes shërbimeve të integruara
- Zgjeron gamën e produkteve dhe zgjidhjeve financiare
- Forcon lidhjen afatgjatë me klientët dhe partnerët

Ky drejtim do të vazhdojë të jetë një nga shtyllat strategjike të zhvillimit tonë në vitet në vijim.

Suksesi i Bankës Ekonomike mbështetet mbi njerëzit që e ndërtojnë atë çdo ditë.

Profesionalizmi, përkushtimi dhe integriteti i stafit tonë janë themeli mbi të cilin ndërtohet besimi i klientëve dhe stabiliteti i institucionit. Investimi në zhvillimin e kapitalit njerëzor mbetet një prioritet i vazhdueshëm për të garantuar performancë të qëndrueshme dhe standarde të larta shërbimi.

Në këtë rrugëtim, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për:

- Klientët tanë, për besimin dhe besnikërinë e vazhdueshme
- Partnerët tanë, për bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe të frytshëm
- Stafin tonë, për përkushtimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm

Duke parë drejt vitit 2026, sektori financiar pritet të përballet me zhvillime të mëtejshme, duke përfshirë digjitalizim më të thellë, rritje të konkurrencës dhe kërkesa më të larta për inovacion dhe transparencë. Banka Ekonomike është e përgatitur për këtë fazë të re, me një vizion të qartë dhe kapacitete të konsoliduara.

Prioritetet tona strategjike mbeten të fokusuara në:

- Forcimin e stabilitetit financiar dhe menaxhimin e kujdesshëm të rrezikut
- Përsheptimin e transformimit digjital dhe inovacionit
- Zgjerimin e mbështetjes për bizneset dhe ekonominë reale
- Zhvillimin e partneriteteve që krijojnë vlerë të qëndrueshme për klientët dhe shoqërinë

Me përvojën, ekspertizën dhe vizionin tonë të përbashkët, jemi të bindur se Banka Ekonomike do të vazhdojë të rritet dhe të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit financiar në vend.

*Me respekt,
Bordi i Drejtorëve
Banka Ekonomike*





Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv



Hamide Pacolli Gashi
Zv. Kryeshef Ekzekutive



Arijan Haxhibeqiri
Zv. Kryeshef Ekzekutive

Të nderuar klientë, partnerë dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,

Viti 2025 shënon një etapë të rëndësishme në zhvillimin e Bankës Ekonomike, me një kombinim të qëndrueshëm të rritjes financiare, avancimit teknologjik dhe forcimit të marrëdhënieve me klientët dhe komunitetin. Në një ambient ekonomik që vazhdon të karakterizohet nga dinamika të forta dhe sfida të vazhdueshme, kemi arritur të ruajmë stabilitetin dhe të rritemi mbi bazat tona të forta, duke u orientuar drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Përmes një qasjeje proaktive dhe vendimmarrjeje të strukturuar qartë, kemi arritur të shfrytëzojmë mundësitë e tregut dhe të adresojmë sfidat me fleksibilitet dhe përgjegjësi, duke krijuar vlerë të qëndrueshme për të gjitha palët e interesit.

Rritje, qëndrueshmëri dhe besim i vazhdueshëm

Gjatë vitit 2025, performanca financiare e Bankës Ekonomike ka treguar stabilitet dhe progres të vazhdueshëm në të gjitha segmentet kryesore të aktivitetit të saj.

- Portofoli i Bankës shënoi rritje të qëndrueshme për rreth 73 milion euro ose rritje për 14.64 përqind nga viti paraprak, duke u mbështetur në një zgjerim të balancuar të kreditimit për individë, biznese dhe korporata
- Të hyrat vijuan trendin pozitiv, duke arritur total prej 50.60 milion euro dhe duke mirëmbajtur pjesëmarrjen në total të të hyrave të interesit të tregut në 8.8 përqind.
- Depozitat shënuan rritje të ndjeshme, prej rreth 101 milion euro ose rritje prej 16.95 përqind në krahasim me vitin e kaluar, duke reflektuar besimin e klientëve në sigurinë dhe stabilitetin e Bankës
- Rezultatet financiare kontribuan në ruajtjen e një pozicioni të fortë kapital dhe një baze të shëndoshë për zhvillim të mëtejshëm, duke arritur një fitim prej 12.70 milion euro para tatimit.

Këto zhvillime janë rezultat i kombinimit të disiplinës financiare, menaxhimit të kujdesshëm të riskut dhe orientimit të vazhdueshëm drejt nevojave të klientëve. Rritja e portofolit dhe depozitave nuk përfaqëson vetëm zgjerim të aktivitetit, por edhe thellim të marrëdhënieve me klientët dhe rritje të besueshmërisë së institucionit në treg.

Në të njëjtën kohë, investimi në kapitalin njerëzor ka qenë komponent kyç i këtij suksesi. Përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe zhvillimit profesional, kemi ndërtuar një ekip të përgatitur dhe të motivuar, i cili kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve dhe në përmbushjen e objektivave strategjike.

Transformimi ynë digjital – drejt një banke më të avancuar

Transformimi digjital gjatë vitit 2025 ka qenë një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit, me synim krijimin e një eksperience moderne, të thjeshtë dhe të sigurt për klientët.

- Thjeshtimi i proceseve ka reduktuar ndjeshëm kohën dhe kompleksitetin e shërbimeve bankare, duke rritur efikasitetin operacional
- Përmirësimi i platformave E-Banking dhe Mobile Banking ka mundësuar qasje më të lehtë dhe funksionalitete më të avancuara për klientët
- Rritja e standardeve të sigurisë ka garantuar mbrojtje më të lartë të të dhënave dhe transaksioneve
- Zhvillimi i funksionaliteteve të reja ka siguruar vazhdimësi dhe fleksibilitet në përdorimin e shërbimeve digjitale

Ndër zhvillimet më të rëndësishme që kanë karakterizuar këtë transformim janë:

- Implementimi i DCC në POS terminale, duke rritur transparencën dhe fleksibilitetin për klientët ndërkombëtarë
- Integrimi i chatbot-it në uebfaqe, duke ofruar asistencë të menjëhershme dhe të vazhdueshme
- Zhvillimi i OTP përmes emailit, duke garantuar akses të pandërprerë në shërbimet digjitale
- Zgjerimi i përdorimit të pagesave elektronike dhe rritja e pranisë së POS terminaleve në treg
- Përmirësimi i proceseve të pagesave dhe menaxhimit të pagave për bizneset
- Banka Ekonomike ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Facilitation dhe Oracle për implementimin e një sistemi të ri bankar, të bazuar në teknologjitë më të fundit, duke shënuar një etapë të re në modernizimin dhe transformimin digjital të Bankës. Ky projekt përfaqëson një investim strategjik në avancimin e infrastrukturës teknologjike të Bankës Ekonomike, duke rritur efikasitetin e proceseve, përmirësimin e sigurisë dhe ofrimin e shërbimeve. Platforma e re, e bazuar në teknologji të gjeneratës së fundit, do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale dhe optimizimin e proceseve të brendshme.

Këto nisma kanë ndikuar në transformimin e mënyrës se si klientët ndërveprojnë me Bankën, duke e bërë përvojën më intuitive për ta dhe më të përshtatshme për kërkesat e kohës. Digjitalizimi ka kontribuar gjithashtu në rritjen e efikasitetit të brendshëm dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Zgjerimi dhe lidhja me komunitetin

Gjatë vitit 2025, Banka Ekonomike ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për zgjerimin e pranisë së saj dhe forcimin e lidhjes me komunitetin në të gjithë vendin.

- Integrimi i suksesshëm i IS Bank në Kosovë ka sjellë zgjerim të bazës së klientëve dhe forcim të kapaciteteve operacionale
- Zgjerimi i rrjetit të degëve, përfshirë praninë në Leposaviq, ka mundësuar ofrimin e shërbimeve bankare në zona me rëndësi strategjike
- Investimet në modernizimin e degëve ekzistuese kanë përmirësuar ndjeshëm përvojën e klientëve dhe kushtet e shërbimit

Këto zhvillime kanë ndikuar në rritjen e aksesit në shërbime financiare dhe në ndërtimin e një marrëdhënieje më të afërt me komunitetin. Zgjerimi nuk është parë vetëm si rritje fizike e rrjetit, por edhe si mënyrë për të krijuar një prani më të fortë dhe më gjithëpërfshirëse në treg, duke adresuar nevojat e ndryshme të klientëve në rajone të ndryshme.



Përgjegjësia sociale – investim në të ardhmen

Përkushtimi ndaj përgjegjësisë sociale ka vazhduar të jetë pjesë integrale e veprimtarisë së

Bankës Ekonomike gjatë vitit 2025.

- Mbështetja e sportit ka kontribuar në zhvillimin e talenteve dhe promovimin e vlerave si disiplina dhe përkushtimi
- Përkrahja e aktiviteteve kulturore ka ndihmuar në pasurimin e jetës sociale dhe kulturore të komunitetit
- Investimet në arsim dhe shëndetësi kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e brezave të rinj
- Mbështetja e kategorive në nevojë ka reflektuar angazhimin për një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe solidare

Këto nisma kanë forcuar rolin e Bankës si institucion që kontribuon jo vetëm në zhvillimin ekonomik, por edhe në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë.

Përfundim

Arritjet e vitit 2025 janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet klientëve, personelit, partnerëve dhe aksionarëve tanë. Ky bashkëpunim ka krijuar një bazë të fortë për vazhdimin e rritjes dhe zhvillimit në të ardhmen.

Banka Ekonomike do të vijojë të jetë e përkushtuar për të avancuar më tej kapacitetet e saj, për të ofruar zgjidhje inovative dhe për të ruajtur standarde të larta në çdo aspekt të veprimtarisë. Me një vizion të qartë dhe një strategji të përcaktuar qartë, ne synojmë të vazhdojmë të jemi një partner i besueshëm financiar dhe një kontribues i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv,

Shpend Luzha

Kryeshef Ekzekutiv

VIZIONI

Të jemi një nga ofruesit më të mirë dhe më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Kosovë.

MISIONI

- Të jemi partneri më i mirë financiar i klientëve tanë, për të arritur rritje dhe qëndrueshmëri ekonomike.
- Të jemi në qendër të kërkesave dhe shërbimeve financiare të klientëve individualë, bizneseve, korporatave dhe klientëve institucionalë.
- Të mbështesim dhe rreshtohemi në të gjitha aktivitetet që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.
- Qëllimi ynë parësor është të fitojmë dhe të ruajmë besimin e publikut si dhe t'u përmbahemi standardeve më të larta etike.
- Të arrijmë të ofrojmë mbështetje financiare, siguri dhe optimizëm tek klientët tanë.

VLERAT TONA

- Në pikëpamjen afatgjatë, ne investojmë në njerëz, produkte dhe teknologji.

Ne vazhdimisht përpiqemi të përmirësojmë performancën tonë deri në përpikëri.



MJEDISI MAKROEKONOMIK

Gjatë vitit 2025, ekonomia e Kosovës ka treguar qëndrueshmëri dhe një trend pozitiv të rritjes, pavarësisht sfidave të vazhdueshme globale dhe rajonale. Sipas të dhënave paraprake nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje reale prej 3.9 përqind deri në 4.1 përqind krahasuar me vitin paraprak. Kjo dinamikë u mbështet kryesisht nga konsumi final i amvisërive, rritja e investimeve publike, si dhe nga sektori i shërbimeve, i nxitur veçanërisht nga diaspora.

Sektori i ndërtimit dhe tregtia me pakicë vazhduan të jenë kontribuuesit kryesorë në rritje, të pasuar nga një performancë e përmirësuar e sektorit të prodhimit. Rritja e qëndrueshme e dërgesave të emigrantëve (remitancave), të cilat arritën një vlerë rekorde, luajti një rol thelbësor në mbështetjen e fuqisë blerëse dhe kërkesës së brendshme.

Inflacioni dhe Tregtia

Në vitin 2025, presionet inflacioniste shënuan një rënie të ndjeshme krahasuar me nivelet e larta të viteve paraprake, duke u stabilizuar në një mesatare vjetore prej 3.3 përqind (ASK). Kjo rënie erdhi si rezultat i stabilizimit të çmimeve të ushqimeve dhe karburanteve në tregjet ndërkombëtare, si dhe masave të ndërmarra nga institucionet vendore. Megjithatë, deficitit i lartë tregtar mbetet një sfidë strukturore për ekonominë. Edhe pse eksportet e mallrave dhe shërbimeve shënuan rritje, ato nuk mjaftuan për të mbuluar vëllimin e lartë të importeve, duke rezultuar në një thellim të deficitit të bilancit të pagesave.

Tregu i Punës

Tregu i punës tregoi shenja përmirësimi, me një rritje të shkallës së punësimit. Sipas ASK-së, shkalla e papunësisë ra në 11.0 përqind (në TM4 2025), duke shënuar një nivel historikisht të ulët, megjithëse papunësia te të rinjtë dhe niveli i lartë i joaktivitetit mbeten shqetësuese.

Në përmbledhje, viti 2025 u karakterizua nga një konsolidim i rritjes ekonomike dhe stabiliteti financiar, duke hapur perspektivapozitive për një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në vitet në vijim.

SEKTORI BANKAR

Sektori bankar në Kosovë, gjatë vitit 2025, ka vazhduar të jetë një nga shtyllat kryesore të stabilitetit financiar dhe zhvillimit ekonomik në vend. Sipas raporteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), sektori ka treguar qëndrueshmëri, likuiditet të lartë dhe nivel adekuat të kapitalizimit për të përballuar rreziqet.

Aktiviteti Kreditor dhe Depozitat

Aktiviteti kreditor shënoi një rritje të shpejtë prej 14,7 përqind (BQK, dhjetor 2025), duke arritur një vlerë totale prej 6,67 miliardë eurosh. Kjo rritje u nxit nga kërkesa e fortë për financim nga ana e ekonomive familjare dhe e bizneseve, si dhe nga kushtet e favorshme të kreditimit.

Nga ana tjetër, depozitat e klientëve vazhduan të rriten, duke arritur vlerën prej 7,82 miliardë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 8,5 përqind. Kjo pasqyron besimin e lartë të qytetarëve në sistemin bankar. Raporti kredi-depozita u stabilizua në rreth 85,2%.

Digjitalizimi dhe Inovacioni

Digjitalizimi i shërbimeve bankare mori një hov të mëtejshëm në vitin 2025.


Bankat komerciale vazhduan të investojnë në teknologji, duke ofruar zgjidhje më të shpejta dhe më të sigurta për klientët e tyre. Përdorimi i aplikacioneve mobile dhe i pagesave elektronike shënoi një rritje të konsiderueshme, duke lehtësuar qasjen në shërbimet financiare dhe duke reduktuar nevojën për prezencë fizike në degë.

Cilësia e Portofolit dhe Mbikëqyrja

Cilësia e portofolit kreditor mbeti në nivele të larta, me një rënie të mëtejshme të shkallës së kredive jo-performuese (NPL) në 1,8 përqind.


Në fund të këtij viti, sektori bankar në Kosovë paraqitet më i konsoliduar, më i zhvilluar dhe më pranë qytetarëve. Me një vizion të qartë për të ardhmen dhe me fokus të pandërprerë në përmirësim, bankat mbeten partnerë të rëndësishëm për çdo hap që qytetarët dhe bizneset ndërmarrin drejt suksesit dhe stabilitetit financiar.

BURIMI: BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS;
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS.




+3.12%

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit




+16.50%

Depozitat (në milionë EUR)




+18.61%



Asetet (në milionë EUR)








STRUKTURA ORGANIZATIVE



POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE 2025 NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS

Rritja e tregut bankar në të gjitha asetet, prej 13,53 përqind është ndikuar edhe nga Bankajonë, e cila shënoi rritje në të gjitha asetet prej 18,61 përqind. Në terma realë, në fund të vitit 2025, pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 800 milionë euro, krahasuar me 675 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2024.

Rritja në asete



% në total asetet




FIGURA 1. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 dhjetor 2025:

FIGURA 2. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total asetet e tregut, 31 dhjetor 2025:

PJESËMARRJA NË TREGUN E KREDIVE

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në totalin e kredive në treg, më 31 dhjetor 2025, qëndronte në 8.63 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar. Gjatë vitit 2025, Banka shënoi një rritje prej 14.58 përqind në kredi, krahasuar me rritjen prej 14.74 përqind të tregut.





FIGURA 3. Rritja e Bankës Ekonomike në kreditë e përgjithshme në raport me tregun, 31 dhjetor 2025:

FIGURA 4. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e kredive në raport me tregun, 31 dhjetor 2025:

PJESËMARRJA NË TREGUN E DEPOZITAVE

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në totalin e depozitave në treg, me 31 dhjetor 2025, ishte 8.92 përqind e sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë. Gjatë vitit 2025, Banka shënoi një rritje prej 16.50 përqind në depozita, krahasuar me tregun që ka shënuar një rritje prej 12.67 përqind.

Rritja në depozita



% në total depozitat





FIGURA 5. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në depozita në raport me tregun, 31 dhjetor 2025:

FIGURA 6. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e depozitave në raport me tregun, 31 dhjetor 2025:




Pasuritë	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Paraja e gatshme dhe në banka	46,064	40,484
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	66,560	60,232
Kreditë për klientët	560,541	491,220
Investime në letra me vlerë	99,980	55,749
Investimet në degë	7,358	7,358
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	14,711	13,535
Pasuritë e paprekshme	2,295	3,220
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	-	343
Pasuri të tjera	3,474	3,140
Gjithsej pasuritë	800,983	675,281
Detyrimet		
Depozitat nga klientët	695,430	596,936
Detyrime ndaj bankave	2,588	1,096
Borxhi i varur	2,136	-
Detyrimi i tatimit në fitim	241	-
Detyrime të tjera	4,554	3,931
Detyrimi i shtyer tatimor	592	596
Gjithsej detyrimet	705,541	602,559
Ekuiteti dhe rezervat		
Kapitali aksionar	38,874	29,422
Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera	6,606	4,887
Fitime të mbajtura	49,962	38,413
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat	95,442	72,722
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat	800,983	675,281

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre më 20 Prill 2026 nga:


Zt. Shpend Luzha
Kryeshëf Ekzekutiv


Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	40,028	35,973
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	(9,005)	(7,741)
Të ardhurat neto nga interesi	31,023	28,232
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	6,800	5,941
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	(2,008)	(1,667)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione	4,792	4,274
Fitimi nga blerja mbi vlerën e drejtë	2,884	-
Të ardhurat e tjera operative	556	764
Të ardhurat	39,255	33,270
Shpenzimet e personelit	(6,483)	(5,585)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(3,389)	(3,306)
Shpenzime të tjera	(13,142)	(12,015)
(Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në instrumentet financiare	(2,960)	(342)
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	(580)	(365)
Gjithsej shpenzimet operative	(26,554)	(21,613)
Fitimi para tatimit	12,701	11,657
Tatimi në fitim	(1,152)	(963)
Fitimi neto për vitin	11,549	10,694
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		
Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje		
Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi	(1,598)	-
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës	-	4
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje		
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	121	137
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	1,719	141
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	13,268	10,835




PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE

Duke vazhduar traditën e rritjes dhe ruajtjes së kënaqshmërisë së klientëve, si dhe duke punuar vazhdimisht për arritjen e caqeve të performancës financiare, Banka Ekonomike, edhe në vitin 2025, shënoi progres në shumicën e treguesve financiarë, duke e mbyllur vitin me fitim para tatimit në vlerë prej 12.70 milionë euro.

Të hyrat neto nga interesi shënuan rritje, e kjo rritje në krahasim me vitin e kaluar është 10 përqind më e lartë, ndërkohë, të hyrat neto nga komisionet dhe tarifat gjatë vitit 2025 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak nga 4,274 milion sa ishin në vitin 2024 në 4,792 milion euro në vitin 2025. Si rrjedhojë e kësaj Banka ka vazhduar të rekrutojë klientë të rinj në masë të konsiderueshme, falë cilësisë së shërbimeve dhe teknologjisë moderne.

Banka jonë mbetet e përkushtuar që t'i realizojë planet e saj afatgjate strategjike, në mënyrë që të vazhdojë t'i kryejë operacionet me sukses dhe në trend të qëndrueshëm rritjeje..



ASETET E BANKËS

Përkushtimi ndaj vlerave, cazeve të performancës dhe angazhimi i vazhdueshëm drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së Bankës kanë rezultuar në rritje të aseteve të saj për të gjashtin vit me radhë. Banka jonë mbylli vitin 2025 me 800 milionë euro, për dallim nga viti 2024 kur kishte 675 milionë euro asete.




FIGURA 7: Asetet e Bankës Ekonomike,
2021-2025:

ECURIA E KREDIVE

Menaxhimi i duhur i portofolit dhe menaxhimi i balancuar i rrezikut kanë ndikuar që edhe këtë vit të vazhdojë trendi i rritjes. Si rezultat, Banka shënoi një rritje substanciale në portofolin e kredive, përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2025, portofoli i kredive u rrit nga 501 milionë euro në 574 milionë euro.

Banka Ekonomike ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme produktet e saj më të mira të kredidhënies përmes fushatave të marketingut.




FIGURA 8: Portofoli i kredive,
2021-2025:

Kreditë - Banka Ekonomike

ECURIA E DEPOZITAVE

Rritja e vazhdueshme e depozitave është një tregues më shumë për rritjen e vazhdueshme të besimit të klientëve ndaj shërbimeve të Bankës Ekonomike. Viti 2025 shënoi rritje të depozitave në 695 milionë euro, nga 597 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.





FIGURA 9: Depozitat e klientëve,
2021-2025:

Depozitatë e klientve - Banka Ekonomike


TË HYRAT NGA INTERESI

Euro'000	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Te hyrat nga interesi	17,966	21,513	24,577	30,746	35,973	40,028
Kostot e depozitave	2,640	2,783	3,188	5,450	7,741	9,005
Te hyrat NETO nga interesi	15,326	18,730	21,388	25,295	28,232	31,023
NETO te hyrat nga komisionet dhe tarifat	2,030	2,467	3,444	3,575	4,274	4,792



SHPENZIMET OPERATIVE

	Euro'000	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shpenzimet administrative		4,463	5,083	5,314	7,292	12,015	13,142
Shpenzimet e personelit		3,466	3,888	4,546	5,064	5,585	6,483
Shpenzimet e zhvlersimit		2,277	2,367	2,611	3,055	3,306	3,389
Gjithsej shpenzimet operative		10,206	11,338	12,471	15,410	20,906	23,014



ZHVILLIMI I BIZNESIT

Rritje e qëndrueshme dhe transformim drejt një banke më afër klientit

Gjatë vitit 2025, Banka Ekonomike ka vazhduar të forcojë ndjeshëm pozicionin e saj në treg përmes zgjerimit të bazës së klientëve, rritjes së përdorimit të produkteve dhe avancimit të kanaleve digjitale. Qasja strategjike e fokusuar në klientin dhe inovacionin ka rezultuar në performancë të qëndrueshme dhe rritje të dukshme në të gjitha segmentet kryesore të biznesit.

Modernizimi i platformave elektronike, zgjerimi i rrjetit të degëve dhe rritja e numrit të bankomatëve kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës së klientit dhe në rritjen e përdorimit të shërbimeve digjitale. Paralelisht, fushatat e marketingut dhe ofertat e personalizuara kanë forcuar besueshmërinë e klientëve dhe kanë nxitur përdorimin më të madh të produkteve bankare.

Klientët Individualë

Segmenti i klientëve individualë vazhdoi të jetë një ndër shtyllat kryesore të rritjes gjatë vitit 2025. Rritja e numrit të klientëve të rinj dhe përdorimi më i madh i produkteve digjitale kanë ndikuar pozitivisht në performancën e përgjithshme të bankës.

Përmes zhvillimit të produkteve inovative dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve, banka arriti të rrisë depozitat, portofolin e kredive dhe përdorimin e kartelave bankare. Përvoja më e thjeshtuar dhe intuitive në kanalet elektronike ka kontribuar ndjeshëm në adoptimin e shërbimeve digjitale nga klientët.

SME (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme)

Segmenti i SME-ve ka shënuar një performancë shumë pozitive gjatë vitit 2025, duke reflektuar besimin e bankës në potencialin e bizneseve vendore dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik.

Portofoli kreditues u rrit me 10 milionë euro, duke arritur në 150.6 milionë euro, ndërsa cilësia e portofolit është ruajtur në nivele të qëndrueshme, me kredi joperformuese brenda parametrave të pranueshëm. Kontribut të rëndësishëm në këtë zhvillim dhanë:

- Pjesëmarrja në programin WE Finance Code, me fokus në mbështetjen e grave në biznes
- Lehtësimi i qasjes në financa përmes ndryshimeve në politikat kreditore
- Zgjerimi i rrjetit të pagesave përmes mbi 1,450 POS terminaleve
- Gjenerimi i mbi 38 milionë euro qarkullim përmes këtyre terminaleve

Kjo qasje mundësoi mbështetje më të mirë për bizneset dhe kontribui në rritje të aktivitetit ekonomik në vend.

Korporata

Departamenti i Korporatës vazhdoi të luajë një rol kyç në mbështetjen e bizneseve të mëdha dhe klientëve institucionalë, duke ofruar zgjidhje të strukturuar dhe të personalizuara financiare.

Gjatë vitit 2025:

- Portofoli kreditues është rritur me 41.3 milionë euro, duke arritur në mbi 200 milionë euro
- Depozitat janë rritur me 34.6 milionë euro (+29.71%)
- Janë shpërndarë 858 POS terminale
- Qarkullimi përmes POS ka arritur në 44 milionë euro

Këto rezultate reflektojnë besimin e klientëve dhe aftësinë e bankës për të mbështetur projekte zhvillimore dhe aktivitete ekonomike në shkallë të gjerë.

Zhvillimi i Produkteve

Transformimi digjital ka qenë një ndër prioritetet kryesore gjatë vitit 2025, duke synuar krijimin e një përvoje bankare më të thjeshtë dhe më të aksesueshme për klientët.

Iniciativat kryesore përfshinë:

- Thjeshtimin e dokumentacionit dhe proceseve bankare
- Zhvillimin e produkteve të reja digjitale
- Fushata ndërgjegjëse për përdorimin e Mobile Banking, POS dhe kartelave

Këto masa ndikuan drejtpërdrejt në:

- Rritjen e numrit të klientëve të rinj
- Zgjerimin e depozitave dhe kredive
- Rritjen e përdorimit të shërbimeve online

Lizingu

Lizingu vazhdoi të jetë një segment në rritje dhe një ndër produktet më të kërkuara gjatë vitit 2025, duke u shndërruar në një instrument të rëndësishëm financimi për klientët.

Përmes bashkëpunimeve me kompani ndërtimi dhe biznese të ndryshme, banka ofroi zgjidhje fleksibile për financimin e:

- Automjeteve
- Pajisjeve
- Aseteve të biznesit

Rritja e kërkesës dhe besimi i klientëve ndikuan në forcimin e këtij segmenti dhe në konsolidimin e bankës si një partner i rëndësishëm për investime.

Përmbledhje

Viti 2025 përfaqëson një periudhë të rëndësishme zhvillimi për Bankën Ekonomike, ku të gjitha segmentet kryesore nga klientët individualë, SME-të, korporatat, deri te produktet dhe lizingu kontribuan në rritjen e qëndrueshme dhe forcimin e pozicionit në treg.

Përmes një qasjeje të integruar, të orientuar drejt klientit dhe inovacionit, banka krijoi një bazë të fortë për zhvillim të mëtejshëm dhe përmbushjen e objektivave strategjike në vitet në vijim.

PORTOFOLI KREDITOR

Banka Ekonomike shënoi një performancë të jashtëzakonshme në portofolin kreditor gjatë vitit 2025 si rezultat i strategjisë së përpunuar me kujdes dhe angazhimit për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e klientëve në të gjitha segmentet e biznesit.

Në vitin 2025, Banka vazhdoi të shënojë rritje të qëndrueshme në portofolin kreditor, duke e rritur vlerën e tij nga 501 milionë euro, sa ishte në vitin 2024, në 574 milionë euro. Kjo rritje e madhe është rezultat i një strategjie të qëndrueshme të ofrimit të produkteve kreditore në të gjitha segmentet e tregut. Diversifikimi i portofolit kontribuoi në ruajtjen e stabilitetit dhe në sigurimin e rritjes së qëndrueshme të Bankës në tregun e kredisë.

Me një qasje të orientuar drejt nevojave të klientëve dhe angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e ofertës kreditore, Banka mbetet e pozicionuar për të vazhduar trajektoren e rritjes në vitin 2025 dhe për të konsoliduar më tej pozicionin e vet si një nga liderët në tregun e kredisë.

Segmenti	Ekspozimi kreditor 2023 '000	Përqindja e participimit në vitin 2023	Ekspozimi kreditor 2024 '000	Përqindja e participimit në vitin 2024	Ekspozimi kreditor 2025 '000	Përqindja e participimit në vitin 2025
NVM	124,242	28%	140,746	28%	150,680	26%
Lizing	32,107	7%	40,492	8%	38,723	7%
Korporate	151,978	34%	157,984	32%	200,293	35%
Individe	142,213	32%	161,888	32%	184,504	32%
Totali	450.540	100%	501.110	100%	574.200	100%





KLIENTËT KORPORATË

Viti 2025 shënoi një periudhë të suksesshme dhe të qëndrueshme për Departamentin e Korporatës, me rritje të dukshme në portofolin kreditues, bazën e depozitave, aktivitetin e klientëve dhe efikasitetin operacional. Këto rezultate reflektojnë një strategji të qartë zhvillimi, menaxhim të kujdesshëm të riskut dhe besim të vazhdueshëm nga klientët korporativë dhe institucionalë.

Rritja dhe Menaxhimi i Portofolit

Gjatë vitit 2025, portofoli i kredive shënoi rritje prej 41.3 milionë euro, që përkthehet në një rritje vjetore prej 26.05 përqind. Kjo performancë reflekton kërkesën në rritje për financim dhe aftësinë e bankës për të mbështetur zhvillimin e klientëve të saj pavarësisht rritjes së volumit, Departamenti ka ruajtur një nivel të lartë profesionalizmi dhe efikasiteti, përmes analizës së kujdesshme të riskut dhe përshtatjes ndaj kushteve dinamike të tregut.

Stabiliteti i Depozitave dhe Struktura

Depozitat e klientëve u rritën për 34.6 milionë euro gjatë vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 29.71 përqind krahasuar me vitin paraprak. Struktura e depozitave mbeti e balancuar:

- 35 përqind në llogari rrjedhëse
- 65 përqind në depozita me afat

Kjo strukturë siguron stabilitet financiar dhe fleksibilitet në menaxhimin e likuiditetit, duke optimizuar koston e fondeve.

Norma e Interesit në Portofolin Kreditues

Norma e ponderuar e interesit në portofolin kreditues u rrit me 0.09 përqind, duke reflektuar një strategji të kujdesshme të çmimeve dhe menaxhim efektiv të riskut. Kjo ka ndikuar në ruajtjen e marzhit neto të interesit, duke mbetur konkurruese në treg.

Aktiviteti i Klientëve dhe Qarkullimi

Gjatë vitit 2025, qarkullimi dhe transferet dalëse të klientëve u rritën me 161 milionë euro krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje dëshmon zgjerimin e aktivitetit financiar të klientëve dhe rritjen e besimit ndaj kapaciteteve operationale të bankës.

Disbursimet dhe Financimi

Disbursimet totale u rritën me 39.73 milionë euro gjatë vitit 2025, duke reflektuar aftësinë e bankës për të ofruar zgjidhje fleksibile dhe të personalizuar financimi. Kjo kontribuoi drejtpërdrejt në zgjerimin e portofolit kreditues dhe rritjen e të ardhurave nga interesi.

Zgjerimi i Bazës së Klientëve

Gjatë vitit, Departamenti arriti të hapë mbi 37 llogari të reja, duke zgjeruar më tej praninë e bankës në segmentin korporativ dhe duke forcuar pozicionin e vet në treg.

Cilësia e Portofolit dhe Kredite Joperformuese

Niveli i kredive joperformuese (NPL) arriti në 1.03 përqind në vitin 2025. Edhe pse paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak, ky nivel mbetet i kontrolluar dhe brenda kufijve të menaxhueshëm. Përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe komunikimit proaktiv me klientët, Departamenti vazhdon të fokusohet në ruajtjen e cilësisë së portofolit dhe stabilitetit financiar.

Zgjerimi i Pagesave dhe POS Terminaleve

Gjatë vitit 2025, janë vendosur 858 POS terminale të reja tek klientët, duke rritur kapacitetin për pagesa elektronike dhe duke përmirësuar përvojën e konsumatorëve finalë.

Si rezultat:

- Qarkullimi nga POS terminalet arriti mbi 44 milionë euro
- U rritën të ardhurat nga komisionet
- U përmirësua oferta për bizneset

Përfundim

Performanca e vitit 2025 e pozicionon Departamentin e Korporatës si një nga shtyllat kryesore të rritjes së bankës. Me një portofol të shëndoshë, rritje të qëndrueshme dhe efikasitet të lartë operacional, departamenti hyn në vitet në vijim me një perspektivë të qartë dhe ambicie për të thelluar ndikimin e tij në zhvillimin e bankës dhe mbështetjen e biznesit vendor.



KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Duke marrë parasysh rolin kyç të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zhvillimin ekonomik, gjenerimin e punësimit dhe krijimin e vlerave të reja, gjatë vitit 2025 Banka Ekonomike ka vijuar të mbështesë këtë segment me përkushtim të lartë. Përmes një qasjeje të orientuar drejt klientit dhe besimit në kapacitetet e bizneseve, banka ka siguruar vazhdimësi në kreditim dhe përmirësim të shërbimeve për këtë kategori.

Rritja e portofolit dhe mbështetja financiare

Kjo qasje e fokusuar ka rezultuar me performancë pozitive, ku segmenti ka shënuar rritje prej 10 milionë euro, duke arritur një portofol kreditues prej 150.6 milionë euro në fund të vitit 2025. Një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim ka luajtur edhe fondi garantues, i cili përmes instrumenteve të tij ka lehtësuar qasjen në financa për bizneset, veçanërisht për klientët që përballen me kufizime në sigurimin e kolateralit.

Iniciativa për përfshirje dhe zhvillim

Gjatë vitit 2025, banka ka qenë aktive në iniciativa të rëndësishme për zhvillimin e këtij segmenti, përfshirë pjesëmarrjen në programin e **WE Finance Code në bashkëpunim me Banka Qendrore e Kosovës**.

Në kuadër të kësaj iniciative:

- janë zhvilluar takime të vazhdueshme me palët e interesit,
- janë përditësuar politikat kreditore,
- janë krijuar produkte të dedikuara për gratë ndërmarrëse.

Këto hapa kanë ndikuar në përmirësimin e qasjes në financa dhe në fuqizimin e grave në biznes.

Zgjerimi i infrastrukturës së pagesave

Duke iu përgjigjur kërkesave të tregut dhe nevojave të bizneseve, gjatë vitit 2025 është realizuar një zgjerim i ndjeshëm i rrjetit të pagesave:

- Mbi 1,450 POS terminale të shpërndara në gjithë territorin e Kosovës
- Mbi 38 milionë euro qarkullim i gjeneruar përmes tyre

Ky zhvillim ka mundësuar rritjen e efikasitetit në shitje për bizneset dhe ka përmirësuar ndjeshëm përvojën e konsumatorëve finalë.

Cilësia e portofolit dhe qasja profesionale


Nga aspekti i cilësisë së portofolit, segmenti ka ruajtur stabilitet të lartë, duke mbajtur nivelin e kredive joperformuese brenda parametrave të pranueshëm. Kjo dëshmon për një qasje profesionale dhe të kujdesshme në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e portofolit.

Qasja e integruar ndaj klientit

Përveç kreditimit, segmenti është fokusuar edhe në shitje të tërthorta, duke ofruar një gamë të integruar produktesh dhe shërbimesh bankare. Kjo qasje ka mundësuar adresimin më të plotë të nevojave të klientëve dhe forcimin e marrëdhënieve afatgjata me ta.

Përfundim

Në përgjithësi, performanca e segmentit SME gjatë vitit 2025 reflekton një rritje të qëndrueshme, mbështetje të vazhdueshme për bizneset dhe një pozicionim të fortë në treg. Përkushtimi ndaj inovacionit, përfshirjes financiare dhe cilësisë së portofolit e vendos këtë segment si një ndër kontribuesit kryesorë në zhvillimin e bankës dhe ekonomisë në tërësi.



KLIENTËT INDIVIDUAL

Performanca dhe Zhvillimi i Segmentit

Gjatë vitit 2025, Banka Ekonomike shënoi rezultate të qëndrueshme dhe pozitive në segmentin e klientëve individualë, duke forcuar ndjeshëm pozicionin e saj në treg dhe duke rritur portofolin e kredive dhe depozitave.

Përmes një qasjeje moderne dhe të orientuar drejt klientit, banka arriti jo vetëm të ruajë besnikërinë e klientëve ekzistues, por edhe të tërheqë një numër të konsiderueshëm klientësh të rinj. Kjo është arritur përmes zhvillimit të produkteve të personalizuar dhe ofertave të përshtatura për profile dhe nevoja të ndryshme financiare.

Fokusi i vazhdueshëm në zhvillim dhe përmirësimin e përvojës së klientit ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e angazhimit dhe përdorimit të shërbimeve bankare. Falë këtij angazhimi, mijëra klientë të rinj i janë bashkuar Bankës Ekonomike gjatë vitit 2025.

Zhvillimi i Produkteve dhe Angazhimi i Klientëve

Gjatë vitit 2025, një rol të rëndësishëm në arritjen e rezultateve ka luajtur përmirësimi i vazhdueshëm i produkteve ekzistuese dhe lansimi i ofertave të reja inovative.

Përmes kampanjave të targetuara dhe aktiviteteve promovuese:

- klientët përfituan kushte konkurruese në produkte kreditore dhe depozituese,
- u rrit ndërgjegjësimi për ofertat e bankës,
- dhe u forcua lidhja afatgjatë me klientët.

Një nga iniciativat më të dalluara ishte organizimi i lojës shpërblyese për depozita me afat, ku çmimi kryesor ishte një banesë në Prishtinë, duke rritur ndjeshëm interesimin dhe pjesëmarrjen e klientëve.

Rezultatet Kryesore

Performanca e Departamentit të Klientëve Individualë gjatë vitit 2025 reflektohet në rritje konkrete të indikatorëve kryesorë:


- Numri i llogarive rrjedhëse u rrit me +11,543,
- Portofoli i kredive për individë u rrit me +22.851 milionë Eur,
- Depozitat shënuan rritje prej +66.571 milionë Eur.

Këto rezultate dëshmojnë një trend të qëndrueshëm rritjeje dhe konfirmojnë besimin e klientëve në bankë si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Bashkëpunimi i Brendshëm dhe Efikasiteti

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet degëve dhe departamenteve ka qenë faktor kyç në realizimin e objektivave strategjike. Ky koordinim ka mundësuar një qasje më të unifikuar ndaj klientit dhe ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e portofolit të kredive dhe depozitave.

Në tërësi, viti 2025 konfirmon përkushtimin e Bankës Ekonomike për të qenë zgjedhja e parë për klientët individualë dhe një partner i besueshëm financiar.



KANALET E DISTRIBUIMIT DHE RRJETI I DEGËVE

Zgjerimi dhe Modernizimi i Rrjetit

Gjatë vitit 2025, Banka Ekonomike ka vazhduar investimet në modernizimin e rrjetit të saj fizik dhe në përmirësimin e përvojës së klientit në degë.

Në fund të vitit, rrjeti përbëhej nga 36 degë, prej të cilave 7 degë kryesore dhe 29 nëndegë, duke siguruar mbulim të gjerë dhe akses të lehtë për klientët në të gjithë territorin.

Modernizimi i degëve përfshiu:

- krijimin e hapësirave më funksionale dhe komode për klientët,
- pajisjen me teknologji të avancuar bankare,
- dhe zhvillimin profesional të stafit front-line për ofrim më cilësor të shërbimeve.

Zhvillimi i Infrastrukturës – Bankomatet dhe POS

Numri i degëve në tregun bankar




FIGURA 12
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar

Bankomatët

Në vitin 2025 u shënua një rritje e dukshme në numrin e bankomatëve dhe përdorimin e tyre:


- Rritja e numrit të bankomatëve: numri i bankomatëve u rrit në 67 njësi në të gjithë territorin e Kosovës.

Kjo rritje tregon avancimin e infrastrukturës së pagesave dhe orientimin drejt lehtësimit të qasjes për klientë.

POS Terminalet

Në vazhdimësi të investimeve të filluara në vitet e mëparshme, Banka Ekonomike ka zgjeruar rrjetin e POS terminaleve, duke u fokusuar në teknologji të përditësuar, efikasitet dhe mbështetje të vazhdueshme për bizneset në vend.

- **Numri total i POS Terminaleve në fund të vitit 2025: Mbi 2000**



KANALET ALTERNATIVE TË SHËRBIMIT - QENDRA E THIRRJEVE

Qendra e Thirrjeve ka qenë një ndër shtyllat kryesore në përmirësimin e përvojës së klientit gjatë vitit 2025.

Përmes investimeve në teknologji dhe në trajnim të stafit, është arritur:

- Menaxhim efikas i një numri të konsiderueshëm thirrjesh dhe kërkesash,
- Përmirësim i kohës së përgjigjes,
- Rritje e cilësisë në trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave, dhe ofrim i mbështetjes së vazhdueshme 24/7 për klientët.

Përfundim

Departamenti për Klient Individualë dhe zhvillimi i kanaleve të shpërndarjes gjatë vitit 2025 kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e qëndrueshme të Bankës Ekonomike.

Këto zhvillime kontribuan në forcimin e :

- afërsisë me klientët,
- efikasitetit operacional,
- dhe pozicionit konkurrues të bankës në treg.



LIZINGU

Gjatë vitit 2025, shërbimi i lizingut ka vazhduar të zhvillohet me ritëm të qëndrueshëm, duke reflektuar përkushtimin e bankës për të ofruar alternativa financimi fleksibile dhe konkurruese për klientët. Zgjerimi i gamës së produkteve dhe thellimi i bashkëpunimit me kompanitë e ndërtimit dhe autosallonet kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kërkesës për financim përmes lizingut.

Kjo qasje ka mundësuar shfrytëzim më të madh të potencialit të tregut, duke tërhequr klientë të rinj dhe duke forcuar marrëdhëniet me klientët ekzistues.

Performanca dhe zhvillimi i portofolit

Gjatë vitit 2025, fokusi kryesor ka qenë ruajtja e cilësisë së portofolit aktiv të lizingut. Kjo ka ndikuar që rritja të jetë më e moderuar krahasuar me vitet paraprake, por gjithsesi pozitive dhe e qëndrueshme.

- Klientët individualë kanë shënuar rritje prej 15%
- Numri i kontratave të lizingut është rritur për 7%

Portofoli aktiv i lizingut në fund të vitit 2025 ka arritur në 38.72 milion euro, i shpërndarë sipas segmenteve si më poshtë:

Segmenti	Vlera
Klientët korporatë	12.55 milionë
NVM	21.14 milionë
Klientët individualë	5.03 milionë

Këto rezultate pasqyrojnë një strukturë të balancuar të portofolit dhe një prani të qëndrueshme në të gjitha segmentet kryesore të tregut.

Faktorët e suksesit

Rritja e qëndrueshme e lizingut është rezultat i disa faktorëve kyç:

- zgjerimit të vazhdueshëm të produkteve financiare,
- forcimit të partneriteteve strategjike,
- orientimit të qartë drejt nevojave të klientëve,
- dhe përkushtimit të vazhdueshëm të ekipit në ofrimin e shërbimeve cilësore.

Këta elementë kanë kontribuar në ndërtimin e një baze solide besimi me klientët dhe në rritjen e konkurrueshmërisë në treg.

Perspektiva për të ardhmen

Duke marrë parasysh trendin pozitiv dhe potencialin në rritje të këtij segmenti, Banka synon të vazhdojë investimet në zhvillimin e mëtejshëm të lizingut. Fokus i veçantë do të mbetet zgjerimi i ofertës, rritja e fleksibilitetit të produkteve dhe përshtatja me nevojat në ndryshim të klientëve.

Në këtë drejtim, lizingu pritet të mbetet një ndër shtyllat e rëndësishme të financimit, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme dhe në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të klientëve.

ZHVILLIMI I SIGURIMEVE DHE BANCASSURANCE

Partneriteti Strategjik me KS Siguria

Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi ndërmjet Bankës Ekonomike dhe KS Siguria është konsoliduar më tej në një partneritet strategjik të strukturuar dhe të qëndrueshëm. Ky bashkëpunim reflekton një qasje të harmonizuar drejt rritjes së efikasitetit operativ dhe zgjerimit të ofertës së përbashkët të produkteve financiare dhe të sigurimeve.

Të dy institucionet kanë dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në ndërtimin dhe përmirësimin e proceseve funksionale, duke integruar ekspertizën dhe kapacitetet përkatëse me qëllim krijimin e vlerës së shtuar për klientët. Si rezultat, gjatë vitit 2025 janë arritur objektivat e përcaktuara në strategjinë e sinergjisë, duke konfirmuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij modeli bashkëpunimi në afatgjatë.

Qasja e unifikuar në zhvillimin e produkteve dhe realizimin e kampanjave ka kontribuar në forcimin e pozitës së të dy institucioneve në tregun financiar dhe atë të sigurimeve.

Integrimi i Produkteve dhe Ofertës së Përbashkët

Gjatë vitit raportues, produktet e KS Siguria u integruan në mënyrë të vazhdueshme në ofertat dhe kampanjat promociionale të Bankës Ekonomike, duke u bërë pjesë përbërëse e paketave bankare.

Kjo qasje e koordinuar mundësoi krijimin e një oferte të balancuar dhe konkurruese, e cila jo vetëm rrit përfitimet për klientët, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e përvojës së tyre. Produktet e sigurimeve janë përfshirë edhe në kampanja shpërblyese, si për klientët ashtu edhe për stafin, duke zgjeruar ndikimin e bashkëpunimit përtej dimensionit komercial.

Ky nivel i integritit përbën një bazë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve të ndërlidhura dhe për krijimin e zgjidhjeve inovative në të ardhmen.


Zhvillimet e Planifikuara për Vitin 2026

Në vitin 2026, Banka Ekonomike synon të realizojë një hap strategjik të rëndësishëm përmes licencimit si ndërmjetësues në sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës.

Ky zhvillim përfaqëson një zgjerim të natyrshëm të aktivitetit të bankës dhe pritet të kontribuojë në:

- ofrimin e zgjidhjeve më të plota dhe të personalizuar për klientët,
- përmirësimin e përvojës së klientit përmes një modeli të integruar “one-stop-shop”,
- diversifikimin e burimeve të të ardhurave,
Në përputhje me strategjinë afatgjatë të kompanisë dhe rolin e saj në mbështetjen e bizneseve si punëdhënësit kryesorë në vend gjatë vitit 2025, KS “Siguria” ka vazhduar të fokusohet në adresimin e nevojave të klientëve dhe në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme për rritje dhe zhvillim të përbashkët. Paralelisht me segmentin e bizneseve, kompania ka forcuar prezencën edhe në segmentin retail, duke synuar rritjen e aksesit dhe përmirësimin e përvojës së klientëve përmes zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të degëve.

Një hap i rëndësishëm strategjik ka qenë integrimi i shërbimeve në rrjetin e Banka Ekonomike, duke mundësuar ofrimin më të lehtë dhe më efikas të produkteve të sigurimit për klientët ekzistues dhe potencialë.

Gjatë vitit 2025, kompania ka shënuar rritje të qëndrueshme në performancën financiare.

Primet e shkruara bruto arritën në 14.801, duke reflektuar një rritje prej rreth 2% krahasuar me vitin 2024 (14.460). Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga segmenti i sigurimeve të detyrueshme, i cili ka shënuar rritje prej 15%, ndërsa sigurimet vullnetare kanë kontribuar me një rritje prej 8% krahasuar me vitin paraprak.

Struktura e portofolit tregon një dominim të sigurimeve të detyrueshme, të cilat u rritën nga 6.989 në 8.006, ndërsa sigurimet vullnetare u rritën nga 5.137 në 5.555, duke reflektuar një diversifikim gradual dhe të qëndrueshëm të produkteve.

Në nivel produktesh, rritje të konsiderueshme janë shënuar në:

- sigurimet shëndetësore dhe të aksidenteve,
 - sigurimet kasko,
 - si dhe sigurimet e pronës dhe garancive,
- duke dëshmuar orientimin e kompanisë drejt produkteve me vlerë më të lartë dhe kërkesë në rritje.


Si rezultat i kësaj performance, KS “Siguria” ka arritur pjesëmarrje tregu në nivelin 8.7 përqind për vitin 2025, duke konsoliduar pozitën e saj në industrinë e sigurimeve.

Në aspektin e menaxhimit të dëmeve, kompania ka vazhduar trendin pozitiv në përmbushjen e obligimeve ndaj klientëve. Dëmet e paguara arritën në 6.171 në vitin 2025, krahasuar me 5.760 në vitin 2024, duke reflektuar një rritje prej rreth 7 përqind. Ky tregues konfirmon përkushtimin e kompanisë për trajtim të shpejtë dhe të drejtë të kërkesave për dëmshpërblim. Gjithashtu, KS “Siguria” mban një pjesëmarrje të lartë në tregun e dëmeve të paguara, në nivelin 7.3 përqind, duke dëshmuar besueshmërinë dhe stabilitetin e saj financiar.

Përtej performancës financiare, kompania ka vazhduar të investojë në zhvillimin e tregut përmes fushatave të synuara për sigurimet shëndetësore, të pronës dhe produkteve të tjera vullnetare.



PORTOFOLI I KS 'SIGURIA' ËSHTË I RISIGURUAR NGA RISIGURUESIT REPUTABILË, ME STABILITET FINANCIAR DHE KREDIBILITET NË TREGJET E RISIGURUESVE NË EVROPË.




Porofolio e Sigurimeve te Detyrueshme dhe Vullnetare 2025/2024

■ Viti 2024 ■ Viti 2025

Porofolio e Sigurimeve Vullnetare 2025/2024


■ Viti 2024 ■ Viti 2025



PJESËMARRJA NË TREG

KS 'SIGURIA' shënoi rritje të lehte të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2025 me rreth 2 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak 2024. Referuar primeve të shkruara bruto, KS 'SIGURIA' ka pjesëmarrje në nivelin 8.7 përqind në tregun e sigurimeve për vitin 2025.


Primet e Shkruara 2025/2024



Primet e
Shkruara Bruto
2024

Primet e
Shkruara Bruto
2025

Primet Vullnetare 2025/2024



Primet
Vullnetare
2024


Primet
Vullnetare
2025

Rritja e primeve përgjatë vitit 2025 rezulton kryesisht tek primet e detyrueshme, me 15 përqind realizim më shumë se viti paraprak 2024, ndërsa rritja tek primet vullnetare me 8 përqind më shumë se viti i kaluar 2024. KS 'SIGURIA' vazhdon të ketë trend qëndrueshëm të pjesëmarrjes në treg, në 7.5 përqind për vitin 2025, në primet vullnetare.

DËMET

KS 'SIGURIA' edhe përgjatë vitit 2025 vazhdoi trendin e njëjtë në përmbushjen e pagesave të dëmeve për palët e zhdëmtuara, apo me një rritje prej 7 përqind krahasuar me vitin e kaluar 2024.

Dëmet e pagura 2025/2024



KS 'SIGURIA' vazhdon të ketë pjesëmarrje të lartë të dëmeve të paguara në nivelin 7.3 përqind në gjithsej tregun e sigurimeve për vitin 2025.

RRITJE E KONSOLIDUAR, RRITJE E BESIMIT DHE TRANSFORMIM I QËNDRUESHËM

Gjatë vitit 2025, KS "SIGURIA" ka vazhduar të konsolidojë dhe zgjerojë në mënyrë të qëndrueshme bazën e saj të klientëve, duke arritur në gjithsej 69,285 klientë aktivë në portofol. Kjo shifër përfaqëson një zhvillim cilësor të marrëdhënies me klientët, duke reflektuar besimin e tyre në shërbimet dhe produktet e kompanisë. Struktura e portofolit paraqitet e balancuar, ku 62 përqind i përkasin sigurimeve të detyrueshme, ndërsa 38 përqind sigurimeve vullnetare, duke treguar një zhvendosje graduale drejt produkteve me vlerë të shtuar dhe një ndërgjegjësim në rritje të klientëve për rëndësinë e mbrojtjes financiare përtej detyrimeve ligjore. Ky zhvillim është rezultat i një qasjeje të qëndrueshme strategjike, e cila synon edukimin e tregut dhe promovimin e kulturës së sigurimit në vend.

Portofoli i kompanisë mbështetet nga partneritete të forta të cilat garantojnë kapacitet të mjaftueshëm për përballimin e rreziqeve dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj klientëve në çdo situatë. Kjo strukturë mbështetëse jo vetëm që rrit stabilitetin financiar të kompanisë, por gjithashtu forcon ndjeshëm besimin e klientëve dhe partnerëve në qëndrueshmërinë afatgjatë të saj.

Në thelb, zhvillimi i portofolit gjatë vitit 2025 reflekton një kombinim të:

- rritjes së qëndrueshme të bazës së klientëve,
- diversifikimit të produkteve,
- dhe forcimit të kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut.

Këto elemente së bashku krijojnë një bazë solide për zgjerim të mëtejshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të ofertës në vitet në vijim.



DEPARTAMENTI I SHITJES DHE MARRJES NË SIGURIM

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Shitjes dhe Marrjes në Sigurim ka qenë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të kompanisë, duke reflektuar një qasje të qartë drejt transformimit, fleksibilitetit dhe orientimit të plotë ndaj klientit. Kompania ka vazhduar të investojë në përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve, si dhe në zgjerimin e ofertave digjitale, me synimin për të krijuar një përvojë sa më të avancuar dhe të lehtë për klientët.

Ky departament ka përjetuar një vit dinamik, duke shënuar një rritje prej 12 përqind, e cila është rezultat i drejtpërdrejtë i përmirësimit të proceseve të brendshme, integritit të teknologjive të reja dhe zgjerimit të vazhdueshëm të portofolit të klientëve. Kjo rritje është dëshmi e efektivitetit të strategjive të zbatuara dhe angazhimit të stafit në arritjen e objektivave.

Viti 2025 shënoi gjithashtu një moment të rëndësishëm historik për kompaninë, duke arritur nivelin më të lartë të primeve që nga themelimi. Ky rezultat është arritur falë një kombinimi faktorësh që përfshijnë:

- ofertat e strukturuar sipas nevojave reale të klientëve,
- shërbimet e personalizuara,
- dhe përpunimin e shpejtë dhe efikas të kërkesave.

Rritja e bazës së klientëve, si në segmentin individual ashtu edhe në atë biznesor, është dëshmi e qartë e besimit të ndërtuar dhe e qasjes së orientuar drejt cilësisë dhe transparencës. Synimi për vitin 2026 është të ruhet dhe të tejkalohet ky trend pozitiv, duke u fokusuar në inovacion, zgjerim të tregut dhe përmirësim të mëtejshëm të shërbimeve. Ne linje me këtë, klientëve tanë si individual ashtu dhe biznesor ju kemi kushtuar vëmendje dhe rendësi të veçantë përmes ofertave atraktive, shërbimeve të personalizuar si dhe prosedimit të shpejtë të kërkesave të klientëve.

Pavarësisht sfidave të mjedisit makroekonomik dhe rritjes së çmimeve, departamenti ka ruajtur stabilitet dhe ka vazhduar të avancojë, duke riafirmuar pozitën e kompanisë në treg, duke treguar një trend shumë pozitiv të rritjes ku nga viti 2025 ne raport me vitin paraprak u shënuar një rritje prej 12 përqind, rritje. Në këtë kontekst, prioritetet për të ardhmen janë të qarta dhe të fokusuar në:

- inovacion të vazhdueshëm,
- automatizim të proceseve,
- dhe zgjerim të mëtejshëm të prezencës në treg.

Kjo qasje synon jo vetëm ruajtjen e trendit pozitiv, por edhe ngritjen e standardeve të shërbimit në një nivel edhe më të lartë.

SIGURIMI I SHËNDETIT DHE AKSIDENTEVE

Sigurimi i shëndetit gjatë vitit 2025 ka vazhduar të jetë një nga segmentet më të rëndësishme dhe me ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të kompanisë. Ky departament ka shënuar rritje të dukshme në numrin e klientëve, duke reflektuar rritjen e interesimit për produkte që lidhen drejtpërdrejt me mirëqenien dhe sigurinë financiare.

Ky segment ka luajtur rol thelbësor në mbështetjen e mijëra individëve dhe familjeve, duke ofruar mbulim të zgjeruar dhe procese të thjeshtuara që e bëjnë qasjen në shërbimet mjekësore më të shpejtë dhe më efikase. Përmirësimi i vazhdueshëm i përvojës së klientit ka qenë në fokus, duke siguruar që çdo shërbim të jetë sa më i qartë, i lehtë dhe i besueshëm.

Duke qenë se shëndeti është primar, kompania përgjatë vitit 2025 i ka kushtuar rëndësi të veçantë plotësimit të kërkesave të klientëve të cilat dalin nga sigurimi shëndetësor. Në përputhje me strategjinë për të qenë sa më afër klientëve, gjatë vitit është zhvilluar një kampanjë e strukturuar me tre paketa sigurimi shëndetësor, të cilat ofrojnë:

- tarifa të përshtatura,
- mbulime fleksibile,
- dhe zgjidhje konkrete për kategori të ndryshme klientësh.

Si rezultat i kësaj qasjeje, është arritur një pjesëmarrje në treg prej 5 përqind, duke reflektuar rritjen e besimit dhe pranueshmërisë së produkteve. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ka qenë zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet shëndetësore private, duke rritur cilësinë dhe gamën e shërbimeve të ofruara. Paralelisht, janë iniciuar projekte për digjitalizimin e shërbimeve, të cilat do të mundësojnë që në të ardhmen klientët të marrin shërbime online, duke kursyer kohë dhe duke rritur efikasitetin.



SIGURIMI I PRONAVE DHE GARANCIONEVE

Gjatë vitit 2025, ky departament ka dhënë një kontribut të rëndësishëm të palëkundur në rritjen e primit dhe rritjen e përgjithshme të kompanisë, duke u fokusuar në forcimin e politikave të sigurimit dhe në zgjerimin e bazës së klientëve, veçanërisht në segmentin e bizneseve.

Sigurimi i pronës ka qenë një element kyç në mbrojtjen e pasurisë së klientëve nga rreziqet e paparashikuara, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe të besueshme.

Përmirësimi i proceseve të vlerësimit dhe trajtimit të dëmeve ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe në përforcimin e marrëdhënies me klientët.

Investimet në teknologji dhe analiza të avancuara të rrezikut na kanë mundësuar të rrisim efikasitetin dhe transparencën në proceset tona. Siguria e pronës suaj mbetet prioriteti ynë kryesor, duke ndërtuar një të ardhme më të sigurt për të gjithë Marrë parasysh rëndësinë e bizneseve për ekonominë e Kosovës, në kuptim të gjenerimit të punësimit dhe krijimi të vlerave të reja, K.S. SIGURIA, në masë të madhe u përkujdes që këtij trageti grupi t'i ofrojë shërbime sa me cilësore në kuptim të nevojave të tyre.

Një nga iniciativat më të rëndësishme ka qenë implementimi i konceptit “One stop shop”, përmes të cilit klientëve u është mundësuar të kryejnë shërbime në mënyrë të centralizuar në degët e Bankës Ekonomike. Kjo qasje ka:

- thjeshtuar proceset,
- kursyer kohën e klientëve,
- dhe rritur efikasitetin operacional.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve, është arritur një pjesëmarrje në treg prej 4.47 përqind, duke reflektuar ndikimin pozitiv të strategjive të zbatuara dhe fokusin në nevojat reale të tregut.

SIGURIMET KASKO

Sigurimet KASKO gjatë vitit 2025 kanë qenë në fokus të veçantë, si pjesë e strategjisë për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të ofruar mbulim më të plotë për klientët.

Në bashkëpunim me Bankën Ekonomike dhe partnerët afaristë, janë zhvilluar kampanja të shumta që kanë rritur ndjeshëm interesimin për këtë produkt.

Përmirësimet në proceset e trajtimit të dëmeve dhe përdorimi i teknologjisë kanë kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe në forcimin e besimit të klientëve.

Gjithashtu, kompania ka investuar në:

- rritjen e kapaciteteve njerëzore,
- zhvillimin e proceseve teknologjike,
- dhe përmirësimin e shërbimeve të personalizuar.

Si rezultat, është arritur një pjesëmarrje në treg prej 12.35 përqind, duke konfirmuar rëndësinë strategjike të këtij segmenti dhe potencialin e tij për zhvillim të mëtejshëm.



SIGURIMI I AUTOPËRGJEGJËSISË (TPL)

Sigurimi TPL gjatë vitit 2025 ka vazhduar të jetë një nga shtyllat më të rëndësishme të portofolit të kompanisë, duke garantuar mbrojtje për një numër të madh drejtuesish mjetesh dhe duke kontribuar në sigurinë në komunikacion.

Rritja e numrit të policave dhe përmirësimi i proceseve të menaxhimit të dëmeve kanë bërë të mundur ofrimin e një shërbimi më të shpejtë dhe më transparent.

Investimet në teknologji dhe optimizimi i proceseve kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e kohës së trajtimit dhe në rritjen e kënaqësisë së klientëve. Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe zgjerimi i rrjetit të shitjes, duke ofruar qasje më të lehtë për klientët në shërbimet e kompanisë dhe duke rritur prezencën në treg.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve:

- është shënuar një rritje prej 15.40 përqind,
- dhe një pjesëmarrje në treg prej 8.7 përqind,

duke reflektuar suksesin e strategjive të zbatuara dhe angazhimin e vazhdueshëm për përmirësim dhe zhvillim.

Përmes:

- investimeve të vazhdueshme në teknologji
- zgjerimit të gamës së produkteve
- përmirësimit të proceseve të brendshme
- dhe rritjes së kapaciteteve profesionale

kompania ka krijuar një bazë solide për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Ky progres nuk reflekton vetëm rezultate financiare pozitive, por edhe një transformim të thellë në mënyrën se si kompania operon, ndërton marrëdhënie me klientët dhe kontribuon në zhvillimin e tregut të sigurimeve në Kosovë.



DEPARTAMENTI I DËMEVE

Efikasitet më i lartë, procese më të shpejta dhe fokus i vazhdueshëm tek klienti

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Dëmeve ka shënuar progres të rëndësishëm në përmirësimin e proceseve operative dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve. Përmes një qasjeje të strukturuar dhe orientimit drejt efikasitetit, është arritur një transformim i dukshëm në mënyrën e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim.

Një ndër arritjet kryesore ka qenë reduktimi i kohës mesatare të trajtimit të dëmeve, falë optimizimit të procedurave të brendshme dhe koordinimit më të mirë ndërmjet ekipeve. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e shpejtësisë së reagimit dhe në përmirësimin e përvojës së klientëve gjatë gjithë procesit.

Në aspektin e performancës, gjatë vitit 2025 është shënuar rritje e qëndrueshme në trajtimin dhe pagesën e dëmeve:

- numri i dëmeve të paguara është rritur me 13.96 përqind krahasuar me vitin 2024
- vlera e dëmeve të paguara është rritur me 8.28 përqind

Këto rezultate reflektojnë efektivitetin e strategjive të ndërmarra, përfshirë digjitalizimin e proceseve dhe fokusin e shtuar në nevojat reale të klientëve të dëmtuar. Rritja e volumit të dëmeve të trajtuara, e shoqëruar me ruajtjen e cilësisë së shërbimit, dëshmon për kapacitetin operacional dhe përkushtimin e departamentit.

Në kuadër të digjitalizimit, është zbatuar me sukses platforma online për paraqitjen dhe trajtimin e dëmeve shëndetësore. Ky zhvillim ka sjellë përfitime të rëndësishme:

- thjeshtim të procedurave për klientët
- rritje të transparencës dhe saktësisë në trajtimin e rasteve
- ulje të ngarkesës administrative për personelin
- përmirësim të ndjeshëm të efikasitetit operacional

Përmes këtyre inovacioneve, procesi është bërë më i shpejtë, më i qartë dhe më i qasshëm për të gjithë klientët.

Nga perspektiva e kënaqshmërisë së klientëve, gjatë vitit 2025 është vërejtur përmirësim i dukshëm, si rezultat i komunikimit më të shpejtë, përgjigjeve më të sakta dhe trajtimit profesional të çdo kërkesë. Angazhimi i personelit ka qenë kyç në këtë drejtim. Kjo është arritur duke respektuar standardet e cilësisë dhe afatet e përcaktuara, si dhe duke ndërtuar një raport më të besueshëm me klientët.

Analiza sipas kategorive të dëmeve tregon një avancim të qartë në të gjitha segmentet:

- Dëmet shëndetësore janë trajtuar më shpejt dhe me më shumë transparencë, falë implementimit të databazave të reja dhe proceseve të digjitalizuara
- Dëmet materiale kanë përfituar nga standardizimi i proceseve dhe bashkëpunimi më efikas me palët relevante, duke përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes
- Dëmet jomateriale janë menaxhuar me një qasje më të strukturuar dhe konsistente, veçanërisht në rastet komplekse, duke rritur besueshmërinë e procesit

Ky progres i gjithanshëm tregon një maturim të dukshëm të funksionit të menaxhimit të dëmeve dhe një orientim të qartë drejt praktikave moderne dhe efikase.

Në tërësi, krahasimi ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 dëshmon për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar, ku rritja e volumit është shoqëruar me përmirësim të cilësisë dhe transparencës.

Departamenti ka arritur të përmbushë objektivat për vitin 2025 dhe ka ndërtuar një bazë të fortë për avancime të mëtejshme. Ky progres vendos themelet për një menaxhim edhe më efikas të dëmeve në të ardhmen, duke synuar gjithmonë ofrimin e një shërbimi të shpejtë, transparent dhe të besueshëm për çdo klient.



SINERGJIA MES KS SIGURIA DHE BANKËS EKONOMIKE, NJË SIGURI E PËRGJITHSHME SHOQËRORE

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Marketingut ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar zhvillimin e aktiviteteve të tij, duke u fokusuar në ndërtimin afatgjatë të brendit, rritjen e prezencës në treg dhe forcimin e lidhjes me klientët. Ky vit nuk ka qenë thjesht një vazhdimësi e praktikave të mëparshme, por një thellim i mëtejshëm i tyre, duke i zhvilluar në përputhje me dinamikën e reja të tregut dhe pritshmëritë gjithnjë në rritje të klientëve.

Një nga elementet më të rëndësishme të këtij zhvillimi ka qenë vazhdimi i menaxhimit të marketingut për KS Siguria si pjesë integrale e funksionit të Departamentit të Marketingut të Bankës Ekonomike. Kjo përgjegjësi, e marrë në vitet e kaluara, gjatë vitit 2025 është konsoliduar dhe avancuar ndjeshëm, duke krijuar një bashkëveprim të natyrshëm dhe efikas ndërmjet dy institucioneve. Ky bashkëpunim ka mundësuar jo vetëm përdorimin më të mirë të resurseve dhe ekspertizës, por edhe ndërtimin e një komunikimi të unifikuar dhe të qëndrueshëm në të gjitha kanalet, duke rritur ndikimin dhe koherencën e mesazheve të brendit.

Në këtë kuadër, zhvillimit të saj KS Siguria ka vijuar si një proces dinamik dhe i vazhdueshëm.

Përtej krijimit të një identiteti vizual të konsoliduar, gjatë vitit 2025 është punuar në mënyrë të thelluar në mënyrën se si ky identitet komunikohet dhe perceptohet nga publiku.

Të gjitha materialet promovuese, prezenca në degë, komunikimi digjital dhe aktivitetet në terren janë harmonizuar për të reflektuar një imazh modern, profesional dhe të besueshëm.

Një rol kyç në këtë drejtim ka luajtur zhvillimi i vazhdueshëm i prezencës digjitale, veçanërisht në rrjetet sociale. Menaxhimi i përmbajtjes në platforma si Instagram është trajtuar si një proces strategjik dhe jo thjesht operativ. Rrjetet Sociale janë riorganizuar dhe rifreskuar vazhdimisht, duke ndjekur trendet bashkëkohore të dizajnit dhe komunikimit vizual, ndërsa përmbajtja është përshtatur për të qenë më e afërt, më informative dhe më interaktive për audiencën. Kjo ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e angazhimit, në zgjerimin e audiencës dhe në krijimin e një lidhjeje më të fortë emocionale me klientët.

Strategjia e marketingut gjatë vitit 2025 ka qenë e ndërtuar mbi një kombinim të balancuar ndërmjet komunikimit digjital dhe aktiviteteve fizike në terren. Kjo qasje ka siguruar që mesazhet e institucionit të arrijnë në mënyrë efektive tek grupe të ndryshme të audiencës, duke krijuar një prezencë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në treg.

Fushatat promovuese, aktivitetet ndërgjegjësuëse dhe bashkëpunimet strategjike kanë kontribuar në rritjen e dukshmërisë dhe në forcimin e reputacionit të KS Siguria si një institucion i besueshëm dhe i orientuar drejt klientit.

Aktivitetet Kryesore të Marketingut dhe Përgjegjësisë Sociale

Angazhimi i Departamentit të Marketingut gjatë vitit 2025 nuk është kufizuar vetëm në promovimin e produkteve dhe shërbimeve, por ka përfshirë në mënyrë aktive edhe iniciativa me ndikim social, edukativ dhe komunitar, duke reflektuar një qasje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme:

- **Menaxhimi dhe zhvillimi i përmbajtjes në Instagram**

Gjatë vitit është realizuar një transformim i plotë i qasjes ndaj përmbajtjes digjitale, duke përfshirë strukturimin e feed-it, krijimin e identitetit vizual të qëndrueshëm dhe ndërtimin e një narrative të qartë komunikimi. Përmbajtja është planifikuar në mënyrë strategjike për të balancuar informacionin, edukimin dhe promovimin, duke krijuar një eksperiencë më të pasur dhe më tërheqëse për ndjekësit. Kjo ka rezultuar në rritje të ndjeshme të ndërveprimit dhe besnikërisë së audiencës.

- **Donacion për kopshtin “Yllkat”**

Përmes këtij donacioni janë përmirësuar kushtet infrastrukturore dhe ambientale për fëmijët, duke kontribuar në krijimin e një hapësire më të sigurt, më funksionale dhe më të përshtatshme për zhvillimin e tyre. Ky aktivitet reflekton angazhimin e institucionit për të investuar në komunitet dhe në të ardhmen e brezave të rinj.

- **Ligjëratë edukative në shkollën fillore “Helena Gjika”**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Higjienës, është organizuar një aktivitet edukativ me nxënësit, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit për praktikatat e shëndetshme të jetesës. Kjo iniciativë ka kontribuar në edukimin e brezave të rinj dhe në ndërtimin e një kulture më të fortë të kujdesit për shëndetin.

- **Aktiviteti i dhurimit të gjakut nga stafi i KS Siguria**

Ky aktivitet ka përfaqësuar një shembull konkret të solidaritetit dhe përgjegjësisë sociale, duke inkurajuar njëkohësisht edhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e kontributeve individuale në shpëtimin e jetëve.

- **Fushata sensibilizuese për muajin e kancerit të gjirit**

Përmes kësaj fushate është synuar rritja e vetëdijes për diagnostikimin e hershëm dhe rëndësinë e kontrolleve të rregullta. Aktivitetet kanë përfshirë komunikim të gjerë në rrjete sociale dhe ndërgjegjësim publik, duke kontribuar në informimin dhe edukimin e komunitetit.

- **Mbështetja e Forumit Ekonomik të Brezovicës 2025**

Pjesëmarrja në këtë forum ka forcuar pozicionin e institucionit në diskutimet ekonomike dhe ka krijuar mundësi për bashkëpunime të reja strategjike me aktorë të rëndësishëm të tregut.

- ***Mbështetja e shoqatës Doën Syndrome Kosova***

Kjo mbështetje vazhdon si një iniciativë e qëndrueshme dhe afatgjatë, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve dhe në rritjen e mundësive për fëmijët me sindromën Doën, si dhe në sensibilizimin e shoqërisë për përfshirje më të madhe sociale.

- ***Mbështetja e shoqatës së Autizmit***

Përmes kësaj iniciative është synuar rritja e ndërgjegjësimin dhe mbështetja për individët dhe familjet e prekura nga autizmi, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

- ***Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar “Prishtina 2025”***

Kjo pjesëmarrje ka shërbyer si një platformë e rëndësishme për prezantimin e produkteve dhe shërbimeve, krijimin e kontakteve të reja dhe forcimin e marrëdhënieve me partnerët ekzistues. Prezenca në panair ka reflektuar profesionalizmin dhe ambicien për zgjerim të mëtejshëm në treg.

Në tërësi, viti 2025 ka përfaqësuar një fazë të avancuar të zhvillimit të marketingut, ku fokusi nuk ka qenë vetëm në rritjen e dukshmërisë, por në ndërtimin e një identiteti të qëndrueshëm dhe të besueshëm, në krijimin e përvojave më të mira për klientët dhe në ndërtimin e një lidhjeje të fortë me komunitetin. Përmes një qasjeje të integruar dhe të orientuar drejt së ardhmes, Departamenti i Marketingut ka vendosur baza të forta për zhvillime edhe më të mëdha në vitet në vijim.

BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat Individuale Financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

**për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)**

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet

Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Parasë

Shënime për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Banka Ekonomike Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat individuale financiare të Banka Ekonomike Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën individuale të rrjedhës së pasasë për vitin që përfundon dhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat individuale financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e pasasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmblusur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 2(a) të pasqyrave individuale financiare shoqëruese, këto pasqyra individuale financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën në përmblusjen e kërkesave të Bankës Qendrore të Kosovës për raportim financiar dhe mund të mos jenë të përshtatshme për t'u përdorur për qëllime të përgjithshme, përveç nëse ato lexohen së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara.

Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING



RSM KOSOVO SH.P.K.
Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja B-C,
Kati 2, No.B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo
DL +383 45 666 888
www.rsm.global/kosovo

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Bankës, por nuk përfshijnë pasqyrat individuale financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Bankës pritët të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat individuale financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave individuale financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuara më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat individuale financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Individuale Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave individuale financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave individuale financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat individuale financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra individuale financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave individuale financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat individuale financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë.
Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave individuale financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat individuale financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.
Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Organizatës, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë disa mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

21 Prill 2026




Sadik Berisha

Auditor Ligjor

Pasuritë	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Paraja e gatshme dhe në banka	6	46,064	40,484
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	7	66,560	60,232
Kreditë për klientët	8	560,541	491,220
Investime në letra me vlerë	9	99,980	55,749
Investimet në degë	9.1	7,358	7,358
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	10	14,711	13,535
Pasuritë e paprekshme	11	2,295	3,220
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	-	-	343
Pasuri të tjera	12	3,474	3,140
Gjithsej pasuritë		800,983	675,281
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	13	695,430	596,936
Detyrime ndaj bankave	14	2,588	1,096
Borxhi i varur	24	2,136	-
Detyrimi i tatimit në fitim	-	241	-
Detyrime të tjera	15	4,554	3,931
Detyrimi i shtyer tatimor	-	592	596
Gjithsej detyrimet		705,541	602,559
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	16	38,874	29,422
Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera	16	6,606	4,887
Fitime të mbajtura		49,962	38,413
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		95,442	72,722
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		800,983	675,281

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre më 20 Prill 2026 nga:


Zt. Shpend Luzha
Kryeshër Ekzekutiv


Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar



Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	17	40,028	35,973
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	17	(9,005)	(7,741)
Të ardhurat neto nga interesi		31,023	28,232
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	18	6,800	5,941
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	18	(2,008)	(1,667)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		4,792	4,274
Fitimi nga blerja mbi vleren e drejtë	26	2,884	-
Të ardhurat e tjera operative	19	556	764
Të ardhurat		39,255	33,270
Shpenzimet e personelit	20	(6,483)	(5,585)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(3,389)	(3,306)
Shpenzime të tjera	21	(13,142)	(12,015)
(Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në instrumentet financiare	6,7,8,9	(2,960)	(342)
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	11	(580)	(365)
Gjithsej shpenzimet operative		(26,554)	(21,613)
Fitimi para tatimit		12,701	11,657
Tatimi në fitim	22	(1,152)	(963)
Fitimi neto për vitin		11,549	10,694

Banka Ekonomike Sh.a.**Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse***Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje***

Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi	(1,598)	-
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës	-	4

Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje

Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	121	137
---	-----	-----

Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	1,719	141
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	13,268	10,835

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Ekuitet
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera	Fitimet e mbajtura	Gjithsej ekuiteti dhe rezervat
Me 01 Janar 2024	29,422	4,746	30,719	64,887
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenta e shpërndarë (Shënimi 16)	-	-	(3,000)	(3,000)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	(3,000)	(3,000)
Fitimi për vitin	-	-	10,694	10,694
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Fitimi nga rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave, neto pas tatimit	-	-	-	-
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	4	-	4
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	137	-	137
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	141	10,694	10,835
Më 31 Dhjetor 2024	29,422	4,887	38,413	72,722
Me 01 Janar 2025	29,422	4,746	30,719	64,887
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga pronarët (Shënimi 16)	9,452	-	-	9,452
Dividenta e shpërndarë	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	9,452	-	-	9,452
Fitimi për vitin	-	-	11,549	11,549
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Ekuitet
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Fitimi nga rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave, neto pas tatimit				
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	1,598	-	1,598
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	-	-	-
Transfer	-	121	-	121
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	1,719	11,549	13,268
Më 31 Dhjetor 2025	38,874	6,606	49,962	95,442

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënime të pasqgrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023
Aktivitetet operative				
Fitimi para tatimit		12,701	11,657	12,908
<i>Ndryshime për:</i>				
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	3,389	3,306	3,004
Ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në kreditë për klientët	8	2,951	283	(1,375)
Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	11	580	365	942
Humbje neto nga zhvlerësimi i aseteve tjera	-	27	620	-
Ngarkesa/(Lirimi) e provizionit për garancitë dhe letrat me vlerë	15,9	209	(47)	(78)
Fitimi nga blerja mbi vlerën e drejtë	26	(2,884)	-	-
Të ardhurat nga interesi	17	(40,028)	(35,973)	(30,746)
Shpenzimet e interesit	17	9,005	7,741	5,450
		(14,050)	(12,048)	(9,895)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>				
Rezerva statutore me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara		(15,274)	(16,264)	1,951
Kreditë për klientët		(34,344)	(50,543)	(59,385)
Pasuri të tjera		319	(1,213)	(18)
Depozitat nga klientët		64,510	58,996	30,822
Detyrime ndaj bankave		(104)	(391)	1,394
Detyrime të tjera		(1,236)	1,133	85
		(179)	(20,330)	(35,046)
Interesi i paguar		(8,241)	(6,868)	(4,469)
Interesi i arkëtuar		39,811	36,177	30,150
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(568)	(1,394)	(1,308)
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga aktivitetet operative		30,823	7,585	(10,673)

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese		(44,579)	(47,839)	(14,670)
Aktivitetet financiare				
Pagesat e dividendës	10	-	(3,000)	(976)
Kontributet nga pronarët	16	9,452	-	-
Të ardhurat nga emetimi i borxhit të varur		2,136	-	-
Pagesat e qirasë	16	(1,198)	(952)	-
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet financiare		10,390	(3,952)	(976)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj				
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fillim të vitit	6	51,916	96,122	93,101
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit		6	48,550	51,916
			96,122	

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a (“Banka”) është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (“BQK”), Banka ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 29 nëndegë. Banka ka te punësuar 473 punonjës më 31 Dhjetor 2025 (2024: 450).

Në Shtator 2022, Banka përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Kompanisë të Sigurimeve Siguria Sh.a. Më 31 Dhjetor 2025, Banka zotëron 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a (2024: 100%).

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra individuale financiare përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e tyre të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Këto pasqyra individuale financiare përfaqësojnë rezultatin dhe pozicionin financiar të Bankës dhe nuk përfshijnë atë të filialit të saj (shënimi 9.1). Banka përgatit një grup tjetër pasqyrash financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF. Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur për qëllime ligjore lokale.

Banka Ekonomike Sh.a.

Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

(b) Prezantimi i pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime qartësie, pasqyrat individuale financiare dhe shënimet e pasqyrave individuale financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave individuale financiare agregohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare parësore. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime.

(c) Standardet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Banka

Banka ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit.

Ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 janar 2025:

- **Ndryshimet në IAS 21 – Mungesa e këmbyeshmërisë së valutës.**

Adoptimi i këtyre ndryshimeve nuk pati ndikim signifikant në pasqyrat individuale financiare të përmbledhura të Bankës.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(d) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa miratuara nga Banka

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Bankës janë shpalosur më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare – Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7;
- Kontratat që referojnë energjinë elektrike të varur nga natyra – Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7.
- Përmirësimet vjetore të standardeve të kontabilitetit SNRF – Vëllimi 11;
- SNRF 18 Prezantimi dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare;
- SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacionit;
- Shitja ose kontributi i aseteve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit ose sipërmarrjes së tij të përbashkët – Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28.

Banka ka zgjedhur të mos miratojë para kohe këto deklarata dhe është në proces të analizimit të ndikimit të adoptimit të këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve në pasqyrat individuale financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

Banka Ekonomike Sh.a.

Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

(e) Baza e kontabilitetit

Pasqyrat individuale financiare janë përgatitur duke përdorur parimin e vazhdimësisë dhe sipas konventës së kostos historike, me përjashtim të pasurive financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit të mbajtura për mbledhje dhe shitje dhe klasa të caktuara të pronave, impianteve dhe pajisjeve

(f) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat individuale financiare përgatiten mbi bazën e vijimësisë, pasi Drejtorët janë të kënaqur që banka ka burime për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë parashikimet e ardhshme të përfitimit, flukset monetare, kërkesat për kapital dhe burimet kapitale. Këto konsiderata përfshijnë skenarë të theksuar. Ata gjithashtu morën parasysh rreziqe të tjera kryesore, si dhe nga ndikimet e lidhura me përfitimin, kapitalin dhe likuiditetin.

(g) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra individuale financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç ku shprehet ndryshe.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(h) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimi

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospective.

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 25.

3. Politikat materiale kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra individuale financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

(a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare, duke përjashtuar ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim, njihen në 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)
Përqendrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Përqendrimi sipas sektorëve								
Korporative	210,955	172,825	-	-	-	-	14,493	10,155
Qeveria	-	-	99,980	55,749	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	92,751	82,639	-	-

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Individët	182,760	161,643	-	-	-	-	13	-
Mikro entitete	167,159	156,752	-	-	-	-	2,815	3,050
Gjithsej	560,874	491,220	99,980	55,749	92,751	82,639	17,321	13,205
Përqendrimi sipas vendndodhjes								
Vendet e BE-së	-	-	-	-	22,557	21,308	-	-
Republika e Kosovës	560,874	491,220	99,980	55,749	70,194	61,331	17,075	13,169
	560,874	491,220	99,980	55,749	92,751	82,639	17,075	13,169

Pasojat e luftës Ukrainë-Rusi

Pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse dhe reagimi i mëpasshëm global ndaj këtyre veprimeve ushtarake mund të kenë efekte të rëndësishme financiare në shumë entitete dhe tregje financiare. Këto përfshijnë subjekte me operacione fizike në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi, si dhe interesa indirekte. Banka nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rosisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, Banka po monitoron vazhdimisht zhvillimet në lidhje me efektet e luftës Ukrainë-Rusi. Pozicioni financiar i Bankës vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si dhe në të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është rregulluar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të Bankës kanë norma fikse interesi. Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme.

Banka përpiket të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

25. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)****Rreziku i normave të interesit (vazhdim)**

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Ekspozimet e Bankës bazohen në normat e interesit të shënuara në Kosovë dhe Banka përballlet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Bankës në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Thesarit monitoron në mënyrë konstante rrezikun e normave të interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për rishmimin ose rialokimin me miratimin e Komisionit të Pasurive dhe Detyrimeve. Raporti lidhur me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komisionit për Pasuri dhe Detyrime. Janë marrë masat e nevojshme nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analiza për depozituesit kryesorë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet në analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analizën e GAP-it mbi rrezikun e likuiditetit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e rishmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR dhe EURIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës me 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë si në vijim:

	USD		EUR		CHF		GBP	
Pasuritë	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Paraja në dorë dhe në banka	3.31%	0.72%	0.51%	0.85%	(0.43)%	-	(0.22)%	-
Balancat me BQK-në	-	-	0.30%	0.30%	-	-	-	-
Kreditë për klientët	-	-	6.91%	6.95%	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë kosto të amortizuar	-	-	-	3.19%	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë në VDATGJ	3.73%	4.19%	2.16%	2.94%	(0.10)%	(0.32)%	-	-
Pasuritë								
Depozitat e klientëve	2.05%	0.83%	1.45%	1.23%	0.05%	0.02%	0.01%	-

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendeikut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimve financiare të Bankës ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

	2025	2024
Përshkrimi	Totalet e Normave Fikse (000)	Totalet e Normave Fikse (000)
Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata	667,113	552,569
Totali i detyrimet totale dhe pozicionet e shkurtra	801,089	675,281
Pozicioni neto (i papeshuar)	(133,976)	(122,712)
Përshkrimi	Totalet e Normave Variabile (000)	Totalet e Normave Variabile (000)
Asetet dhe pozicionet e gjata		
Kredi dhe paradhënie për klientët	133,976	122,712
Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata	133,976	122,712
Detyrimet dhe pozicionet e shkurtra	-	-
Pozicioni neto (i papeshuar)	(133,976)	(122,712)
Gjithsej kapitali (Klasi I + Klasi II)	97,311	70,644
Norma e interesit variabile në normë fikse të aseteve %	20.08%	22.21%

Banka vazhdon të jetë e ekspozuar ndaj një niveli të ngjashëm të rrezikut të normës së interesit. Rreth 20% (2024: 22%) e aktiveve të Bankës janë me norma të ndryshueshme.

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)**

31 Dhjetor 2025	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartese	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	13,877	-	-	-	-	-	32,187	46,064
Gjendja me BQK	66,560	-	-	-	-	-	-	66,560
Investimet në letra me vlerë	22,738	21,096	20,771	27,218	8,157	-	-	99,980
Kredi klientëve – Norma fikse	8,584	22,954	45,772	55,321	249,582	178,661	-	560,874
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	1,475	1,475
Gjithsej	111,759	44,050	66,543	82,539	257,739	178,661	33,662	774,953
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	82,008	24,771	32,943	164,015	124,378	306	267,571	695,992
Detyrimet ndaj bankave	2,162	-	426	-	-	-	-	2,588
Borxhi i varur– Norma fikse	-	-	-	-	-	2,136	-	2,136
Detyrimet tjera	-	-	-	56	2,344	545	1,237	4,182
Gjithsej	84,170	24,771	33,369	164,071	126,722	2,987	268,808	704,898
Hendeku	27,589	19,279	33,174	(81,532)	131,017	175,674	(235,146)	70,055
Hendeku kumulativ	27,589	46,868	80,042	(1,490)	129,527	305,201	70,055	

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

31 Dhjetor 2025	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartese	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	10,622	-	-	-	-	-	29,862	40,484
Gjendja me BQK	60,232	-	-	-	-	-	-	66,232
Investimet në letra me vlerë	32,618	12,372	2,973	-	108	7,678	-	55,749
Kredi klientëve – Norma fikse	4,603	19,497	-	49,639	228,663	161,164	-	491,220
Pasurite tjera	-	-	-	-	-	-	1,715	1,715
Gjithsej	108,075	31,896	30,627	49,639	228,771	168,842	31,577	649,400
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	58,875	22,839	21,285	101,041	124,303	1,354	267,239	596,936
Detyrimet ndaj bankave	614	-	482	-	-	-	-	1,096
Detyrimet tjera	-	-	-	3	1,681	1,090	900	3,674
Gjithsej	59,489	22,839	21,767	101,044	125,984	2,444	268,139	601,706
Hendeku	48,586	9,030	8,860	(51,405)	102,787	166,398	(236,562)	47,694
Hendeku kumulativ	48,586	57,616	66,476	15,071	117,859	284,256	47,694	

25.Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)****Rreziku valutor**

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë të huaj. Banka sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë valuta të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra.

Rreziku valuator nuk është i rëndësishëm, meqë pjesa më e madhe e transaksioneve të Bankës janë në valutën vendase. Valutat e huaja me të cilat Banka operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë si në vijim:

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Valuta	2025 EUR	2024 EUR
1 USD	1.1750	1.0389
1 CHF	0.9314	0.9412
1 GBP	0.8726	0.8292

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e këmbimit është si në vijim:

	EUR	USD	CHF	GBP	Total
31 Dhjetor 2025					
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	33,949	8,600	2,674	841	46,064
Gjendja me BQK	66,560	-	-	-	66,560
Investimet në letra me vlerë	67,614	28,596	3,770	-	99,980
Kreditë ndaj klientëve	560,541	-	-	-	560,541
Pasuritë tjera	1,475	-	-	-	1,475
	730,139	37,196	6,444	841	774,620
Detyrimet					
Depozita nga klientët	650,426	37,550	6,613	841	695,430
Detyrimet ndaj bankave	2,588	-	-	-	2,588
Borxhi i varur	2,136	-	-	-	2,136
Detyrime të tjera	4,182	-	-	-	4,182
	659,332	37,550	6,613	841	704,336

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Pozicioni neto valutor	70,807	-354	-169	0	70,284
31 Dhjetor 2024	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	33,455	2,704	3,533	792	40,484
Gjendja me BQK	60,232	-	-	-	
Investimet në letra me vlerë	45,932	7,694	2,123	-	55,749
Kreditë ndaj klientëve	491,220	-	-	-	491,220
Pasuritë tjera	1,715	-	-	-	1,715
	632,554	10,398	5,656	792	649,400
Detyrimet					
Depozita nga klientët	579,934	10,529	5,633	840	596,936
Detyrimet ndaj bankave	1,096	-	-	-	1,096
Detyrime të tjera	3,674	-	-	-	3,674
	584,704	10,529	5,633	840	601,706
Pozicioni neto valutor	47,850	(131)	23	(48)	47,694

25.Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Rreziku valuator (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose uljes së normave të valutës së huaj është si më poshtë:

	USD		CHF		GBP	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitimi ose humbja						
+5% e Euro	(17.68)	(6.56)	(8.45)	1.17	-	(2.40)
- 5% e Euro	17.68	6.56	8.45	(1.17)	-	2.40

(d) Rreziku i likuiditetit
Rreziku i likuiditetit është se Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.
Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës.
Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mbliidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar. Banka ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Bankës dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 arritën në 56,714 mijë euro (me 31 Dhjetor 2024: 44,428 mijë euro). Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Banka përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Për më tepër Banka mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabelat e mëposhtme tregojnë flukset monetare të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturimit më të hershëm kontraktual të mbetur. Flukset monetare të pritshme të Bankës për këto instrumente ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)
Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
31 Dhjetor 2025							
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	46,064	-	-	-	-	-	46,064
Gjendja me BQK	66,560	-	-	-	-	-	66,560
Investimet në letra me vlerë	22,737	21,096	20,771	27,218	8,158	-	99,980
Kreditë ndaj klientëve	8,584	22,954	45,772	55,321	249,582	178,861	560,874
Pasuri të tjera	1,475	-	-	-	-	-	1,475
Gjithsej	145,420	44,050	66,543	82,539	257,740	178,661	774,953
Liabilities							
Depozitat nga klientët	349,579	24,771	32,943	164,015	124,378	306	695,992
Detyrimet ndaj bankave	2,162	-	426	-	-	-	2,588
Borxhi I varur	-	-	-	-	-	2,136	2,136
Detyrime të tjera	1,610	(12)	(181)	150	2,425	190	4,182
Gjithsej	353,351	24,759	33,188	164,165	126,803	2,632	704,898
Hendeku	(207,931)	19,291	33,355	(81,626)	130,937	176,029	70,055
Hendeku kumulativ	(207,931)	(188,640)	(155,285)	(236,192)	(105,976)	70,055	

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2024	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	40,484	-	-	-	-	-	40,484
Balances with CBK	60,232	-	-	-	-	-	60,232
Investimet në letra me vlerë	32,618	12,372	2,973	-	108	7,678	55,749
Kreditë ndaj klientëve	4,603	19,497	27,654	49,639	228,663	161,164	491,220
Pasuri të tjera	1,715	-	-	-	-	-	1,715
Gjithsej	139,652	31,869	30,627	49,639	228,771	168,842	649,400
Detyrimet							
Depozitat nga klientët	326,114	22,839	21,285	101,041	124,303	1,354	596,936
Detyrimet ndaj bankave	614	-	482	-	-	-	1,096
Detyrime të tjera	745	4	616	109	1,745	455	3,674
Gjithsej	327,473	22,843	22,383	101,150	126,048	1,809	601,706
Hendeku	(187,821)	9,026	8,244	(51,511)	102,723	167,033	47,694
Hendeku kumulativ	(187,821)	(178,795)	(170,551)	(222,062)	(119,339)	47,694	

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 14% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Asetet e peshuara me rrezikun

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke iu caktuar një peshë rreziku në përputhje me shumën e vlerësuar të kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshimit të rrezikut: (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, dhe 150%): për shembull instrumentet e tregut të parasë peshohen me zero rrezik, i cili nënkupton që nuk nevojitet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Pasuritë afatgjata materiale peshohen me rrezik 100% çka nënkupton që ato duhet të mbështetet nga Raporti i Kapitalit (Niveli 1) + Rezervën e ruajtjes së kapitalit e barabartë me 9% të 2025 të vlerës kontabël.

Angazhimet jashtë bilancit të lidhura me kreditimin merren në konsideratë. Shumat më pas peshohen me rrezikun duke përdorur përqindje të njëjtë me atë të pasurive të bilancit

	2025	2024
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik	522,932	463,693
Pasuritë gjithsej të peshuara mepër rrezikun operacional	38,635	33,261
Gjithsej	561,567	496,954
Kapitali rregullator (Gjithsej Kapitali)	97,311	70,604
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (Gjithsej Kapitali)	17.33%	14.21%

Rregullorja e BQK-së për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit bankar ka hyrë në fuqi më 01.01.2020 dhe për këtë arsye ka pasur një ndryshim të aktiveve financiare me AMR 100% ku disa prej këtyre pasurive janë llogaritur me 75% AMR.

Leva financiare

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsiderat koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2025	2024
Gjithsej Pasuritë	800,983	675,281
Gjithsej Ekuiteti	95,442	72,722
Raporti i levës	11.92%	10.77%

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Kombinimi i bizneseve dhe shkrirja

Në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar për blerje/shitje më 23 Prill 2025, dhe marrjen e miratimit nga Banka Qendrore e Kosovës përmes vendimit të tyre nr. 2025/312, datë 29 Korrik 2025, Banka Ekonomike përfundoi blerjen e aktiveve dhe pasivave të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë më 19 Gusht 2025 (data e blerjes). Si rezultat, aktivet dhe pasivet e fituara të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë u bashkuan me aktivet dhe pasivet e Bankës. Detajet e vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasivave të identifikueshme të fituara, kompensimit të blerjes dhe përfitimit të marrë nga blerja mbi vleren e drejte janë si më poshtë:

	Vlera në libra EUR	Rregullime EUR	Vlera e drejte EUR
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	3,405,693	-	3,405,693
Kredi për klientët	38,068,106	(332,775)	37,735,331
Investime në letra me vlerë	7,051,204	87,710	7,138,914
Prona pajisjet dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	819,039	68,288	887,327
Pasuri të paprekshme	28,577	-	28,577
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	97,948	-	97,948
Pasuri të tjera	209,119	(196,436)	12,683
Gjithsej Pasuritë	49,679,686	(373,213)	49,306,473
Liabilities			
Detyrime ndaj klientëve	33,580,299	(562,218)	33,018,081
Detyrime ndaj bankave	1,595,865	-	1,595,865
Detyrimi i tatimit në të ardhura	98,275	-	98,275
Detyrime të tjera	1,556,031	(75,959)	1,480,072
Detyrimi i shtyer tatimor	29,951	-	29,951
Gjithsej Detyrimet	36,860,421	(638,177)	36,222,244
Pasuritë neto të blera	12,819,265	264,964	13,084,229
Fitimi nga blerja mbi vleren e drejte			
Gjithsej Konsiderata (shiko shënimin 11)			10,200,000
Vlera e drejtë e Pasurive të fituara			49,306,473
Vlera e drejtë e Detyrimeve të marra			(36,222,244)
Vlera e Drejtë e Pasurive Neto të Fituara			13,084,229
Fitimi nga blerja mbi vleren e drejte në datën e blerjes			2,884,229

Banka Ekonomike Sh.a.

Shënime të pasqyrave individuale financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shuma totale prej 10.2 milionë euro për blerjen e aktiveve dhe pasivave të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë, u transferua te shitësi më 3 Tetor 2025 (shih shënimin 10).

Përveç asaj që është zbuluar, nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose zbulim në pasqyrat e shkurtuara financiare të veçanta.

27. Ngjarjet pasuese

Pas datës së raportimit, Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat ka hyrë në fuqi në Republikën e Kosovës në vitin 2026, duke sjellë ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullativ që rregullon sektorin bankar. Ky ligj përfshin ndryshime, ndër të tjera, në lidhje me licencimin, mjaftueshmërinë e kapitalit, qeverisjen, menaxhimin e rrezikut, kërkesat mbikëqyrëse dhe rregulloret e tjera prudenciale të zbatueshme për bankat që operojnë në Kosovë. Ligji parashikon një periudhë tranzicioni prej një viti, gjatë së cilës bankat duhet të harmonizojnë operacionet, politikat dhe proceset e tyre të brendshme me kërkesat e reja.

Për më tepër, pas datës së raportimit, tensionet gjeopolitike, përfshirë zhvillimet lidhur me konfliktin Iran–Shtetet e Bashkuara, kanë vazhduar të evoluojnë. Edhe pse Banka operon në Kosovë dhe nuk ka ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj zonës së konfliktit, operacionet e saj mund të ndikohen në mënyrë indirekte për shkak të kushteve më të gjera rajonale dhe globale të tregjeve financiare, ndikimeve në kushtet ekonomike lokale dhe aktivitetin e klientëve. Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, situata mbetet dinamike dhe natyra, koha dhe madhësia e çdo ndikimi të mundshëm në operacionet, pozicionin financiar, likuiditetin, cilësinë e aktiveve ose mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës nuk mund të vlerësohen me saktësi të besueshme. Menaxhmenti po e monitoron nga afër zhvillimin e situatës dhe vazhdon të vlerësojë implikimet e mundshme. Prandaj, nuk janë bërë rregullime në pasqyrat financiare në lidhje me këtë çështje.

Përveç sa është shpalosur në pasqyrat financiare të veçanta, nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat e Konsoliduara Financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

**për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)**

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet

Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Parasë

Shënime për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Banka Ekonomike Sh.A.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese të Banka Ekonomike Sh.A. dhe filialit të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes ose të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që përfundon, dhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë politikat kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën e tij financiare të konsoliduar dhe rrjedhen e parasë të konsoliduar për vitin e përfunduar në përputhje me bazën të përgatitjes siç shpjegohet në shënimin 2(a) të pasqyrave të konsoliduara financiare shoqëruese.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave të konsoliduara financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Grupit, por nuk përfshijnë pasqyrat e konsoliduara financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Grupit pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat e konsoliduara financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave të konsoliduara financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuar më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat e konsoliduara financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me bazën e përgatitjes siç shpaloset në shënimin 2(a), dhe për një kontroll të tillë të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat e konsoliduara financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra të konsoliduara financiare.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave të konsoliduara financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.

- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Grupit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Grupit. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat e konsoliduara financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Grupi të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

- Marrim evidencë të mjaftueshme të përshtatshme auditimi në lidhje me informacionin financiar të njërive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës
21 Prill 2026

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Sadik Berisha'.

Sadik Berisha

Auditor Ligjor

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	46,290	41,070
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	7	66,883	60,555
Depozitat me afat	8	9,171	6,481
Kreditë për klientët	9	560,541	491,220
Investime në letra me vlerë	10	104,105	60,831
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	11	18,236	16,820
Pasuritë e paprekshme	12	4,227	5,095
Paradhënie për tatimin mbi të ardhurat		-	179
Pasuri të tjera	13	8,476	8,632
Gjithsej pasuritë		817,929	690,883
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	14	689,564	591,773
Detyrime ndaj bankave	15	2,588	1,096
Detyrimet e provizioneve teknike	16	12,993	12,107
Provizioni për prime të pafituara	17	6,636	6,427
Borxhi i varur	18	2,350	200
Detyrimi i tatimit në fitim		201	-
Detyrime të tjera	19	5,603	4,856
Detyrimi i shtyer tatimor		592	596
Gjithsej detyrimet		720,527	617,055
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	20	38,874	29,422
Rivlerësimi dhe rezervat tjera	20	6,606	4,887
Fitime të mbajtura		51,922	39,519
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		97,402	73,828
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		817,929	690,883

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues dhe nënshkruar në emër të tyre më 20 Prill 2026 nga:


Zt. Shpend Luzha
Kryeshf Ekzekutiv


Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar



Banka Ekonomike Group
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	21	40,368	36,260
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	21	(8,954)	(7,673)
Të ardhurat neto nga interesi		31,414	28,587
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	22	6,800	5,941
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	22	(2,008)	(1,667)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		4,792	4,274
Primet e fituara neto, neto nga tatimi mbi primin		12,428	11,532
Të ardhura të tjera operative, neto	23	579	995
Fitimi nga blerja mbi vleren e drejtë	30	2,884	-
Të ardhurat		52,097	45,388
Shpenzimet e personelit	24	(8,865)	(7,834)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(3,727)	(3,601)
Shpenzime të tjera	25	(14,583)	(13,920)
Shpenzimet e provizioneve teknike	16	(7,612)	(6,641)
(Lirimi)/nga lejimi i humbjeve neto në instrumentet financiare	6,7,8,9,10	(2,960)	(342)
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	12	(580)	(365)
Gjithsej shpenzimet operative		(38,327)	(32,703)
Fitimi para tatimit		13,770	12,685
Tatimi në fitim	26	(1,367)	(1,232)
Fitimi neto për vitin		12,403	11,453

Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse

Banka Ekonomike Group
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje
Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës

1,598	-
-	4

Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas
vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

121	137
-----	-----

Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	1,719	141
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	14,122	11,594

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e
këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Banka Ekonomike Group
Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhjes së Parasë
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera	Fitimet e mbajtura	Gjithsej ekuiteti dhe rezervat
Me 01 Janar 2024	29,422	4,746	31,066	65,234
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga pronarët	-	-	-	-
Dividenta e shpërndarë (Shënimi 20)	-	-	(3,000)	(3,000)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	(3,000)	(3,000)
Fitimi për vitin	-	-	11,453	11,453
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	4	-	4
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	137	-	137
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	-	-	-
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	141	11,453	11,594
Më 31 Dhjetor 2024	29,422	4,887	39,519	73,828
Me 01 Janar 2025	29,422	4,887	39,519	73,828
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga pronarët (Shënimi 20)	9,452	-	-	9,452
Dividenta e shpërndarë	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	9,452	-	-	9,452
Fitimi për vitin	-	-	12,403	12,403
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	1,598	-	1,598
Fitimi nga rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave, neto pas tatimit	-	121	-	121
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	-	-	-
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	1,719	12,403	14,122
Më 31 Dhjetor 2025	38,874	6,606	51,922	97,402

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare

Banka Ekonomike Group
Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhjes së Parasë
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënim	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Aktivitete operative			
Fitimi para tatimit		13,770	12,685
Ndryshime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	3,727	3,601
Ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në kreditë për klientët	9	2,951	283
Shpenzimet e humbjeve dhe rregullimeve të humbjeve	16	7,612	6,641
Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	12	580	365
Zhvlerësimi i aseteve të tjera	19	27	620
Lirimet e provizionit për garancitë	19	209	(47)
Fitimi nga blerja mbi vleren e drejtë	30	(2,884)	-
Të ardhurat nga interesit	21	(40,368)	(36,260)
Shpenzimet e interesit	21	8,954	7,673
		(5,422)	(4,439)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rezerva statutore me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara		(12,629)	(16,265)
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)			
Kreditë për klientët		(31,919)	(50,546)
Pasuri të tjera		141	(1,596)
Depozitat nga klientët		64,140	58,281
Detyrime ndaj bankave		(104)	(391)
Detyrimet e provizioneve teknike		(6,726)	(6,317)
Provizioni për prime të pafituara		209	1,259
Detyrime të tjera		416	946
		8,106	(19,068)
Interesi i paguar		(8,321)	(6,800)
Interesi i arkëtuar		40,151	36,601
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(987)	(1,553)
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga aktivitetet investuese		38,949	9,180
Aktivitete investuese			
Blerjet e pronave dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	11,12	(1,308)	(3,060)
Blerjet e investimeve në letra me vlerë	10	(296,383)	(183,081)
Shitjet e investimeve në letra me vlerë	10	260,326	138,186
(Rritja)/zvogëlimi i depozitave me afat		(2,690)	(1,118)
Kompensimi i paguar për blerjen, neto nga mjetet monetare të përfituara		(10,200)	-
Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese		(50,255)	(49,073)
Aktivitetet financiare			
Kontributet nga pronaret		9,452	-
Borxhi i varur	18	2,150	200
Shlyerja e detyrimit të qirasë	11	(1,358)	(1,178)
Dividentët e paguar	20	-	(3,000)
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet financiare		10,244	(3,978)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj			
Paraja dhe ekuivalentët e saj, fillim të vitit	6	52,502	96,373
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	6	51,440	52,502

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a ("Shoqëria Mëmë") është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Shoqëria Mëmë ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Shoqëria Mëmë operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 29 nëndegë. Shoqëria Mëmë ka të punësuar 473 punonjës më 31 Dhjetor 2025 (2024: 450).

Në 9 Shtator 2022, Shoqëria Mëmë përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiala") përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Filiales. Më 31 Dhjetor 2025, Shoqëria Mëmë zotëron 100% të aksioneve në Filialë.

Filiala është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me numër biznesi 70167671 si shoqëri aksionare.

Filiala është e licencuar si kompani e sigurimeve jo të jetës. Veprimtaria kryesore e Filialës është sigurimi motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe klasa të tjera të sigurimit të tilla si:

- Sigurimi i pronave;
- Të gjitha Risqet gjatë Ndërtimit (CAR);
- Sigurimi shëndetësor gjatë udhëtimit;
- Aksidentet personale;
- Sigurimi Gjithëpërfshirës i Automjeteve Motorike, etj.

Selia e regjistruar e Filialës gjendet në rrugën Qamil Hoxha Nr., 51, 10000, Prishtina, Kosovo.

Më 31 Dhjetor 2025 Filiala ka gjithsej 127 të punësuar dhe menaxhment të lartë (2024: 129).

Shoqëria mëmë, së bashku me filialin e saj të konsoliduar vendas (bashkë, "Grupi"), janë institucione financiare të rregulluara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërise mëmë përfshijnë llogaritë e Komapnisë.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Interpretimet (së bashku SNRF), me përjashtim të SNRF 17. SNRF 17 nuk zbatohet më 31 dhjetor 2024, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për vazhdimin e afatit për zbatimin e këtij standardi. Zbatimi i SNRF 17 do të jetë në fuqi për periudhën e raportimit vjetor që fillon më 1 janar 2026. Megjithatë, faza përgatitore dhe plani i veprimt nga Grupi duhet të përfshijë aktivitete dhe veprime konkrete duke filluar nga viti 2024, drejt përgatitjes për zbatimin e plotë të këtij standardi deri në fund të vitit 2025. Kështu, këto pasqyra financiare nuk mund të lexohen si të përgatitura në përputhje me SNRF-të. Për më tepër, bazuar në një analizë fillestare të kryer, Grupi nuk parashikon një ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e miratimit.

Bazat e matjes përshkruhen më plotësisht në politikat kontabël më poshtë.

(b) Paraqitja e pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime qartësie, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe shënimet në pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare të konsoliduara, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(c) Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Grupi

Grupi, me përjashtim të SNRF 17, ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. SNRF 17 nuk është zbatuar, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për zgjatjen e afatit për zbatimin e këtij standardi. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimit, përveç IRFS 17, nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 Janar 2025:

- Ndryshimet në SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Valutave të Huaja - Mungesa e Këmbyeshmërisë.
Grupi është aktualisht në fazat fillestare të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të SNRF 17 Kontratat e Sigurimit në pasqyrat e tij financiare. Në këtë moment, bazuar në vlerësimin tonë fillestar, menagjemti nuk parashikon një ndikim material në pozicionin ose performancën financiare të Grupit. Megjithatë, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit, nuk mund të konkludohet përfundimisht se nuk do të ketë ndikim material. Prandaj, ne e kuptojmë rëndësinë e zbulimit të kësaj pasigurie. Prandaj, ne e pranojmë se efekti i zbatimit nuk mund të përcaktohet me siguri absolute në këtë moment.
Në fillim ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Grupi shpërndan konsideratën në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të çmimeve të tyre relative të pavarura. Megjithatë, për qiratë e tokës dhe ndërtesave në të cilat ajo është qiramarrëse, Grupi ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të llogarisë komponentët e qirasë dhe ato joqira si një komponent i vetëm i qirasë.

(p) Pasuritë e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga Grupi janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Shpenzimet pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike me të cilën lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është të vlefshme për përdorim.

Programi kompjuterik amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme prej pesë vjetësh. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Hulumtimi dhe zhvillimi

Kostot e kërkimit dhe zhvillimit të kërkimit shpenzohen në periudhën në të cilën ato ndodhin. Kostot e zhvillimit kapitalizohen kur është e mundur që projekti të jetë i suksesshëm duke marrë parasysh fizibilitetin e tij komercial dhe teknik; Grupi ka synime dhe burime të mjaftueshme për të përfunduar zhvillimin; dhe kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

Kostot e kapitalizuara të zhvillimit amortizohen në bazë lineare gjatë periudhës së pritshme të fitimit, duke qenë jeta e tyre e kufizuar.

(q) Pasuri e riposeduar

Pasuritë e riposeduara fitohen nëpërmjet zbatimit të garancisë mbi kreditë jo-performuese për klientët dhe janë të destinuara për nxjerrjen jashtë përdorimi brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen duke përdorur shumën e grupit përmbarimor në ankandin e fundit dhe më pas maten me vlerën më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje kur ndodhin.

Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

(r) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Grupit, përveç pasurive tatimore të shtyera, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të saj e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e të hollave të ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë aktualizimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga rënia në vlerë janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëqoftëse nuk është njohur humbja nga zhvlerësimi.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(s) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, Grupi ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Efekti i aktualizimit njihet si kosto financiare.

(t) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Grupi paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse Grupi ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

(u) Garancitë financiare dhe angazhimet per hua

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Grupit që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

Garancitë financiare të lëshuara ose zotimet për të siguruar një kredi me një normë interesi nën nivelin e tregut fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet gjatë jetës së garancionit ose angazhimit. Më pas, ato maten me më të lartën e kësaj shume të amortizuar dhe shumës së provizionit të humbjes.

Grupi nuk ka dhënë asnjë zotim të kredisë që matet në VDNFH.

Për angazhimet e tjera të kredisë, Grupi njeht kompensimin e humbjes.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare dhe e angazhimeve të huave të patërhequra nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve janë shpalosur në shënimin 26 dhe provizionet korresponduese të humbjeve janë paraqitur në shënimin 19.

(v) Dividentët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në kapital në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

(w) Klasifikimi i produktit

Kontratat e sigurimit janë ato kontrata ku Grupi (siguruesi) ka pranuar rrezik të konsiderueshëm të sigurimit nga një palë tjetër (mbajtësit e policave) duke u pajtuar që të kompensojë mbajtësit e policave nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt në të ardhmen (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht në të siguruarit. Si një udhëzues i përgjithshëm, Kompania përcakton nëse ka rrezik të konsiderueshëm të sigurimit, duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitimet e pagueshme nëse ngjarja e siguruar nuk ka ndodhur. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe riskun financiar.

Kontratat e investimit janë ato kontrata që transferojnë risk të madh financiar. Risku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë të një norme specifike të interesit, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit, indeksit të çmimeve ose normave, vlerësimit të kredisë ose indeksit të kredisë ose variabileve të tjera, me kusht që në rast të ndonjë variabili jo-financiar që variabili nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe riskun financiar. Kur një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së saj, edhe nëse risku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose mbarojnë.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(x) Detyrimet e kontratave të sigurimeve

Njohja dhe matja

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit llogariten ndaras për të gjitha produktet e sigurimeve dhe përbëhen nga kontigjencat e primeve (të pafituara), rreziku i paparashikuar (i papërshtatshëm) dhe kontigjenti i humbjes (nuk paguhet në datën e mbylljes së vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) përfaqësojnë vlerësimet e pagesave të ardhshme për kërkesat e raportuara dhe të pa raportuara. Kompania nuk zbret detyrimet e saj të sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësimet reflektohet në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimeve është një proces kompleks që merret me pasigurinë, duke kërkuar përdorimin e vlerësimeve të informuara dhe gjykimeve. Primet bruto të shkruara regjistrohen në bazë akruale sipas kontratave të sigurimit dhe politikave të nxjerra gjatë vitit dhe kreditohen për fitim në mënyrë proporcionale gjatë periudhës së mbulimit të politikës përkatëse. Primet e shkruara bruto pasqyrojnë shitjet gjatë vitit dhe përjashtojnë çdo taksë apo detyrim të bazuar në primet. Primet fitohen nga data e marrjes së rrezikut deri në periudhën e jetëgjatësisë, bazuar në modelin e rreziqeve të marra në sigurim.

Primet e pafituara

Provizioni për primin e pafituar përfshin proporcionin e primeve bruto të shkruara që vlerësohet të fitohen në vitet pasuese financiare, të llogaritura veçmas për çdo kontratë sigurimi duke përdorur metodën ditore pro rata, të përshtatura nëse është e nevojshme për të pasqyruar ndonjë ndryshim në incidencën e rrezik gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Detyrimet e kontratave së sigurimit

Detyrimet e kontratës së sigurimit të jo-jetës njihen kur lidhen kontratat dhe paguhen primet. Këto detyrime njihen si kërkesa për dëmshpërblim, të cilat bazohen në koston përfundimtare të vlerësuar të të gjitha kërkesave të ndodhura por që nuk janë shlyer në datën pozicionit financiar, qoftë të raportuar apo jo. Detyrimi çregjistrohet kur kontrata skadon, shkarkohet ose anulohet.

Rezervat për primet e pa fituara përfshijnë primet e marra për risqet që ende nuk kanë skaduar. Në përgjithësi, rezervat lirohen gjatë afatit të kontratës dhe njihen si të ardhura të primeve. Në çdo datë raportimi, kryhet një test i mjaftueshmërisë së detyrimeve. Ndryshimet në kërkesat e pritshme që kanë ndodhur, por të cilat nuk janë shlyer, pasqyrohen me rregullimin e provizionit për kërkesat e papaguara. Provizioni për riskun e paskaduar rritet në masën që kërkesat e ardhshme në lidhje me kontratat aktuale të sigurimit tejkalojnë primet e ardhshme plus provizionet aktuale të primeve të pa fituara.

Kërkesat që rrjedhin nga biznesi i përgjithshëm i sigurimeve

Kërkesat e shkaktuara në lidhje me biznesin e përgjithshëm përbëhen nga kërkesat e paguara ndaj mbajtësve të policave gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimet në vlerësimin e detyrimeve për kërkesat e papaguara.

Kërkesat e papaguara përbëjnë provizionet për vlerësimin e Kompanisë për shpenzimet përfundimtare të shlyerjes së të gjitha kërkesave të kryera por të papaguara në datën e raportimit qoftë të raportuar ose jo, dhe shpenzimet e trajtimit të kërkesave të brendshme dhe të jashtme dhe margjinën prudenciale.

Përderisa Menaxhmenti konsideron se provizionet bruto për kërkesat dhe mbulimet e ri-sigurimeve përkatëse janë deklaruar në mënyrë të drejtë në bazë të informacionit që aktualisht është në dispozicionin e tyre, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullim të rëndësishëm me shumat e siguruara. Rregullimi me shumat e provizioneve të kërkesave të vendosura në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhen rregullimet.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(x) Detyrimet e kontratave të sigurimeve (vazhdim)

Njohja dhe matja (vazhdim)

Provizioni paraqet shpenzimet përfundimtare të vlerësuar të shlyerjes së të gjitha kërkesave duke përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta dhe indirekte të shlyerjes, që rrjedhin nga ngjarjet që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve përbëhen nga vlerësimet për humbjet e raportuara dhe provizionet për humbjet që nuk janë raportuar. Metoda e përdorur për të përcaktuar provizionet për kërkesat, bazohet në rregullat e aplikueshme në fuqi në vijim, por mbështetet gjithashtu nga vlerësimet aktuariale.

Provizionet teknike janë llogaritur nga aktuari i Grupit, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në rregulloren për llogaritjen e provizioneve teknike për siguruesit jo-jetë, të nxjerrë nga Rregullatori i Sigurimeve Banka Qendrore e Kosovës.

Demet e raportuara por jo të zgjidhura ("RBNS") vendosen rast pas rasti. Rezerva llogaritet si shuma e pritshme për tu paguar dhe vlerësimet rregullohen kur informacioni i ri bëhet i disponueshëm.

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 rezervat teknike per IBNR per MTPL percaktohen duke perdorur metoden "Chain Ladder" bazuar ne demet e paguara, ndërsa për linjat tjera është e bazuar në 10% të primit të fituar gjate vitit për atë linjë.

Testi i përshtatshmërisë së detyrimeve/"LAT"

Në çdo datë raportimi, Grupi kryen test për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të kërkesave. Testet primare të kryera janë Analiza e Normës së Kërkesave dhe Analiza e Rrjedhjes së Rezervave të Kërkesave.

Analiza e raportit të kërkesës kryhet çdo vit në linjat kryesore të biznesit individualisht. Llogaritja kryhet vetëm për kërkesat, si dhe kërkesat duke përfshirë shpenzimet e blerjes dhe çdo shpenzim tjetër të trajtimit të kërkesave të jashtme. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Grupi merr në konsideratë vlerësimet aktuale të rrjedhjes dalëse të parave të gatshme. Grupi nuk zbret këto rrjedhje të parasë së gatshme të vlerësuar sepse shumica e kërkesave pritet të zgjidhen brenda një viti.

Përveç kësaj, grupi kryen çdo vit një analizë së rrjedhjes së rezervave së kërkesave për të vlerësuar metodologjinë e rezervimit. Analiza e Rrjedhjes kryhet në Dëmet e Raportuara por jo të Paguara (RBNS) dhe Dëmet e Ndodhura por jo të Raportuara (IBNR) veçmas, si dhe në baza të kombinuara. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha, përshtatjet e duhura bëhen në metodologjinë e rezervimit. papërcaktuar të riskut nga humbjet që rrjedhin nga Testi i Përshtatshmërisë së Përgjegjësisë.

Risigurimi

Grupi siguroi ri-sigurime në rrjedhën normale të biznesit me qëllim të kufizimit të humbjes së mundshme neto përmes diversifikimit të risqeve të saj që rrjedhin nga linjat e biznesit të MTPL, pronës, aksidenteve personale dhe linjat tjera të biznesit.

Një risigurim i tillë përfshin traktate dhe marrëveshje fakultative. Vetëm kontratat që krijojnë transferim të rëndësishëm të riskut të sigurimit dhe riskut të kohës, llogariten si sigurime. Marrëveshjet e ri-sigurimit nuk e lirojnë Kompaninë nga detyrimet e saj të drejtpërdrejta ndaj siguruesve të saj. Detyrimet e ri-sigurimit përbëhen nga detyrimet e pagueshme për kontratat e ri-sigurimit jashtë dhe njihen si një shpenzim i bazuar në shumën e përgjithshme të pajtuar me ri-siguruesin.

Përfitimet e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrës e pozicionit financiar në baza bruto. Rezervat e parashikuara të rikuperimit shpalosen veçmas si pasuri në pasqyrën e pozicionit financiar. Ri-sigurimet dhe rikuperimet tjera vlerësohen në një mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve të papaguara në përputhje me shumat e lidhura me kontratat e sigurimit themelor dhe në përputhje me kushtet e kontratës së ri-sigurimit.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)
(x) Detyrimet e kontratave të sigurimeve (vazhdim)
Njohja dhe matja (vazhdim)

Kostot e shtyera të blerjes
Kostot e blerjes janë përcaktuar si shpenzime që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta, siç janë komisionet e agjentëve dhe pagesat e paguara Bankës Qendrore të Kosovës. Kostot e shtyera të blerjes dhe shpenzimet e shtyra të origjinës amortizohen sistematikisht gjatë ekzistencës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Çdo shumë që nuk është e rikuperueshme shpenzohet. Ato çregjistrohen kur kontratat përkatëse zgjidhen ose shiten.

Kostot e trajtimit të kërkesave
Kostot e trajtimit të pretendimeve përbëhen nga shpenzimet e brendshme dhe të jashtme në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga personeli i kompanisë si dhe shpenzimet e jashtme si tarifat ligjore dhe shpenzimet e tjera. Menaxhmenti ka vlerësuar koston e trajtimit të kërkesave të nga 1.5% - 2% (2024: 1.5-2%) të rezervave totale RBNS dhe IBNR, duke përfshirë dëmet (kërkesat) e polisave kufitare dhe kostot e trajtimit të fondit të garancive të cilat përcaktohen nga Byroja e Sigurimeve e Kosovës.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve
Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kryesore të Grupit dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një rrezik të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe gjykimet kryesore në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta, janë shpalosur më poshtë.
Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shënimin 29).

(a) Zhvlerësimi
Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave të kontabilitetit të përshkruara në 3 (h)(viii). Grupi rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin në baza të tremujore.
Vlera kontabël dhe neto e pasurive financiare më 31 Dhjetor 2025, është paraqitur më poshtë:

Pasuritë financiare	Vlera bartëse	Rënia në vlerë	Vlera neto
Depozitat me afat	9,171	-	9,171
Kreditë ndaj klientëve	574,178	(13,637)	560,541
Investimet në letrat me vlerë në VDATGJ	100,034	(54)	99,980
Investime në letra me vlerë - me kosto të amortizuara	4,125	-	4,125

Vlera kontabël dhe neto e pasurive financiare më 31 Dhjetor 2024, është paraqitur më poshtë:

Pasuritë financiare	Vlera bartëse	Rënia në vlerë	Vlera neto
Depozitat me afat	6,481	-	6,481
Kreditë ndaj klientëve	501,110	(9,890)	491,220
Investimet në letrat me vlerë në VDATGJ	47,816	(26)	47,790
Investime në letra me vlerë - me kosto të amortizuara	13,043	(2)	13,041

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjyqimeve (vazhdon)

(b) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurisë dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka asnjë çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në shënimin 3(h)(vii). Grupi vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike.
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme apo identike në tregjet të cilat konsiderohen më pak se aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në mënyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme të pa vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjyqime materiale të pavëzhgueshme kërkojnë për të reflektuar dallimet në mes të instrumenteve

Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin 5.

(c) Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit të jo-jetës, duhet të bëhen vlerësime si për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të raportuara në datën e pozicionit financiar, ashtu edhe për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të shkaktuara, por të pa raportuara ende në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (IBNR). Kostoja përfundimtare e dëmeve të papaguara është vlerësuar duke përdorur një sërë teknikash standarde të projektimit të dëmeve aktuale.

(d) Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Supozimi kryesor që qëndron në themel të këtyre teknikave është se përvoja e mëparshme e zhvillimit të dëmeve të një Grupi mund të përdoret për të projektuar zhvillimin e dëmeve në të ardhmen dhe kështu koston përfundimtare të dëmeve. Si të tilla, këto metoda theksojnë zhvillimin e humbjeve të paguara dhe të shkaktuara, koston mesatare të një dëmi dhe numrin e dëmeve bazuar në zhvillimet e vëzhguara të viteve të mëparshme dhe raportet e humbjeve të pritshme. Zhvillimi i pretendimeve historike analizohet kryesisht sipas viteve të aksidentit, por gjithashtu mund të analizohet më tej sipas zonës gjeografike, si dhe sipas linjave të rëndësishme të biznesit dhe llojeve të dëmeve. Vlerësimi cilësor shtesë përdoret për të vlerësuar shkallën në të cilën tendencat e kaluara nuk mund të zbatohen në të ardhmen, në mënyrë që të arrihet në koston përfundimtare të vlerësuar të pretendimeve që përfaqëson rezultatin e mundshëm nga diapazoni i rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasiguritë e përfshira.

5. Shpalosja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentet ekzistuese financiare në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit pa u përpjekur të vlerësohet vlera e biznesit të ardhshëm të pritshëm dhe vlera e pasurive dhe detyrimeve që nuk janë instrumente financiare.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të matura me vlerën e drejtë dhe analizën e tyre sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar. Vlerat janë bazuar në vlerat e njohura në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Vlera e drejtë e letrave me vlerë të investimeve është e bazuar në çmimet e tregut ose kuotimet broker / dealer të çmimeve. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të flukseve monetare të bazuara në një kurbë aktuale të të ardhurave të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Investimet në letrat me vlerë	Vlera Kontabël	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3
31 December 2025	99,980	-	99,980	-
31 December 2024	47,790	-	47,790	-

Investimet në letra me vlerë të matura me FVOCI më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përfshijnë obligacione të emetuara nga Qeveria e Kosovës dhe bono thesari të emetuara nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve, të cilat janë blerë ose për t'u shitur ose për t'u mbajtur deri në maturim, varësisht nga nevojat për likuiditet të bankës. Mesatarja e ponderuar e maturimit të mbetur të obligacioneve dhe bonove të thesarit në fund të vitit 2025 është < 0.6 vite (2024: 0.5 vite), ndërsa periudha më e largët e investimit është 4 vite (2024: 5 vite), të shprehura në EURO, USD dhe CHF

Rejtingu i fletëobligacioneve/ bonove	Vlera Kontabël 2025	% Pjesmarrja 2025	Vlera Kontabël 2024	% Pjesmarrja 2024
BB-	16,299	16.3%	7,786	16.3%
AA	44,491	44.5%	5,170	10.8%
AAA	-	-	8,117	17%
AA+	39,190	39.2%	26,717	55.9%
Totali	99,980	100.00%	47,790	100%

Instrumentet jo-financiare të matura me vlerën e drejtë-hierarki e vlerës së drejtë
Pronat investuese

Pronat e investuara të grupit dhe pronat e zotëruara nga pronari maten me vlerën e drejtë për qëllime të raportimit financiar. Në vlerësimin e vlerës së drejtë të një pasurie, Grupi punon ngushtë me vlerësues të jashtëm të kualifikuar të cilët kryejnë vlerësimin, bazuar në teknikat e duhura të vlerësimit të dakorduara dhe të dhëna për modelin (p.sh. përdorimi i metodës së krahasueshme të tregut që pasqyron çmimet e fundit të transaksioneve për instrumente të ngjashme, analiza e fluksit monetar të skontuar etj.). Çmimet e përcaktuara më pas nga vlerësuesit përdoren nga Grupi pa rregullime. Ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive dhe shkaqet e tyre analizohen nga menaxhmenti i Grupit. Vlerësime të tilla kërkojnë që Grupi të zgjedhë midis një sërë metodologjish të ndryshme vlerësimi dhe të bëjë vlerësime për flukset e ardhshme të parasë dhe normat e skontimit, çmimet e tregut etj.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Prona dhe Ndërtesa

Baza e vlerësimit të pronës dhe ndërtesave është vlera e drejtë. Prona dhe ndërtesat e shoqërisë mëmë u rivlerësuan për herë të fundit më 27 dhjetor 2025 bazuar në vlerësues të jashtëm, të pavarur dhe të kualifikuar. Prona dhe ndërtesat e Filialit janë rivlerësuar për herë të fundit më 31 dhjetor 2022 bazuar në vlerësues të jashtëm, të pavarur dhe të kualifikuar.

5. Shpalosja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Prona dhe Ndërtesa(vazhdimi)

Matja e pronës dhe ndërtesës klasifikohet në nivelin 3 për shoqërinë mëmë dhe në nivelin 2 për filialin të hierarkisë së vlerës së drejtë pasi të dhënat dhe supozimet e përdorura për të arritur në vlerën e drejtë janë të pavëzhgueshme. Në mungesë të një tregu aktiv, vlera e drejtë e pronës dhe ndërtesës së shoqërisë mëmë më u përcaktua duke përdorur mesataren e vlerës së drejtë të tregut që rrjedh nga metoda e krahasimit dhe qasja e të ardhurave. Vlera e drejtë e pronës dhe ndërtesës së Filialit u përcaktua duke përdorur metodën e krahasimit të shitjeve, dhe inputet kryesore sipas kësaj qasjeje janë çmimi për metër katror nga shitjet e vitit aktual të pjesëve të krahasueshme të tokave dhe ndërtesave në zonë (vendndodhja dhe madhësia).

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e drejtë në datën e raportimit minus amortizimin e akumuluar të tokës dhe ndërtesës.

Prona dhe Ndërtesat		Vlera e Drejtë Niveli 1	Vlera e Drejtë Niveli 2	Vlera e Drejtë Niveli 3	
31 Dhjetor 2025		-	2,718	9,330	
31 Dhjetor 2024		-	2,777	8,074	
Prona investuese		Vlera e Drejtë Niveli 1	Vlera e Drejtë Niveli 2	Vlera e Drejtë Niveli 3	
31 Dhjetor 2025		-	895	-	
31 Dhjetor 2024		-	895	-	
31 Dhjetor	Lloji	Çmimi për m ²	Të ardhurat nga qiraja për m ²	Norma e Kapitalizimit	Lokacioni
31 December 2025	Ndërtesë	EUR 5,612	EUR 20	6%	Sheshi Nëna Terezë
31 December 2022	Pronë	EUR 2,000	-	-	Qamil Hoxha
31 December 2022	Ndërtesë	EUR 2,222	-	-	Qamil Hoxha
31 December 2022	Pronë (Pronë Investuese)	EUR 303	-	-	Hajvali
31 December 2022	Ndërtesë (Pronë Investuese)	EUR 379	-	-	Hajvali

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e drejtë në datën e raportimit të pronës investuese

Të dhënat e përdorura për llogaritjen e vlerës së drejtë të tokës dhe ndërtesave janë paraqitur më poshtë:

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Instrumentet financiare jo të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë
Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare jo të matura me vlerën e drejtë dhe analizën sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar.

	Vlera kontabël			Vlera e drejtë				
			Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë	2025	2024	2025	2025	2025	2024	2024	2024
Paraja e gatshme dhe në banka	46,290	41,070	-	46,290	-	-	41,070	-
Gjendja me BQK	66,883	60,555	-	66,883	-	-	60,555	-
Depozitat me afat	9,171	6,481	-	9,171	-	-	6,481	-
Investimi në letra me vlerë	4,125	13,041	-	4,125	-	2,974	10,067	-
Kredi për klientët	560,541	491,220	-	-	560,541	-	-	491,220
Detyrimet								
Depozitat nga klientët	689,564	591,773	-	689,564	-	-	591,773	-
Detyrimet ndaj bankave	2,588	1,096	-	2,588	-	-	1,096	-

Vlera e drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësipërme është përcaktuar duke përdorur Nivelin 1, Nivelin 2 apo 3 të të dhënave të përshkruara më lartë.

5. Shpalosja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)
Balancat me banka dhe depozitat me afat
Detyrimet me bankat e tjera përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe llogaritë. Përderisa balancat me bankat janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar
Vlera e drejtë vlerësohet bazuar në kuotat e ndërmjetësit/tregtarit dhe rendimentit mesatar të instrumenteve të ngjashëm.
Kreditë për klientët

Ku është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Ku transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur metodat e vlerësimit, të tilla si teknikat e fluksit monetar të skontuar. Teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive tregtare dhe të bizneseve të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofole me karakteristika

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Vlera e drejtë e depozitave nga klientët vlerësohet duke përdorur teknikat e skontuara të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat dhe borxhet e varura me maturime dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit. Depozitat kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar e cila përafrohet me vlerën kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normave bazë të interesit që përafrohen me normat e tregut. Shumica e depozitave i nënshtrohen ri-çmimit brenda një viti.

6. Paraja e gatshme dhe në banka

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Paraja e gatshme	19,873	18,078
Llogari rrjedhëse me bankat	26,447	23,042
Lejimet për humbje	(30)	(50)
	46,290	41,070

Paraja dhe ekuivalentet e saj për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë përfshijnë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Paraja e gatshme dhe në banka	46,290	41,070
Gjendja me BQK (Shënimi 7)	66,883	60,555
Rezerva e detyrueshme në BQK	(57,360)	(44,750)
Fondet e tjera të kufizuara	(4,373)	(4,373)
	51,440	52,502

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime likuiditeti, Banka duhet të mbajë minimalisht 10% të depozitave të klientëve me afat maturimi deri në një vit, si rezerva të ligjshme. Rezervat që duhet të njihen ligjerisht përfaqësojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë paratë në dorë, llogaritë në BQK ose në bankat tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervës ligjore. Pasuritë me të cilat Grupi mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50% e ekuivalentit në euro të parave të gatshme të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave.

Lëvizja e zhvlerësimit për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024, e ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	2025	2024
Gjendja fillestar	50	12
Ngarkimi në fitim dhe humbje	(20)	38
Gjendja përfundimtare	30	50

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

7. Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Rezerva e detyrueshme me BQK	57,360	44,751
Llogaritë rrjedhëse	9,539	15,818
Lejimet për humbje	(16)	(14)
	66,883	60,555

	2025	2024
Gjendja fillestare	14	17
Ngarkimi/(lirimi) në fitim dhe humbje	2	(3)
Gjendja përfundimtare	16	14

8. Depozitat me afat

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Depozitat me afat	9,171	6,481
Gjithsej	9,171	6,481
Maturiteti i depozitave		
Maturimi brenda 1 viti	3,672	922
Maturimi pas 1 viti	5,499	5,559
Gjithsej Depozitat	9,171	6,481

Depozitat përbëhen nga depozitat me afat të mbajtura nga bankat vendase. Këto depozita më 31 dhjetor 2025 janë depozita fikse dhe interes të bartur me një normë prej 1.0% deri në 3.8% (2024: 0.9 % to 3.8%) në vit.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Kredi për klientët

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Kreditë	463,697	417,536
Mbitërheqjet	110,624	83,502
	574,321	501,038
Interesi i përlllogaritur	2,279	2,062
Tarifa disbursimi të shtyra	(2,089)	(1,990)
	574,511	501,110
Rregullimi i vlerës së drejtë	(333)	-
	574,178	501,110
Lejimet për humbjet e kredive	(13,637)	(9,890)
Kreditë për klientët	560,541	491,220

Kreditë paraqiten në vlerën nominale, interesi i përlllogaritur bazohet në normat nominale të interesit, ndërsa tarifat e shtyra të disbursimit janë tarifa shtesë që janë pjesë e normës efektive të interesit.
Maturiteti për kreditë afatgjata varion nga 1 deri në 30 vjet (2024: 1 deri 30 vjet). Në 2025, norma e interesit për kreditë ndaj klientëve varioi nga 1.50% në 24% në vit (2024:1.50% në 24% në vit).

Grupi ka dhënë disa kredi me normë interesi në limitin minimal të treguar më lartë, të cilat janë norma më të ulëta se ato që ofrohen përgjithësisht nga Banka dhe mbulohen nga kolateral i parasë së gatshme.
Lëvizjet në provizionet për humbjet nga kreditë janë si më poshtë:

	2025	2024
Lejimet për humbjet e kredive më 1 Janar	9,890	10,269
Kreditë e shlyera	(686)	(3,031)
Ngarkesa për vitin, neto	4,433	2,652
Lejimet për humbjet e kredive më 31 Dhjetor	13,637	9,890

Lëvizja e provizionit për humbje për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024, e ngarkuar ose e liruar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	2025	2024
(Ngarkesa)/Lirimi	(4,433)	(2,652)
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë	1,109	2,369
Rregullimi për portfolion e përvetësuar	373	-
Humbjet neto nga dëmtimi i kredive	(2,951)	(283)

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Kreditë te klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën kontabël bruto dhe lejimin e humbjeve të kredive për klientët me kosto të amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	Gjithsej
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma e provizionit me 1 janar 2025	3,291	716	5,883	-	9,890
<i>Levizjet me impakt ne F&H</i>	-	-	-	-	-
<i>Transferet:</i>	-	-	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(246)	246	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(1,323)	-	1,323	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	33	(33)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(732)	732	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	7	-	(7)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	21	(21)	-	-
Lirimi i HPK-së për çregjistrimin e huave të tjera përveç shlyerjeve	(726)	(158)	(684)	-	(1,568)
Pasuritë e reja financiare me origjinë ose të blera	2,026	282	1,111	-	3,419
Ndryshimet ne Parametrat e Riskut (PD/HDHD/ENP)	1,620	337	607	-	2,564
Ndryshimet ne Modele	-	-	-	-	-
Rikthimi i skontimit	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	(668)	-	(668)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Vlera e provizionit neto për periudhën	1,391	(37)	2,393	-	3,747
Lëvizje të tjera pa impakt në F&H	-	-	-	-	-
Instrumente të ç'regjistruara	-	-	-	-	-
Shuma e provizionit më 31 Dhjetor 2025	4,682	679	8,276	-	13,637

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Kreditë te klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive me kosto të amortizuar

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	Gjithsej
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma bruto e bartur më 1 janar 2025	469,496	21,588	9,954	-	501,038
<i>Transferimet:</i>	-	-	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(2,327)	2,327	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(3,571)	-	3,571	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	5,988	(5,988)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(1,948)	1,948	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	935	-	(935)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	68	(68)	-	-
Pasuritë financiare të ç'regjistruara gjatë periudhës përveç shlyerjeve	(134,046)	(7,805)	(1,170)	-	(143,021)
Instrumente financiare te reja, me origjinë ose të blera	284,330	8,312	2,665	-	295,307
Modifikimet në rrjedhën e parasë kontraktuale	(74,193)	(3,628)	(514)	-	(78,335)
Shlyerjet	-	-	(668)	-	(668)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Shuma bruto e bartur më 31 dhjetor 2025	546,612	12,926	14,783	-	574,321
Kreditë te klientët (vazhdim)					

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në lejmit e kredive me kosto të amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	Gjithsej
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma e provizionit me 1 janar 2024	2,570	712	6,987	-	10,269
<i>Levizjet me impakt ne F&H</i>	-	-	-	-	-
<i>Transferet:</i>	-	-	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(285)	285	-	-	-

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Transfer nga faza 1 në fazën 3	(1,630)	-	1,630	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	6	(6)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(306)	306	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	9	-	(9)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	8	(8)	-	-
Lirimi i HPK-së për çregjistrimin e huave të tjera përveç shlyerjeve	(703)	(234)	(590)	-	(1,527)
Pasuritë e reja financiare me origjinë ose të blera	1,674	259	216	-	2,149
Ndryshimet ne Parametrat e Riskut (PD/HDHD/ENP)	1,650	(2)	356	-	2,004
Ndryshimet ne Modele	-	-	-	-	-
Rikthimi i skontimit	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	(3,005)	-	(3,005)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Vlera e provizionit neto per periudhen	721	4	(1,104)	-	(379)
Lëvizje të tjera pa impakt në F&H	-	-	-	-	-
Instrumente të ç'regjistruara	-	-	-	-	-
Shuma e provizionit më 31 Dhjetor 2024	3,291	716	5,883	-	9,890

9. Kreditë te klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive me kosto të amortizuar

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	Gjthsej
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma bruto e bartur më 1 janar 2024	422,831	18,012	10,047	-	450,890
<i>Transferimet:</i>					
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(3,754)	3,754	-	-	-

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Transfer nga faza 1 në fazën 3	(3,442)	-	3,442	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	832	(832)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(973)	973	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	152	-	(152)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	25	(25)	-	-
Pasuritë financiare të ç’regjistruara gjatë periudhës përveç shlyerjeve	(117,958)	(7,286)	(896)	-	(126,140)
Instrumente financiare te reja, me origjinë ose të blera	238,038	11,694	409	-	250,141
Modifikimet në rrjedhën e parasë kontraktuale	(67,203)	(2,806)	(839)	-	(70,848)
Shlyerjet	-	-	(3,005)	-	(3,005)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Shuma bruto e bartur më 31 dhjetor 2024	469,496	21,588	9,954	-	501,038

10. Investime në letrat me vlerë

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Investimet në letrat me vlerë – në VDATGJ		
Obligacionet qeveritare	99,755	47,768
Interes i llogaritur	191	48
Rregullimi i vlerës së drejtë	88	-
Lejimet për humbje	(54)	(26)
Gjithsej investimet në letrat me vlerë	99,980	47,790

Investimet në letrat me vlerë – në koston e amortizuar

Obligacionet qeveritare	4,101	12,859
Interes i llogaritur	24	184
Lejimet për humbje	-	(2)
Investimet në letrat me vlerë – në koston e amortizuar	4,125	13,041
Investimet në letrat me vlerë	104,105	60,831

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Mesatarja e ponderuar, e periudhës së mbetur të fletëobligacioneve/bono me mbyllje të vitit 2025 është < 0,6 vite (2024 <0.5 vite) , derisa periudha më e largët e investimeve është 4 vite, të shprehura në EURO,USD dhe CHF.

Portofoli i investimeve të Grupit është klasifikuar në dy pjesë me kosto të amortizuar dhe VDATGJ, dhe të gjitha këto investime janë investuar në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës, Francës, Zvicrës, Gjermanisë, Austrisë dhe SHBA-së. Grupi ka bono thesari ose obligacione të cilat janë klasifikuar në koston e amortizuar më 31 dhjetor 2025.

Grupi ka 10 obligacione qeveritare (vendase) dhe 9 bono thesari (të huaja) në dhjetor 2025 të cilat janë klasifikuar në VDATGJ dhe kosto te amortizuar, maturimi mesatar i ponderuar për këto obligacione është 0.90 vjet (2024: 0.57 vjet) dhe mesatarja e interesit është 2.66% (2024:3.02%).

Tabela e mëposhtme paraqet lëvizjen e investimeve në letra me vlerë gjatë viteve 2025 dhe 2024:

	Investimet në VDATGJ	Investimet me Kosto të Amortizuar	Total
Më 01 January 2025	47,768	12,859	60,627
Shtesat	296,383	-	296,383
Shlyerjet	(251,568)	(8,758)	(260,326)
Të përvetësuara përmes blerjes	7,051		7,051
Rregullimi i vlerës së drejtë	88	-	88
Fitimi / (humbja) e parealizuar	121	-	121
Më 31 December 2025	99,843	4,101	103,944
Më 01 January 2024	10,546	5,049	15,595
Shtesat	119,556	63,524	183,080
Shlyrejet	(82,471)	(55,714)	(138,186)
Fitimi / (humbja) e parealizuar	137	-	137
Më 31 December 2024	47,768	12,859	60,627

11 Prona, Impiante dhe Pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi
Më poshtë është një ndarje e pronave dhe pajisjeve në pronësi dhe me qira:

	2025	2024
Prona, dhe pajisjet në pronësi	15,044	13,770
Pasuritë me të drejtë përdorimi SNRF 16	3,192	3,050
Prona, Impiante dhe Pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	18,236	16,820

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Grupi jep me qira disa pasuri të cilat përbëhen nga objekte. Informacioni rreth pasurive me të drejtë të përdorimit dhe detyrimeve të qirasë për të cilat Grupi është qiramarrës është paraqitur më poshtë:

Pasuritë me të drejtë përdorimi	2025	2024
Gjendja më 1 Janar	3,050	3,151
Shtesat në vitin aktual	1,474	2,425
Shlyerjet/kontrata të ndërprera	(77)	(1,174)
Shpenzimet e zhvleresimit per vitin	(1,255)	(1,352)
Gjendja më 31 Dhjetor	3,192	3,050

Detyrimi ndaj qirasë më 1 Janar 2024	2,953
+ Shtesat	1,512
- shlyerjet	(280)
- pagesat e qirasë	(1,178)
+ Interesi mbi detyrimet e qirasë	91
Detyrimi i qirasë më 31 Dhjetor 2024	3,098
+ Shtesat	1,464
- shlyerjet	(57)
- pagesat e qirasë	(1,358)
+ Interesi mbi detyrimet e qirasë	153
Detyrimi i qirasë më 31 Dhjetor 2025	3,330

Shumat e njohura si fitim ose humbje te Grupit për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024:

	2025	2024
Interesi mbi detyrimet e qirasë - SNRF 16	(53)	(91)
Zhvlerësimi për Pasuritë me të drejtë përdorimi	(1,255)	(1,352)
Shpenzimet totale nga qiratë	(1,408)	(1,443)

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

11. Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi (vazhdim)

<i>Kostoja ose Rivlerësimi</i>			Përmirësimet e	Mobiljet, instalime	Kompjutera dhe		
	Toka	Ndërtesat	qirasë	dhe pajisje	pajisje të lidhura	Automjete	Gjithsej
Në 1 Janar 2024	530	13,234	1,306	4,104	2,505	1,196	22,875
Shtesat	-	-	324	773	341	18	1,456
Shlyerjet	-	-	(332)	(431)	(66)	(93)	(922)
Më 31 Dhjetor 2024	530	13,234	1,298	4,446	2,780	1,121	23,409
Rivlerësim	-	1,579	-	-	-	-	1,579
Shtesat	-	-	29	293	439	354	1,115
Shlyerjet	-	(3,118)	(371)	(84)	(66)	(124)	(3,763)
Më 31 Dhjetor 2025	530	11,695	956	4,655	3,153	1,351	22,340
Në 1 Janar 2024	-	2,558	716	2,970	1,929	811	8,984
Shpenzimi për vitin	-	382	204	495	281	124	1,486
Shlyerjet	-	-	(301)	(374)	(63)	(93)	(831)
Më 31 Dhjetor 2024	-	2,940	619	3,091	2,147	842	9,639
Shpenzimi për vitin	-	382	187	389	290	132	1,380
Shlyerjet	-	(3,118)	(359)	(81)	(67)	(98)	(3,723)
Më 31 Dhjetor 2025	-	204	447	3,399	2,370	876	7,296
<i>Vlera Kontabël</i>							
Më 31 Dhjetor 2024	530	10,294	679	1,355	633	279	13,770
Më 31 Dhjetor 2025	530	11,491	509	1,256	783	475	15,044

Më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024, Grupi nuk ka asnjë pronë ose pajisje të lënë peng si kolateral.

11. Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi (vazhdim)
 Nëse toka dhe ndërtesat do të deklaroheshin sipas konventës së kostos historike,shumat do ishin :

	2025	2024
Gjendja më 1 Janar	6,416	6,557
Më pak: Zhvlerësimi	(141)	(141)
Gjendja më 31 Dhjetor	6,275	6,416

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

12. Pasuritë e paprekshme

Kosto	Emri i mirë	Softueri	Pasuritë e paprekshme në vijim	Gjithsej
Më 1 Janar 2024	1,835	2,696	2,282	6,813
Shtesat gjatë vitit	-	702	16	718
Transfer	-	1,184	(1,184)	-
Shlyerjet	-	(770)	-	(770)
Zhvlerësimi	-	-	(365)	(365)
Më 31 Dhjetor 2024	1,835	3,812	749	6,396
Shtesat gjatë vitit	-	840	96	936
Transferet	-	143	(143)	-
Shlyerjet	-	(469)	-	(469)
Humbja nga zhvlerësimi	-	-	(580)	(580)
Më 31 Dhjetor 2025	1,835	4,326	122	6,283
Amortizimi akumuluar				
Më 1 Janar 2024	-	1,094	-	1,094
Shpenzimi për vitin	-	763	-	763
Shlyerjet	-	(556)	-	(556)
Më 31 Dhjetor 2024	-	1,301	-	1,301
Shpenzimi për vitin	-	1,092	-	1,092
Shlyerjet	-	(337)	-	(337)
Më 31 Dhjetor 2025	-	2,056	-	2,056
Vlera kontabël			-	
Më 31 Dhjetor 2024	1,835	2,511	749	5,095
Më 31 Dhjetor 2025	1,835	2,270	122	4,227

Shoqëria Mëmë ka nënshkruar një kontratë të re në Nëntor 2018 për zhvillimin e sistemit të ri kryesor bankar.

Shoqëria mëmë arriti në përfundim se funksionaliteti i sistemit të ri nuk plotëson plotësisht infrastrukturën e tyre ekzistuese të TI-së, si rezultat në vitin 2022 si dhe me një rishikim shtesë në vitin 2023, Shoqëria Mëmë rihyri në një diskutim me kontraktorin dhe negocioi një kontratë të rishikuar, sipas së cilës sistemi bankar ekzistues do të përmirësohej për të mbuluar të gjitha zhvillimet që ishin parashikuar fillimisht në kuadër të sistemit të ri bankar bazë, pa asnjë kosto shtesë për Shoqërinë mëmë. Shoqëria mëmë dhe Kontraktori kanë rënë dakord për një listë specifike të moduleve dhe përmirësimeve që do të kryhen në sistemin ekzistues kryesor bankar, me afatin kohor të përfundimit të mbajtur të njëjtë me kontratën bazë, pra, në fundvit 2024.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Për shkak të mos përmbushjes së kërkesave kontraktuale të përfundimit të projekteve, më 29 dhjetor 2023 u miratua një amandament, duke ndryshuar marrëveshjen midis Shoqërisë Mëmë dhe Kontraktorit. Ky ndryshim zgjati afatet për projektet e papërfunduara, krahas rialokimit të burimeve mes tyre, me një përfundim të parashikuar në vitin 2024, që më pas u shtye për 2025. Në të kundërt, pas analizimit të shumës së rikuperueshme të këtyre projekteve të papërfunduara, është njohur një humbje nga zhvlerësimi shtesë prej 580 mijë euro më 31 dhjetor 2025 (2024: 365 mijë euro) në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

12. Pasuritë e paprekshme (vazhdim)

Emri i mirë përbëhet kryesisht nga përfitimet e ardhshme ekonomike dhe sinergjitë me operacionet ekzistuese dhe nuk është i zbritshëm për qëllime tatimore. Grupit i kërkohet të testojë, në baza vjetore, nëse emri i mirë ka pësuar ndonjë zhvlerësim. Shuma e rikuperueshme përcaktohet në bazë të llogaritjeve të vlerës në përdorim. Përdorimi i kësaj metode kërkon vlerësimin e rrjedhjeve monetare të ardhshme dhe përcaktimin e një norme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të rrjedhjeve monetare. Deri në datën e raportimit, emri i mirë nuk është i zhvlerësuar. Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 Grupi nuk ka pasuri të paprekshme të vendosura si kolateral.

12. Pasuritë tjera

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Të arkëtueshmet nga personat e ndërlidhur	-	1,170
Të arkëtueshmet e sigurimit (shenimi 13.1)	1,727	1,299
Pjesa e risiguruesit për provizionet teknike	781	882
Prona investuese (shënimi 13.2)	895	895
Pronat e riposeduara (shenimi 13.3)	1,560	737
TVSH e arkëtueshme	358	266
Interesi i parapaguar mbi depozitat	152	128
Parapagimet	475	710
Të arkëtueshmet nga KIB	459	503
Kostot e shtyera të blerjes (shenimi 13.4)	625	601
Periudha aktuale e primit të pafituar (Risigurim i ceduar)	317	1,176
Të arkëtueshme nga risiguruesit	153	101
Të tjera	1,621	784
Lejimet për humbje	(647)	(620)
Gjithsej	8,476	8,632

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

13.1 Të arkëtueshmet e sigurimit janë shuma të detyrimeve nga klientët për primet e sigurimit për kontratat e sigurimit të shitura në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Shuma pritet të mblihdet brenda një viti ose më pak. Të arkëtueshmet e sigurimit në fund të vitit përfshijnë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Të arkëtueshme nga klientët	2,159	1,593
Të arkëtueshme nga agjentët	34	32
Minus: lejimet për humbje	(466)	(326)
Gjithsej sigurimi i arkëtueshëm	1,727	1,299

13.2 Prona e investuar më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përfshin një tokë në Hajvali, Prishtinë. Shumat e rivlerësuara përcaktohen në bazë të vlerësimit të kryer nga një vlerësues profesionist i pavarur duke përdorur metodën e çmimeve të krahasueshme. Gjatë prillit 2023, Grupi ka rivlerësuar pronën e investuar dhe nuk ka pasur ndryshime në vlerën e drejtë të pronës së investuar.

13.3 Lëvizjet në pronën e riposeduar gjatë viteve janë paraqitur më poshtë:

	2025	2024
Gjendja më 1 Janar	737	868
Shtesat në vitin aktual	1,268	1,636
Shitjet gjate vitit	(170)	(1,498)
Shlyerjet	(275)	(269)
Gjendja më 31 Dhjetor	1,560	737

13. Pasuritë të tjera (vazhdim)

13.4 Kostot e shtyra të blerjes në fund të vitit përfshijnë:

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Komisionet për agjentët	532	507
Tarifat e BQK-së	93	94
Gjithsej	625	601

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

14. Depozita nga klientët

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Llogaritë rrjedhëse	282,158	266,822
Llogaritë e bllokuara	16,781	15,858
Depozitat Flexi	4,352	4,854
Llogaritë e kursimit	34,858	32,919
	338,149	320,453
Shtuara: Maturimi afatshkurtë i depozitave afatgjatë	228,929	147,688
Gjithsej depozitat afatshkurtëra të klientëve	567,078	468,141
 Depozita me afat	 345,918	 265,894
	345,918	265,894
Zvogëluara: Maturimi afatshkurtë i depozitave afatgjatë	(228,929)	(147,688)
Gjithsej depozitat afatgjata të klientëve	116,989	118,206
Interes i përlllogaritur	6,059	5,426
Totali para rregullimit të vlerës së drejtë	690,126	591,773
Rregullimi i vlerës së drejtë	(562)	-
Gjithsej	689,564	591,773

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.
Normat mesatare efektive të interesit për depozitat me afat në vitin 2025 dhe 2024 ishin si vijon:

Viti	1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 -5 vite	>5 vite
2025	0.09%	3.06%	2.93%	2.91%	2.81%	2.80%	3.37%
2024	0.03%	2.70%	2.44%	2.58%	2.40%	2.64%	2.51%

15. Detyrimet ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave prej 2,588 mijë euro (2024: 1,096 mijë euro) përfaqësojnë llogari rrjedhëse nga bankat vendase

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

16. Detyrimet e provizioneve teknike

	2025	2024
Dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNS)	7,864	7,191
Dëmet e ndodhura por jo të raportuara (IBNR)	4,939	4,740
Rezerva e kostos së trajtimit të dëmeve	190	176
Gjithsej	12,993	12,107

Tabela në vazhdim përmbledh lëvizjen e detyrimeve për provizione teknike:

	2025	2024
Më 01 Janar	12,107	11,783
E blerë me kombinim biznesi	-	-
Të ndodhura gjatë vitit	7,612	6,641
Të paguara gjatë vitit	(6,726)	(6,317)
31 Dhjetor	12,993	12,107

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagimin e dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës, në zbatim të dispozitave të neneve 18, 19, 20, 21, dhe 22 të Ligjit Nr. 04 / L-018 për sigurimin e detyrueshëm të palës së tretë të sigurimit të automjeteve motorike. Roli i saj është të paguajë sigurim demesh në lidhje me aksidente të shkaktuara nga automjete të pasiguruara, automjete të panjohura ose ngjarje të tjera të specifikuara. Gjatë vitit 2025 dhe 2024, financimi i fondit të kompensimit është bërë bazuar në rregulloren e re të miratuar nga BQK-ja më 28 dhjetor 2017.

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2025 and 2024 Grupit iu kërkua të kontribuojë në Fondin e Kompensimit një shumë prej 357 mijë euro dhe 368 mijë euro. Për më tepër, kompanitë e sigurimeve kanë marrë përgjegjësi kolektive për të siguruar Fondin e Kompensimit me fonde të mjaftueshme për të qenë në gjendje të përmbushin të gjitha demet e ardhshme në rast se demet dhe kostot e bëra nga Fondi i Kompensimit e tejkalojn tepricën e mbajtur. Shuma e pagueshme në fondin e kompensimit në lidhje me detyrimet për vitin 2025 dhe 2024 është 8 mijë euro dhe 44 mijë euro përkatësisht më 31 dhjetor 2025 dhe 2024.

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

17. Provizioni për prime të pafituara

	Bruto provizioni për prime të pafituara	Pjesa e risiguruesit në primin e pafituar	Neto provizioni për prime të pafituara
31 Dhjetor 2025			
Sigurimi i mjeteve motorike me përgjegjësi të palës së tretë (TPL)	4,058	-	4,058
Pjesa e të ardhurave të BKS-së	70	-	70
Shëndeti dhe Udhëtimet	330	-	330
Sigurimi i Kontratës	279	(196)	83
Aksidentet personale	307	-	307
Sigurimi i Pronës	360	(122)	238
Sigurimi i detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (TPL+)	256	-	256
Përgjegjësia publike për sigurime	78	-	78
CIS & CIT	-	-	-
Kasko	772	-	772
Sigurime tjera	126	-	126
Gjithsej	6,636	(318)	6,318

	Bruto provizioni për prime të pafituara	Pjesa e risiguruesit në primin e pafituar	Neto provizioni për prime të pafituara
31 Dhjetor 2024			
Sigurimi i mjeteve motorike me përgjegjësi të palës së tretë (TPL)	3,534	-	3,534
Pjesa e të ardhurave të BKS-së	65	-	65
Shëndeti dhe Udhëtimet	240	-	240
Sigurimi i Kontratës	1,102	(1,073)	29
Aksidentet personale	139	-	139
Sigurimi i Pronës	312	(102)	210
Sigurimi i detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (TPL+)	222	-	222
Përgjegjësia publike për sigurime	74	-	74
CIS & CIT	-	-	-

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Kasko	625	-	625
Sigurime tjera	114	-	114
Gjithsej	6,427	(1,175)	5,252

Lëvizja e provizionit për primin e pafituar

	2025	2024
Më 1 Janar	6,427	5,168
Plus: Rritja neto e primeve të pafituara gjatë vitit	209	1,259
Gjendja më 31 Dhjetor	6,636	6,427

17. Provizioni për prime të pafituara (vazhdim)

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Primi i shkruar bruto	14,392	14,075
Pjesa e risiguruesve në primin e shkruar bruto	(896)	(2,055)
Primi i shkruar neto	13,496	12,020
Ndryshimi në provizionin bruto për primet e pafituara	(209)	(1,258)
Ndryshimi në Pjesën e Risiguruesit të provizionit për primet e pafituara	(859)	770
Primi i fituar neto, neto nga tatimi mbi primin	12,428	11,532

18. Borxhi i varur

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Isdiar L.L.C.	214	200
Afrim Pacolli	2,136	-
Totali	2,350	200

Gjatë vitit 2025, Kompania Mëmë hyri në një marrëveshje kredie të varur me Afrim Pacollin (palë e lidhur) në shumën prej 2,000 mijë euro. Kredia ka një normë interesi prej 7.7% në vit, të pagueshme në shtatë këste, dhe principali paguhet në një këst të vetëm më 4 shkurt 2032.

Gjatë vitit 2024, Filiali hyri në një marrëveshje për borgjin e varur me ISDIAR L.L.C. në shumën prej 200 mijë euro. Huaja ka një normë interesi prej 7% në vit, e pagueshme në gjashtë këste, pesë pagesa në fund të çdo viti më 31 dhjetor dhe pagesa e fundit më 31 janar 2030, dhe principali është i pagueshëm në një këst të vetëm më 31 dhjetor 2030.

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

19. Detyrimet tjera

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Detyrimet e qirasë (Shënimi 11)	3,300	3,098
Risigurimi i pagueshëm	95	92
Shpenzimet akruale	827	553
Të pagueshme ndaj BKS	8	44
Llogaritë e pagueshme tregtare	172	189
Taksa të tjera të pagueshme	183	151
Të ardhura të tjera të shtyra	126	220
Provizion për humbjet nga garancitë	246	37
Provizione për kontestet gjyqësore	295	153
Tarifat e pensioneve dhe asistencës sociale	53	43
Të pagueshme të tjera	298	276
Gjithsej	5,603	4,856

Lëvizja në provizionin për humbje nga garancitë e lëshuara nga Grupi është si më poshtë:

	2025	2024
Provizionet më 1 janar	37	84
(Lirimi)/Ngarkesa gjatë vitit (Shënimi 23)	209	(47)
Provizionet më 31 dhjetor	246	37

20. Ekuiteti dhe rezervat

Ekuiteti i nënshkruar dhe paguar i Shoqërisë mëmë përbëhet nga 151,851 aksione të zakonshme (2024: 114,930 aksione të zakonshme) me vlerë nominale 256 euro secili (2024: 256 euro). Struktura aksionare e Shoqërisë mëmë është si më poshtë:

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Më 31 Dhjetor 2025		Më 31 Dhjetor 2024	
	%	Vlera	%	Vlera
Behgjet Pacolli	35	13,659	35	10,246
Immobiliare Red L.L.C.	29	11,200	29	8,402
Immobiliare Blue L.L.C.	18	7,146	18	5,360
Xhabir Kajtazi	12	4,642	12	3,482
Ismet Gjoshi	3	987	3	987
Hasan Hajdari	1	396	1	297
Zyhra Hajdari	1	380	1	285
Të tjerë me më pak se 1%	1	464	1	363
	100	38,874	100	29,422

Mbajtësit e aksioneve të zakonshëm kanë të drejtë të marrin dividendë kur deklarohen herë pas here dhe kanë të drejtën e një vote për aksion. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Grupit.

Asnjë dividendë nuk është shpallur dhe/ose paguar gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2025, (2024: Dividendat në shumën prej 3,000 mijë euro me 26.1 euro për aksion u paguan më 3 qershor 2024).

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2025, Banka, në mbledhjen e aksionarëve, miratoi emetimin e 38,281.25 aksioneve të zakonshme (2024: Asnjë) me një çmim prej 256 euro për aksion. Të gjitha aksionet e zakonshme u emetuan me vlerën nominale prej 256 euro për aksion. Emetimi i aksioneve të reja u miratua nga Banka Qendrore e Kosovës përmes vendimit nr. 63 – 24/2025 më 27 Qershor 2025, i cili hyri në fuqi më 1 Korrik 2025.

Në përputhje me ligjin nr. 04/L-093 për “Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare”, minimumi i kapitalit të paguar për bankat vendase që veprojnë në Kosovë është 7 milion euro

Lëvizjet në rezervën e rivlerësimit janë si në vijim:

	2025	2024
Rezerva e rivlerësimit më 1 Janar	4,887	4,746
Rivlerësimi i pronës (neto nga tatimi)	1,598	4
Rezerva e rivlerësimit të investimeve në letra me vlerë e matur në VDATGJ	121	137
Gjendja më 31 Dhjetor	6,606	4,887

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

21. Te ardhurat neto nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Të ardhurat nga interesi		
Kreditë e klientëve	37,696	33,378
Depozitat dhe llogaritë me bankat	644	925
Investime në letra me vlerë	2,028	1,957
Gjithsej të ardhurat nga interesi	40,368	36,260
Shpenzimet e interesit		
Depozitat nga klientët	(8,651)	(7,582)
Borxhi i varur	(150)	-
Interesi mbi detyrimet e qirasë SNRF 16	(153)	(91)
Gjithsej shpenzimet e interesit	(8,954)	(7,673)
Te ardhurat neto nga interesi	31,414	28,587

22. Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Shërbimet bankare	6,367	5,552
Garancitë	433	389
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet	6,800	5,941
Shpenzime për Swift	(1,386)	(1,105)
Tarifa për liçensë dhe tarifa të tjera rregullatore	(622)	(562)
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(2,008)	(1,667)
Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	4,792	4,274

23. Të ardhura të tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Fitimet nga shitja e aseteve të riposeduara	59	346
Fitim nga shitja e investimeve	(7)	5
Fitimet/(humbjet) neto nga këmbimi valutor – (shënimi 23.1)	143	150
Të ardhurat tjera	384	494
	578	995

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

23.1 Fitimet/(humbjet) neto nga këmbimi valutor përfshijnë fitimet nga këmbimi në vlerë prej 11,210 mijë euro (2024: 5,452 mijë) dhe humbjet nga këmbimi në vlerë prej 11,067 mijë euro (2024: 5,302 mijë).

24. Shpenzimet e personelit

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Paga dhe mëditje	8,208	7,253
Kontribute për pension	419	385
Kompensime të tjera	238	196
Gjithsej	8,865	7,834

25. Shpenzimet e tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Riparimi dhe mirëmbajtja	2,075	1,827
Shërbimet IT	1,585	1,622
Të Tjera	1,568	757
Tarifat e Sigurimit të Depozitave	1,307	869
Shpenzimet Operative të Master Card	1,333	1,163
Siguria	1,265	1,163
Shpenzimet e Konsulencës	524	388
Sponsorizimi-i Lejuar për Qëllime Tatimore	487	407
Reklama dhe Marketingu	478	670
Shpenzimet e Kartës Visa	472	328
Shpenzimet Publike dhe Karburanti	398	382
Shpenzime profesionale dhe tarifa të tjera ligjore të lidhura	374	913
Shlyerja e Aseteve të Riposeduara	275	269
Komunikimi	277	254
Shpenzimet e Tarifave të Lidhura me FKGK	273	174
Shpenzimet e sigurimit	262	336
Kontribut në KIB për shpenzime administrative	239	257
Ngarkesa për Provisions Ligjore	213	158
Shpenzimet për garancione	209	(47)
Shpenzimet e BQK-së	208	222
Shlyerja e Aseteve të Paisjeve dhe Aseteve të Paprekshme	180	314
Provizion për të arkëtueshme nga sigurimet	140	70
Shpenzimet e Përfaqësimit	131	203

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Materialet e Zyrës	108	92
Shërbimet e Mbledhjes së Kredive	92	401
Udhëtimi	49	60
Zhvlerësimi i Aseteve Tjera	27	620
Printime	34	48
Gjithsej	14,583	13,920

26. Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhura në Kosovë llogaritet në shkallën 10% (2024: 10%) të të ardhurave të tatueshme.
 Në vijim paraqitet një barazim i rezultatit kontabël me tatimin në fitim:

	2025	2024
Ftitimi para tatimit (përjashtuar sponsorizimin)	14,257	13,092
Tatimi në shkallën 10%	1,426	1,309
<i>I rregulluar për:</i>		
Shpenzime të pazbritshme	494	492
Shpenzime interesi shtesë të zbritshme	53	(22)
Të ardhura të përjashtuara	(40)	(33)
Lejime per kredi	(197)	(220)
Shtoni shpenzimet e lejuara të interesit	96	83
Ndryshimet në rezervat teknike	8	16
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat për vitin	1,840	1,625
<i>Norma efektive tatimore</i>	12.90%	12.65%
Sponsorizimi në kulutrë dhe sport (deri në 30% të shpenzimit të tatimit në fitim)	(487)	(407)
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	1,353	1,218
Ngarkesa e tatimit të shtyrë	14	14
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat e njohura në fitim dhe humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	1,367	1,232

Dallimet midis pasqyrave financiare sipas IFRS dhe rregullave tatimore statutore në Kosovë krijojnë diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të disa aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe për qëllime tatimore. Efekti tatimor i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme regjistrohet me normën 10%.
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, detyrimi total i tatimit të shtyrë i liruar përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është zero (2024: 4 mijë), ndërsa shuma e ngarkuar në fitim-humbje është 14 mijë (2024: 14 mijë).

27. Zotimet dhe Kontigjencat

Grupi lëshon garanci për klientët e tij. Këto instrumente bartin një rrezik kredie të ngjashëm me atë të kredive të dhëna klientëve. Bazuar në vlerësimin e menaxhmentit, nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me garancitë e papaguara më 31 dhjetor 2025 dhe 2024.

Garancitë	2025	2024
Siguruara me depozita	5,662	2,545
Siguruara me kolateral tjetër	11,659	10,661
	17,321	13,206
Zotimet kreditore		
Kreditë e aprovuara por jo të lëshuara	11,514	3,580
Mbitërheqjet	23,021	19,532
Kredit kartela	8,873	7,945
Objektet e kartës së kreditit të papërdorur	43,408	31,057

Kolaterale të tjera të zotuara për garanci, përfshijnë kryesisht pronat e pengut dhe të pasurive të paluajtshme. Zotimet përfaqësojnë bilancet e huaja të kredive, mbitërheqje dhe limit kartelat që u jepen klientëve.

27. Zotimet dhe Kontigjencat (vazhdim)

Çështjet gjyqësore

Grupi është i ekspozuar ndaj dëmeve të ndryshme dhe veprimeve ligjore në rrjedhën e zakonshme të biznesit.

Më 31 Dhjetor 2025, Shoqëria Mëmë ka njohur provizione në vlerën 149 mijë euro (31 dhjetor 2024: 153 mijë euro), në lidhje me procedurat ligjore. Më 31 dhjetor 2025, filiala ka 876 lëndë juridike, me rezervë 2,022 mijë euro, (31 dhjetor 2024: 750 çështje juridike me rezervë në vlerë prej 1,981 mijë euro).

Menaxhmenti beson se provizionet e njohura janë një vlerësim i arsyeshëm kundrejt rezultatit të padive në vazhdim kundër Grupit më 31 dhjetor 2025. Për më tepër, sipas opinionit të Menaxhmentit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk pritet të ketë një efekt negativ material në pozicionin financiar të grupit ose ndryshime në pasuritë neto, përveç rasteve kur është përfshirë tashmë në rezervat e kontratës së sigurimit.

28. Transaksionet me palët e lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Transaksionet me palët janë bërë në kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet në treg.

Në rrjedhën e kryerjes së aktiviteteve bankare, Grupi hyn në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe gjendjet me aksionarët dhe individët apo shoqëritë e tjera të lidhura më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë si më poshtë:

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Pasuritë	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura		Gjithsej	
	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
<i>Kreditë e klientëve</i>								
Kreditë e klientëve, net	39	85	507	557	7,420	5,534	7,966	6,176
Pasuritë e paprekshme në progres	-	-	-	-	122	541	122	541
Të arkëtueshmet – B&A	-	-	-	-	-	1,170	-	1,170
Lejimet – B&A	-	-	-	-	(647)	(620)	(647)	(620)
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	206	125	206	125
Gjithsej Pasuritë	39	85	507	557	7,107	6,750	7,653	7,392
Detyrimet								
Depozita nga klientët	(55)	(94)	(435)	(275)	(47,942)	(18,362)	(48,432)	(18,731)
Borxh i varur	-	-	-	-	(2,350)	(200)	(2,350)	(200)
Të Pagueshmet Tjera	-	-	-	-	(47)	(78)	(47)	(78)
Gjithsej Detyrimet	(55)	(94)	(435)	(275)	(50,339)	(18,640)	(50,829)	(19,009)
Garancitë	-	-	-	-	245	503	245	503
Gjithsej jashtë bilancit	-	-	-	-	245	503	245	503

Vlera totale e vlerësuar e kolateralit nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2025 ishte 36,357 mijë euro (Më 31 dhjetor 2024: vlera e tillë e vlerësuar ishte 24,765 mijë euro).

Angazhimet e papërdorura për kredi me palët e lidhura më 31 dhjetor 2025, janë 1,126 mijë euro (2024: 1,096 mijë euro). Depozitat e palëve të ndërlidhura përbëjnë 6.97 % (2024: 3.10 %) të gjendjes totale të depozitave të klientëve.

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

28. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura gjatë 2025 dhe 2024 janë si në vijim:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura		Gjithsej	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Të hyrat nga interesi	5	8	6	10	470	537	481	555
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	1	2	3	5	147	101	151	108
Premia Neto e Fitimit, Neto nga Tatimi mbi Premiumin	-	-	-	-	524	1,812	524	1,812
Shpenzimet e interesit	-	-	-	-	(257)	(108)	(257)	(108)
Shpenzimet e implementimit-BV	-	-	-	-	(1,392)	(1,399)	(1,392)	(1,399)
Shpenzimet – B&A	-	-	-	-	(1,404)	(1,664)	(1,404)	(1,664)
Shpenzimet - Royal Security	-	-	-	-	(18)	(84)	(18)	(84)
Shpenzimet per Qerate	-	-	-	-	(577)	(427)	(577)	(427)
Shpenzimet kapitale – B&A	-	-	-	-	(517)	(1,758)	(517)	(1,758)

Shpërblimi total për menaxhmentin kryesor të Grupit është si më poshtë:

	2025	2024
Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve për Bordin e Drejtorëve	111	154
Përfitimet afatshkurtëra te punonjësve për Menaxhmentin kyç	770	771
	881	925

29. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues

(a) Hyrje dhe përmbledhje

Grupi është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i tregut
- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit

Grupi gjithashtu ka ekspozim ndaj rreziqeve të sigurimit nga lëshimi i kontratave të sigurimit. Grupi lëshon kryesisht llojet e mëposhtme të kontratave të sigurimit:

- Sigurimi i përgjegjësisë motorike ndaj palëve të treta,
- Sigurim shëndetsor,
- Sigurim i pronës,
- Sigurimi i dëmshpërblimit profesional
- Kontrata të tjera të sigurimit

Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Ky shënim paraqet informacion në lidhje me ekspozimin e Grupit ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Grupit për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Grupit.

Bordi i Drejtorëve të Grupit ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Grupit. Bordi ka krijuar Komitetin e Aseteve dhe Detyrimeve ("ALCO"), Komitetin e Kreditit të Komitetit të Likuiditetit, Komitetin e Auditimit dhe Komitetin e Riskut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Grupit në fushat e tyre të specifikuar. Të gjitha komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe joekzekutivë dhe i raportojnë rregullisht Bordit të Drejtorëve për aktivitetet e tyre. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Grupit janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Grupi, për të vendosur kufijtë dhe kontrollet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Grupi synon të zhvillojë mjedis kontrolli konstruktiv, në të cilin punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Grupit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të Grupit dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit për menaxhimin e rrezikut në raport me rreziqet me të cilat përballet Grupi. Komiteti i Auditimit të Grupit në këto funksione ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Auditimi i Brendshëm kryen rishikime në mënyrë të rregullta dhe spontane të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të rrezikut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Grupi operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike në zhvillim të sipër. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Grupit. Menaxhmenti i Grupit monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare.

Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe merr masat e përshtatshme në lidhje me rrezikun e kredisë, të tregut (normës primare të interesit) dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet negative të mundshme nga kriza financiare dhe ekonomike globale. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet sfidave të tregut, duke mbajtur një pozicion të mjaftueshëm likuid dhe të kapitalit.

(b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të Grupit nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Grupi merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Menaxhimi i rrezikut kreditor

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut kreditor. Një departament të veçantë i Rrezikut kreditor është përgjegjës për administrimin e rrezikut të kredisë të Grupit. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut kreditor për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë së huamarrësit.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfutur kolateral dhe garanci.

29. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë kreditore të asetet financiare dhe lejimet për zhvlerësime/humbje krijuar nga Grupi kundrejt këtyre pasurive.

Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor për Grupin më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut kreditor. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Depozitat me afat		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</i>										
Vlera e bartur	560,541	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	93,300	83,547	-	-
	560,541	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	93,300	83,547	-	-
<i>Me kosto të amortizuar</i>	574,178	501,110	104,159	60,859	9,171	6,481	93,346	83,611	-	-
Lejimet për humbje	(13,637)	(9,890)	(54)	(28)	-	-	(46)	(64)	-	-
Vlera kontabël neto	560,541	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	93,300	83,547	-	-
									-	-
<i>Jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>									-	-
Angazhimet kreditore: Rrezik i ulët - i drejtë	43,408	31,057	-	-	-	-	-	-	17,321	13,206
<i>Gjithsej Angazhime/garanci</i>	43,408	31,057	-	-	-	-	-	-	17,321	13,206
Provizionet e njohura si detyrim	-	-	-	-	-	-	-	-	(246)	(37)
Gjithsej Ekspozimi	43,408	31,057	-	-	-	-	-	-	17,075	13,169

29. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë

	2025				2024			
	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kreditë	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kreditë
Kreditë për klientët								
Gjithsejt shuma bruto	189,535	172,236	212,740	574,511	166,263	161,525	173,322	501,110
Lejimet për humbje	(6,775)	(5,077)	(1,785)	(13,637)	(4,619)	(4,773)	(498)	(9,890)
Vlera kontabël neto	182,760	167,159	210,925	560,874	161,644	156,752	172,824	491,220

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

<i>Kreditë me kushte të rinegociuara</i>								
Vlera kontabël	709	1,901	-	2,611	305	1,939	264	2,508
Lejimet për humbje	(307)	(467)	-	(775)	(106)	(419)	(80)	(605)
Vlera kontabël neto	402	1,434	-	1,836	199	1,520	184	1,903
<i>Kreditë në vonesë</i>								
Jo në vonesë	180,032	151,970	200,350	532,352	156,155	145,964	171,308	473,427
Në vonesë 1-30 ditë	4,498	12,026	10,969	27,493	6,067	9,670	1,436	17,173
Në vonesë 31 - 90 ditë	1,339	2,788	33	4,160	1,244	1,924	42	3,210
Në vonesë 91 – 365 ditë	1,885	2,016	1,055	4,956	1,299	1,679	93	3,071
Në vonesë mbi 365 ditë	1,781	3,436	333	5,550	1,498	2,288	443	4,229
	189,535	172,236	212,740	574,511	166,263	161,525	173,322	501,110

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku kreditor (vazhdim)****Zhvlerësime dhe provizionime**

Provizionet gjithsej që kërkohen nga SNRF-të për “Menaxhimin e Rrezikut Kreditor” (shih 3. (f)(viii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuar në datën e raportimit (modeli i humbjes së shkaktuar) dhe humbjet e pritshme.

Grupi vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërpalëve, duke përdorur mjete të brendshme rangimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpalesh. Mjete të tilla kombinojnë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpalët janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Grupit, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori.

Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rankimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Grupi.

Kreditë janë ranguar nga A në E në sistemin e brendshëm të rangimit të rrezikut kreditor të Grupit:

- A Standarde
- B Vrojtuese
- C Nënstandarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Grupi raporton klasifikimin e humarrësve të saj tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosovës. Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3 (h) (viii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Grupi veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

Grupi vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë euro që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Grupi dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Grupit. (2024: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

Kreditë në vonesë por të pazhvlerësuar

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Grupit.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e shlyerjes

Grupi shlyen një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i shlyerjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin Gjithsej. Shuma gjithsej e shlyer gjatë vitit 2025 është 686 mijë euro (2024: 3,031 mijë euro).

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku kreditor (vazhdim)***Depozitat nga bankat*

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Gupi kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.

Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Më 31 dhjetor	2025	2024
AAA në AA-	10,225	1,744
AAA+ në BBB-	-	-
A+ në A-	7,097	3,906
BBB+ në BBB-	4,776	4,134
BBB+ në B-	-	-
BB+ në B-	443	3,257
Të pa rankuara	-	-
Bankat vendore	3,650	9,367
	26,191	22,408

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Grupi duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes

Grupi menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.

Grupi strukturon nivelet e rrezikut kreditor që ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Grupi mban kolateral kundrejt kredive ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

	2025		2024	
	Kreditë ndaj klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit	Kreditë ndaj klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipoteka	232,859	877,653	197,910	652,489
Kolateral në mjete monetare	19,868	15,608	16,148	18,102
Pengje	158,873	374,687	162,034	367,979
Miks (hipoteke dhe peng)	75,552	307,026	57,116	261,195
Pa kolateral	87,359	-	67,902	-
Gjithsej	574,511	1,574,974	501,110	1,299,765

Përqendrimi i rrezikut kreditor

Më 31 Dhjetor 2025, Grupi ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në 11.58%, gjithsej ishin dy ekspozime ndaj kredive që tejkalonin 10% të kapitalit të nivelit të parë (2024: 11.56%, dy ekspozime të kredive). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 Dhjetor 2025, përfaqëson 8.38% (2024: 9.92%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 4.01% (2024: 3.77%) të kapitali të nivelit të parë. Grupi monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Depozitat me afat		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Përqendrimi sipas sektorëve										
Korporative	210,955	172,825	-	-	-	-	-	-	14,247	10,119
Qeveria	-	-	104,105	60,831	9,171	6,481	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	93,300	83,547	-	-
Individët	182,760	161,643	-	-	-	-	-	-	13	-
Mikro entitete	167,159	156,752	-	-	-	-	-	-	2,815	3,050
Gjithsej	560,874	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	93,300	83,547	17,075	13,169
Përqendrimi sipas vendndodhjes										
vendet e BE-së	-	-	-	-	-	-	22,557	21,308	-	-
Rep. e Kosovës	560,874	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	70,743	62,239	17,075	13,169
Gjithsej	560,874	491,220	104,105	60,831	9,171	6,481	93,300	83,547	17,075	13,169

Pasojat e luftës Ukrainë-Rusi

Pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse dhe reagimi i mëpasshëm global ndaj këtyre veprimeve ushtarake mund të kenë efekte të rëndësishme financiare në shumë entitete dhe tregje financiare. Këto përfshijnë subjekte me operacione fizike në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi, si dhe interesa indirekte. Grupi nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rosisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, Grupi po monitoron vazhdimisht zhvillimet në lidhje me efektet e luftës Ukrainë-Rusi. Pozicioni financiar i Grupit vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si dhe në të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet.

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Grupit ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimi të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është rregulluar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të Grupit kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Grupit janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Grupi përpiqet të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Ekspozimet e Grupit janë të bazuara normat e interesit të shënuara të Kosovës dhe Grupi ballafaqohet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Grupit në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj. Departamenti i Thesarit monitoron në mënyrë konstante rrezikun e normave të interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për rishmimin ose rialokimin me miratimin e Komisionit të Pasurive dhe Detyrimeve. Raporti lidhur me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komisionit për Pasuri dhe Detyrime. Janë marrë masat e nevojshme nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analiza për depozituesit kryesorë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet në analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analizën e GAP-it mbi rrezikun e likuiditetit

Ekspozimi ndaj Rrezikut të Normës së Interesit

Operacionet e Grupit janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Grupi është i ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e rishmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR and EURIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Grupit.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Grupit ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit me 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë si në vijim:

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Pasuritë	USD		EUR		CHF		GBP	
	2025	2024	2025	2025	2024	2024	2025	2024
Paraja në dorë dhe në banka	3.31%	0.72%	0.51%	0.85%	-0.43%	-	0.22%	-
Balancat me BQK-në	-	-	0.30%	0.30%	-	-	-	-
Kreditë për klientët	-	-	6.91%	6.95%	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë kosto të amortizuar	-	-	-	3.19%	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë në VDATGJ	3.73%	4.19%	2.16%	2.94%	-0.10%	0.32%	-	-
Detyrimet				-	-		-	-
Depozitat e klientëve	2.05%	0.83%	1.45%	1.23%	0.05%	0.02%	0.01%	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimve financiare të Grupit ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1% në lakoren e kthimit.

	2025	2024
Përshkrimi	Totalet e Normave Fikse	Totalet e Normave Fikse
Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata	683,953	568,171
Totali i detyrimet totale dhe pozicionet e shkurtra	818,125	690,883
Pozicioni neto (i papeshuar)	(134,172)	(122,712)
Përshkrimi	Totalet e Normave Variabile	Totalet e Normave Variabile
Asetet dhe pozicionet e gjata		
Kredi dhe paradhënie për klientët	134,172	122,712
Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata	134,172	122,712
Detyrimet dhe pozicionet e shkurtra	-	-
Pozicioni neto (i papeshuar)	134,172	122,712

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Gjithsej kapitali (Klasi I + Klasi II)	97,549	69,081
Norma e interesit variabile në normë fikse të aseteve %	19.62%	21.60%

Banka vazhdon me proporcion të ngjajshëm në Riskun e normave të interesit. Banka ka përafërsisht 20% të aseteve të saj me norma variabile (2024: 22%).

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2025	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	25,426	-	-	-	-	-	20,864	46,290
Gjendja me BQK	66,883	-	-	-	-	-	-	66,883
Depozitat me afat	-	-	400	479	8,292	-	-	9,171
Investimet në letra me vlerë	22,738	21,096	20,771	27,218	12,283	-	-	104,105
Kredi klientëve – Norma fikse	8,584	22,954	45,772	55,321	249,582	178,661	-	560,874
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	3,211	3,211
Gjithsej	123,631	44,050	66,943	83,018	270,156	178,661	24,075	790,534
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	82,008	24,771	32,943	162,015	121,499	306	266,022	689,564
Detyrimet ndaj bankave	2,588	-	-	-	-	-	-	2,588
Detyrimet e provizioneve teknike	-	-	-	-	-	-	12,993	12,993
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-	2,350	2,350
Detyrimet tjera	-	-	-	3	1,681	1,090	2,457	5,231
Gjithsej	84,596	24,771	32,943	162,018	123,180	1,396	283,822	712,726
Hendeku	39,035	19,279	34,000	(79,000)	146,976	177,265	(259,747)	77,808
Hendeku kumulativ	39,035	58,314	92,314	13,314	160,290	337,555	77,808	

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

31 Dhjetor 2024	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	25,426	-	-	-	-	-	15,644	41,070
Gjendja me BQK	60,555	-	-	-	-	-	-	60,555
Depozitat me afat	-	-	-	922	5,559	-	-	6,481
Investimet në letra me vlerë	32,618	12,372	2,973	1,197	108	11,563	-	60,831
Kredi klientëve – Norma fikse	4,603	19,497	27,654	49,639	228,663	161,164	-	491,220
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	3,027	3,027
Gjithsej	123,202	31,869	30,627	51,758	234,330	172,727	18,671	663,184
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	53,712	22,839	21,285	101,041	124,303	1,354	267,239	591,773
Detyrimet ndaj bankave	1,096	-	-	-	-	-	-	1,096
Detyrimet e provizioneve teknike	-	-	-	-	-	-	12,107	12,107
Borxhi varur	-	-	-	-	-	-	200	200
Detyrimet tjera	-	-	-	3	1,681	1,090	1,822	4,596
Gjithsej	54,808	22,839	21,285	101,044	125,984	2,444	281,368	609,772
Hendeku	68,394	9,030	9,342	(49,286)	108,346	170,283	(262,697)	53,412
Hendeku kumulativ	68,394	77,424	86,766	37,480	145,826	316,109	53,412	

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë të huaj. Grupi sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë valuta të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra. Rreziku valuator nuk është signifikant, meqë pjesa më e madhe e transakioneve të Grupit janë në valutën vendase. Valutat e huaja me të cilat Grupi operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 janë si në vijim:

Valuta	2025 EUR	2024 EUR
1 USD	1.1750	1.0389
1 CHF	0.9314	0.9412
1 GBP	0.8726	0.8292

Ekspozimi i Grupit ndaj rrezikut të valutës së huaj, i shprehur në ekuivalentë në euro është si në vijim:

31 Dhjetor 2025	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	34,175	8,600	2,674	841	46,290
Gjendja me BQK	66,883	-	-	-	66,883
Depozitat me afat	9,171	-	-	-	9,171
Investimet në letra me vlerë	71,739	28,596	3,770	-	104,105
Kreditë për klientët	560,874	-	-	-	560,874
Pasuritë tjera	3,211	-	-	-	3,211
	746,053	37,196	6,444	841	790,534
Detyrimet					
Depozita nga klientët	644,560	37,550	6,613	841	689,564
Detyrimet ndaj bankave	2,588	-	-	-	2,588
Detyrimet e provizioneve teknike	12,993	-	-	-	12,993
Provizioni për primet e pafituara	6,636	-	-	-	6,636
Borxhi i varur	2,350	-	-	-	2,350
Detyrime të tjera	5,231	-	-	-	5,231
	674,358	37,550	6,613	841	719,362
Pozicioni neto valutor	71,695	(354)	(169)	-	71,172

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

31 Dhjetor 2024	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	34,041	2,704	3,533	792	41,070
Gjendja me BQK	60,555	-	-	-	60,555
Depozitat me afat	5,885	-	-	-	5,885
Investimet në letra me vlerë	51,014	7,694	2,123	-	60,831
Kreditë për klientët	491,220	-	-	-	491,220
Pasuritë tjera	3,027	-	-	-	3,027
	645,742	10,398	5,656	792	662,588
Detyrimet					
Depozita nga klientët	574,771	10,529	5,633	840	591,773
Detyrimet ndaj bankave	1,096	-	-	-	1,096
Detyrimet e provizioneve teknike	12,107	-	-	-	12,107
Provizioni për primet e pafituara	6,427	-	-	-	6,427
Borxhi i varur	200	-	-	-	200
Detyrime të tjera	4,596	-	-	-	4,596
	599,197	10,529	5,633	840	616,199
Pozicioni neto valutor	46,545	(131)	23	(48)	46,389

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj rritjes ose uljes së normave të valutës së huaj është si më poshtë:

	USD		CHF		GBP	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitimi ose humbja						
+5% e Euro	(17.68)	(6.56)	(8.45)	1.17	-	(2.40)
- 5% e Euro	17.68	6.56	8.45	(1.17)	-	2.40

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Grupi do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj. Qasja e Grupit për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundur, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Grupit. Grupi monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Banka Ekonomike Group
Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mbliidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar. Grupi ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Grupit dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 arritën në 57,360 mijë euro (me 31 Dhjetor 2024: 44,750 mijë euro).

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Grupi përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Grupi vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Grupit. Për më tepër Grupi mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabelat e mëposhtme tregojnë flukset monetare të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit në bazë të maturimit më të hershëm kontraktual të mbetur. Flukset monetare të pritshme të Grupit për këto instrumente ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)
Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2025	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	46,290	-	-	-	-	-	46,290
Gjendja me BQK	66,883	-	-	-	-	-	66,883
Depozitat me afat	-	-	400	479	8,292	-	9,171
Investimet në letra me vlerë	22,738	21,096	20,771	27,218	12,282	-	104,105
Kreditë për klientët	8,584	22,954	45,772	55,321	249,582	178,661	560,874
Asete të tjera	3,211	-	-	-	-	-	3,211
Gjithsej	147,706	44,050	66,943	83,018	270,156	178,661	790,534

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Liabilities

Depozitat nga klientët	348,030	24,771	32,943	162,015	121,499	306	689,564
Detyrimet ndaj bankave	2,588	-	-	-	-	-	2,588
Detyrimet e provizioneve teknike	12,993	-	-	-	-	-	12,993
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	2,350	2,350
Detyrime të tjera	745	4	616	156	3,255	455	5,231
Gjithsej	364,356	24,775	33,559	162,171	124,754	3,111	712,726
Hendeku	(216,650)	19,275	33,384	(79,153)	145,402	175,550	77,808
Hendeku kumulativ	(216,650)	(197,375)	(163,991)	(243,144)	(97,742)	77,808	

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

31 Dhjetor 2024	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	41,070	-	-	-	-	-	41,070
Gjendja me BQK	60,555	-	-	-	-	-	60,555
Depozitat me afat	-	-	-	922	5,559	-	6,481
Investimet në letra me vlerë	32,618	12,372	2,973	1,197	108	11,563	60,831
Kreditë për klientët	4,603	19,497	27,654	49,639	228,663	161,164	491,220
Pasuri të tjera	3,027	-	-	-	-	-	3,027
Gjithsej	141,873	31,869	30,627	51,758	234,330	172,727	663,184
Liabilities							
Depozitat nga klientët	320,951	22,839	21,285	101,041	124,303	1,354	591,773
Depozitat nga klientët	1,096	-	-	-	-	-	1,096
Detyrimet ndaj bankave	12,107	-	-	-	-	-	12,107
Detyrimet e provizioneve teknike	200	-	-	-	-	-	200
Detyrime të tjera	745	4	616	156	2,620	455	4,596
Gjithsej	335,099	22,843	21,901	101,197	126,923	1,809	609,772
Hendeku	(193,226)	9,026	8,726	(49,439)	107,407	170,918	53,412
Hendeku kumulativ	(193,226)	(184,200)	(175,474)	(224,913)	(117,506)	53,412	

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Grupi e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.
Struktura e kapitalit të Grupit përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë

Kapitali rregullator

Grupi monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Leva financiare

Komiteti i menaxhimit të rrezikut të Grupit rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK, raporti minimal i levës është 3%.
Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2025	2024
Gjithsej Pasuritë	817,929	690,883
Gjithsej Ekuiteti	97,402	73,828
Raporti i levës	11.91%	10.69%

29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(f) Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Risku tjetër me të cilin përballlet Grupi në bazë të kontratave të sigurimit është se kërkesat aktuale dhe pagesat e përfitimeve ose koha e tyre ndryshojnë nga pritjet. Kjo ndikohet nga shpeshtësia e kërkesave, ashpërsia e kërkesave, përfitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi i mëvonshëm i kërkesave afatgjata. Prandaj, qëllimi i Grupit është që të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion për të mbuluar këto detyrime.
Ekspozimi ndaj riskut zbutet nga diversifikimi në një portofol të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Ndryshueshmëria e risqeve është përmirësuar gjithashtu me përzgjedhjen e kujdesshme dhe zbatimin e udhëzimeve të strategjisë së sigurimit, si dhe me përdorimin e marrëveshjeve të ri-sigurimit.
Grupi blen ri-sigurime si pjesë e programit të lehtësimit të risqeve të saj. Ri-sigurimi i dhënë është vendosur në bazë proporcionale dhe jo-proportionale. Pjesa më e madhe e ri-sigurimit proporcional është tejkalimi i ri-sigurimit të humbjes që merret për të kufizuar ekspozimin e përgjithshëm të Grupit në disa kategori të biznesit. Ri-sigurimi jo-proporcional është kryesisht ri-sigurimi i humbjes së tepërt i projektuar për të zbutur ekspozimin neto të kompanisë ndaj humbjeve nga katastrofa. Kufijtë e mbajtjes për ri-sigurimin e humbjes së tepërt ndryshojnë sipas linjës dhe territorit të produktit.

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në një mënyrë që përputhet me kërkesat e provizioneve të papaguara dhe janë në përputhje me kontratat e ri-sigurimit.

Megjithëse Grupi ka marrëveshje për ri-sigurim, nuk lirohet nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj të siguarve të saj dhe kështu ekziston një ekspozim kredie në lidhje me sigurimet e dhëna, deri në masën që ndonjë ri-sigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e marra sipas marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Grupi kryesisht lëshon këto lloje të kontratave të sigurimit: sigurimi i përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, sigurimi shëndetësor, sigurimi i pronës, sigurimi profesional të dëmshpërblimit dhe kontratave të tjera të sigurimit.

Për sigurimin e përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, risku më i rëndësishëm është dëmi material dhe jo material që shkaktohet nga aksidentet. Për sigurimin e pronës dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor risqet më të rëndësishme janë: katastrofa natyrore, zjarri, aktivitetet terroriste, epidemitë, shkencat mjekësore dhe përmirësimet në teknologji.

Qëllimi i këtyre strategjive të sigurimit dhe ri-sigurimit është të kufizojë ekspozimin ndaj katastrofave bazuar në oreksin e riskut të kompanisë siç vendoset nga menaxhmenti. Mbajtjet maksimale të sigurimit janë 10% e kapitalit rregullator minimal.

Tabela e mëposhtme përcakton përqendrimin e detyrimeve të kontratës së sigurimit jo të jetës sipas llojit të kontratës:

31 Dhjetor 2025

	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta	8,919	187	8,732
BKS	987	52	935
Fondi i Kompenzimit	922	-	922
Sigurimi i Pronës	739	503	236
Sigurimi shëndetësor	385	-	385
Produkte të tjera	1,041	39	1,002
Gjithsej	12,993	781	12,212

31 Dhjetor 2024

	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta	8,075	200	7,875
BKS	880	53	827
Fondi i Kompenzimit	915	-	915
Sigurimi i Pronës	757	503	254
Sigurimi shëndetësor	500	-	500
Produkte të tjera	980	126	854
Gjithsej	12,107	882	11,225

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

30. Kombinimet e biznesit dhe shkrirja

Kombinimi i biznesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 ishte blerja e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiali"). Më 9 shtator 2022 (data e blerjes), shoqëria mëmë fitoi 100% të të drejtave të votës të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a, një kompani e përfshirë në sigurimet e jo-jetës. Si rezultat, Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.a. u bë një filial i shoqërisë mëmë pasi shoqëria mëmë mori kontrollin e Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.a. Detajet e vlerës së drejtë të pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve, shuma e blerjes dhe emri i mirë janë si më poshtë:

	Vlera kontabël Euro	Rregullimet Euro	Vlera e drejtë Euro
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	738,259	-	738,259
Investimet në depozita me afat	7,368,878	-	7,368,878
Investimet në Obligacione Qeveritare	1,953,564	-	1,953,564
Kërkesat ndaj debitorëve	1,212,361	-	1,212,361
Kërkesat e ceduara nga risigurimi	1,907,010	-	1,907,010
Kostoja e shtyrë e blerjes	411,943	-	411,943
Prona, Impiante & Pajisje	3,252,508	112,845	3,365,353
Prona investuese	894,517	-	894,517
Pasuritë e paprekshme	24,201	-	24,201
Pasuritë tatimore	-	14,201	14,201
Pasuritë tjera	317,860	(46,003)	271,857
Gjithsej Vlera e Drejtë e Pasurive	18,081,101	81,043	18,162,144
Detyrimet			
Primi i pafituar	4,559,113	-	4,559,113
IBNR dhe RBNS	10,974,692	590,000	11,564,692
Detyrimet e Risigurimit	931,203	-	931,203
Detyrimet ndaj KIB	142,238	-	142,238
Detyrimet e qirasë – IFRS 16	50,995	-	50,995
Detyrimet e qirasë	148,931	-	148,931
Detyrimet tatimore	106,396	-	106,396
Paga dhe Kontributet Pensionale	54,711	-	54,711
Detyrimet ndaj aksionarëve	97,509	-	97,509
Detyrimet ndaj furnitorit	240,872	-	240,872
Detyrimet e tatimit në fitim	35,000	(35,000)	-
Detyrimet Kontigjente	-	-	-
Gjithsej Vlera e Drejtë e Detyrimeve	17,341,660	555,000	17,896,660

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

Vlera e Drejtë e Pasurive Neto të Fituara	739,441	(473,957)	265,484
Emri i mirë			
Konsiderata e transferuar			2,100
IJK			-
			2,100
Vlera e drejtë e pasurive të blera			18,162
Vlera e drejtë e detyrimeve të supozuara			(17,897)
Vlera e drejtë e pasurive neto të fituara			265
Emri i mirë në datën e blerjes			1,835

30. Kombinimet e biznesit dhe shkrirja (vazhdim)

Emri i mirë konsiston kryesisht në përfitime ekonomike të ardhshme dhe sinergji me operacionet ekzistuese dhe nuk është i zbritshëm për qëllime tatimore. Grupit i kërkohet të testojë, në baza vjetore, nëse emri i mirë ka pësuar ndonjë zhvlerësim. Shuma e rikuperueshme përcaktohet në bazë të llogaritjeve të vlerës në përdorim. Përdorimi i kësaj metode kërkon vlerësimin e rrjedhjeve monetare të ardhshme dhe përcaktimin e një norme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të rrjedhjeve monetare. Që nga data e raportimit, Emri i mirë nuk është zhvlerësuar.

Shumat e rikuperueshme të kompanisë së blerë janë përcaktuar nga llogaritjet e vlerës në përdorim bazuar në parashikimet e flukseve monetare nga buxhetet që mbulojnë një periudhë deri më 31 dhjetor 2027. Supozime të tjera kryesore janë si më poshtë:

- Norma e skontimit: 15.65%
- Norma e rritjes: 2.00%

Norma e rritjes dhe supozimi zbatohen vetëm për periudhën përtej periudhës së buxhetuar formale me llogaritjen e vlerës në përdorim.

Në bazë të nënshkrimit të marrëveshjes së blerjes/shitjes më 23 prill 2025, dhe marrjes së miratimit nga Banka Qendrore e Kosovës nëpërmjet vendimit të tyre nr. 2025/312, datë 29 korrik 2025, Banka Ekonomike përfundoi blerjen e asetëve dhe detyrimeve të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë më 19 gusht 2025 (data e blerjes). Si rezultat, asetet dhe detyrimet e blera të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë u bashkuan me asetet dhe detyrimet e Bankës. Detajet e vlerës së drejtë të asetëve dhe detyrimeve të identifikueshme të blera, shpërblimi i blerjes dhe fitimi që rezultoi nga blerja me çmim të volitshëm janë si më poshtë:

Banka Ekonomike Group**Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025**

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Vlera në libra EUR	Rregullime EUR	Vlera e drejtë EUR
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	3,405,693	-	3,405,693
Kredi për klientët	38,068,106	(332,775)	37,735,331
Investime në letra me vlerë	7,051,204	87,710	7,138,914
Prona pajisjet dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	819,039	68,288	887,327
Pasuri të paprekshme	28,577	-	28,577
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	97,948	-	97,948
Pasuri të tjera	209,119	(196,436)	12,683
Gjithsej Pasuritë	49,679,686	(373,213)	49,306,473
Liabilities			
Detyrime ndaj klientëve	33,580,299	(562,218)	33,018,081
Detyrime ndaj bankave	1,595,865	-	1,595,865
Detyrimi i tatimit në të ardhura	98,275	-	98,275
Detyrime të tjera	1,556,031	(75,959)	1,480,072
Detyrimi i shtyer tatimor	29,951	-	29,951
Gjithsej Detyrimet	36,860,421	(638,177)	36,222,244
Pasuritë neto të blera	12,819,265	264,964	13,084,229
Fitimi nga blerja mbi vlerën e drejtë			
Gjithsej Konsiderata (shiko shënimin 11)			10,200,000
Vlera e drejtë e Pasurive të fituara			49,306,473
Vlera e drejtë e Detyrimeve të marra			(36,222,244)
Vlera e Drejtë e Pasurive Neto të Fituara			13,084,229
Fitimi nga blerja mbi vlerën e drejtë në datën e blerjes			2,884,229

Shuma totale prej 10.2 milionë euro për blerjen e aktiveve dhe pasivave të Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë, u transferua te shitësi më 3 Tetor 2025.

Banka Ekonomike Group

Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

31. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas datës së raportimit, Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat hyri në fuqi në Republikën e Kosovës në vitin 2026, duke sjellë ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullator që rregullon sektorin bankar. Ligji përfshin ndryshime, ndër të tjera, lidhur me kërkesat për licencim, mjaftueshmërinë e kapitalit, qeverisjen korporative, menaxhimin e rrezikut, kërkesat mbikëqyrëse si dhe rregullore të tjera prudenciale të zbatueshme për bankat që operojnë në Kosovë. Ligji parashikon një periudhë tranzitore prej një viti, gjatë së cilës bankat janë të detyruara të përshtatin operacionet, politikat dhe proceset e tyre të brendshme me kërkesat e reja rregullatore.

Po ashtu, pas datës së raportimit, tensionet gjeopolitike, përfshirë zhvillimet që lidhen me konfliktin Iran–Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë vazhduar të evoluojnë. Megjithëse Grupi operon në Kosovë dhe nuk ka ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj zonave të prekura nga konflikti, operacionet e tij mund të ndikohen në mënyrë indirekte përmes kushteve më të gjera rajonale dhe globale të tregjeve financiare, ndikimeve të mundshme në kushtet ekonomike lokale, si dhe ndryshimeve në aktivitetin dhe sjelljen e klientëve. Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, situata mbetet e paqëndrueshme dhe natyra, koha dhe madhësia e çdo ndikimi të mundshëm në operacionet e Grupit, pozitën financiare, likuiditetin, cilësinë e aktiveve ose mjaftueshmërinë e kapitalit nuk mund të përcaktohen në mënyrë të besueshme. Menaxhmenti vazhdon të monitorojë me kujdes zhvillimet dhe të vlerësojë implikimet e tyre të mundshme. Si rrjedhojë, nuk janë bërë rregullime në pasqyrat financiare të konsoliduara në lidhje me këto çështje.

Me përjashtim të asaj që është shpalosur më sipër, nuk ka pasur ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare të konsoliduara.

KOMPANIA E SIGURIMEVE “SIGURIA”
BILANCI I GJENDJES DHE PASQYRA E TË ARDHURAVE



RSM KOSOVO SH.P.K.
Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja B-C,
Kati 2, No.B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo
DL +383 45 666 888
www.rsm.global/kosovo

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me politikat kontabël të shpalosura në Shënimin 2A.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin "IESBA". Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

Theksim i Çështjes

Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 27b të pasqyrave financiare, i cili përshkruan procesin gjyqësor ndaj Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), një organizatë profesionale dhe jofitimprurëse, e themeluar nga kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë, përfshirë edhe Kompaninë. Siç shpaloset në këtë shënim, më 24 korrik 2025, Gjykata e Apelit ka nxjerrë një vendim kundër BKS në lidhje me këtë çështje. Më pas, me vendimin e saj të datës 20 janar 2026, Gjykata Supreme e Kosovës e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Apelit për rigjykim. Për rrjedhojë, procedurat gjyqësore mbeten në vazhdim dhe rezultati përfundimtar është i pasigurt.

Siç shpaloset më tej në Shënimin 27b dhe Shënimin 25, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe pas njohjes së një provizioni nga BKS në pasqyrat e saj financiare, menaxhmenti ka vlerësuar dhe ka njohur një provizion në shumën prej 146 mijë euro në pasqyrat financiare shoqëruese, që përfaqëson pjesën e Kompanisë në detyrimin e mundshëm që rrjedh nga kjo çështje gjyqësore. Provizioni është njohur mbi bazën e vlerësimeve më të mira të menaxhmentit në datën raportuese. Megjithatë, shuma e saktë e detyrimit financiar përfundimtar nuk mund të përcaktohet me siguri në këtë fazë, pasi varet nga rezultati përfundimtar i procesit gjyqësor në vazhdim. Për rrjedhojë, provizioni i njohur i nënshtrohet pasigurisë së konsiderueshme në vlerësim, dhe shuma përfundimtare mund të ndryshojë nga shuma e njohur aktualisht.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 7 prill 2025.

Informata tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat tjera përfshijnë pasqyën shtesë e cila përmban “Margjinën e Solvencës”, “Llogaritjen e Kapitalit” dhe “Mjaftueshmërinë e investimeve të aseteve në mbulim të provizioneve teknike”. Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon informatat e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie apo konkluzioni lidhur me to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informatat e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket se përmbajnë gabime materiale. Nëse, bazuar në punën që kemi bërë në informacionet e tjera të fituara para datës së këtij raporti të auditorit, dhe nese ne konkludojmë se ka një gabim material të këtij informacioni tjetër, ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të shpalosura në Shënimin 2A. dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 7 prill 2025.

Përgjegjësia e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritjet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

Përgjegjësia e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (Vazhdim)

- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës
21 Prill 2026



Sadik Berisha

Auditor Ligjor

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjeve midis këtyre raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING


RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	31 Dhjetor 2025 EUR '000	31 Dhjetor 2024 EUR '000
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	1,082	870
Depozitat	7	14,505	11,682
Investimet ne letrat me vlere	7	4,125	5,082
Të arkëtueshmet nga sigurimet	8	1,753	1,299
Kostot e shtyra të përvetësimit	9	625	601
Prona, pajisjet dhe impiantet	10	3,183	2,975
E drejta e shfrytëzimit të pasurive	11	342	311
Pasuritë e paprekshme	12	97	39
Prona investuese	13	895	895
Pasuritë nga risigurimet	14	1,098	2,058
Pasuritë nga tatimi në fitim		40	-
Pasuritë tjera	15	656	640
GJITHSEJ PASURITË		28,401	26,452
EKUITETI DHE DETYRIMET			
EKUITETI			
Kapitali aksionar	16	19,503	19,503
Rezerva e rivlerësimit		534	534
Humbjet e akumuluar		(11,992)	(12,846)
GJITHSEJ EKUITETI		8,045	7,191
DETYRIMET			
Detyrimet e provizioneve teknike	17	12,431	11,545
Provizioni për prime të pafituara	18	6,636	6,427
Detyrim ndaj borxhittë varur	19	214	200
Detyrim ndaj tatimit në të ardhura		-	164
Detyrimet e qirasë	20	356	324
Detyrimet nga sigurimi dhe të tjera	21	573	601
Detyrimet për çështje ligjore	27b	146	-
GJITHSEJ DETYRIMET		20,356	19,261
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		28,401	26,452

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 03 Prill 2026 dhe janë nënshkruar në emër të:


 Z. Fitim Rexhepaj
 Drejtor Gjeneral


 Z. Adhurim Kastrati
 Drejtor Financiar

Shënimet bashkëngjitur nga 1 deri në 29 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	31 Dhjetor 2025 EUR '000	31 Dhjetor 2024 EUR '000
Primet e shkruara bruto	22	14,801	14,460
Minus: Primet e bartura tek risiguruesit	22	(896)	(2,055)
PRIMET E SHKRUARA NETO		13,905	12,405
Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara	18	(209)	(1,258)
Ndryshimi në pjesën e risiguruesëve të rezervës së primitë pafituar	18	(859)	770
PRIMET E FITUARA NETO		12,837	11,917
Të ardhuratfinanciare neto	23	390	355
Të ardhura tjera	24	230	411
GJITHSEJ TË ARDHURAT		13,457	12,683
Shpenzimet e provizioneve teknike	17	(7,612)	(6,641)
Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit	11	23	70
Kontributi në BKS për shpenzimet administrative		(239)	(257)
Shpenzime tjera operative dhe administrative	25	(4,560)	(4,828)
GJITHSEJ SHPENZIMET		(12,388)	(11,656)
FITIMI PARA TATIMIT		1,069	1,027
Tatimi në të ardhura	26	(215)	(269)
FITIMI PËR VITIN		854	758
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
GJITHSEJ FITIMI GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		854	758

Shënimet bashkëngjitur nga 1 deri në 29 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.